



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:088225

Datë: 24.09.2024

Numri i dokumentit: 06200904

PKR.nr. 7/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas Kryetari i trupit gjykues – gjyqtari Shaqë Curri, gjyqtarëve, Sami Sharaxhiu dhe Violeta Husaj Rugova, anëtar të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale, Selvane Bukleta, në çështjen penale të ndaj të pandehurve, N.G., B.G., A.G.. A.G.1, dhe B.G.1, për shkak të veprës penale, të kryer në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nënpar 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje, “vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, i pandehuri N.G. edhe për shkak të veprës penale, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i pandehuri Y.G., për shkak të veprës penale, “ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, po ashtu për shkak të veprës penale, “ndihma në kryerje e veprës penale, vrasje e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, si dhe veprës penale “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.142/2022 të dt.03.02.2023, pas mbajtjes së seancave publike të shqyrtimit gjyqësor të datës 28.02.2024, 05.03.2024, 06.03.2024, 02.04.2024, 25.04.2024, 12.06.2024, 13.06.2024, 26.07.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit, Lumturije Vuçetaj, të pandehurit N.G., mbrojtësit të tij av. E.K.sipas autorizimit, të pandehurit B.G., mbrojtësit të tij av. R.G.sipas autorizimit, të pandehurit A.G., mbrojtësit të tij av. N.D.sipas autorizimit, të pandehurit A.G.1, mbrojtësit të tij av. G.K., sipas detyrës zyrtare, të pandehurit B.G.1, mbrojtësit të tij av. G.K.1sipas detyrës zyrtare, dhe të pandehurit Y.G., mbrojtësit të tij av. T.R.sipas autorizimit, të dëmtuarit M.H., A.H.dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve, av. F.K., me dt. 31.07.2024 bie dhe shpallë publikisht, ndërsa me datë 24.09.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri **Y.G.**, i biri dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në me banim në fsh. K., me punëtor në NTP “.....”, identifikohet me Inj.nr....., i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, posedon numër telefoni, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në liri

Në kuptim të nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së

LIROHET NGA AKTAKUZA

Gjëja se:

I- Më parë dhe gjerë me datë 28.04.2022, në fshatin Volljakë, K. Klinë, në vend punishten “.....”, me dashje ndihmon personin tjetër në kryerjen e veprës penale “Vrasja e rëndë” dhe “Vrasja e rëndë në tentativë”, në atë mënyrë që, i pandehuri i siguron mjetin armën/pistoletën e llojit TT, me nr. serik: 7588839661962, të pandehurit N.G. duke i vënë në dispozicion të njëjtën me qëllim të kryerjes së veprës penale në dëm të tani viktimës F.H., i cili privohet nga jeta me armën në fjalë nga i pandehuri N. në parkingun e restorantit “.....”, në fsh. Volljakë, K. Klinë, me ç’rast pas ekzaminimit të dëshmimeve të sekuestruara në vendin e ngjarjes, në raportin e ekspertimit me nr. AKF/2022-2020/2022-1945, dt. 26.10.2022, është dhënë konstatimi se dëshmia #1 - gëzhjojë 7.62x25mm e gjetur në vendngjarje, nga e njëjta është përfituar profil i përzier i ADN-së nga së paku dy persona, ku njëri prej tyre është i të pandehurit Y.G.,

- me çka kishte për të kryer vepër penale, ndihma në kryerjen e veprës penale “Vrasja e rëndë” nga neni 173, par. 1, nënpar. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 33, të KPRK-së.

II. - Më parë dhe gjerë me datë 28.04.2022, në fshatin Volljakë, K. Klinë, në vend punishten “Buka prej guri”, me dashje ndihmon personin tjetër në kryerjen e veprës penale “Vrasja e rëndë” dhe “Vrasja e rëndë në tentativë”, në atë mënyrë që, i pandehuri i siguron mjetin armën/pistoletën e llojit TT, me nr. serik: 7588839661962, të pandehurit N.G. duke i vënë në dispozicion të njëjtën me qëllim të kryerjes së veprës penale në dëm të te dëmtuarve M.dhe A.H., ku i pari goditet me një predhë në këmbën e majtë, poshtë gjurit, ndërsa i dyti tentohet të qëllohet nga i pandehuri N. në parkingun e restorantit “.....”, në fsh. Volljakë, K. Klinë, me ç’rast pas ekzaminimit të dëshmimeve të sekuestruara në vendin e ngjarjes, në raportin e ekspertimit me nr. AKF/2022-2020/2022-1945, dt. 26.10.2022, është dhënë konstatimi se dëshmia #1 - gëzhjojë 7.62x25mm e gjetur në vendngjarje, nga e njëjta është përfituar, profil i përzier i ADN-së nga së paku dy persona, ku njëri prej tyre është i të pandehurit Y.G.,

- me çka kishte për të kryer vepër penale, ndihma, në kryerjen e veprës penale “Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 33, të KPRK-së.

III. - Më parë e gjer me datë 28.04.2022, në fshatin Volljakë K. Klinë, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), mban në pronësi dhe kontroll armë dhe atë: pistolletën, ngjyrë të zezë, e llojit TT, me nr. serik: 7588839661962, në atë mënyrë që, i pandehuri armën në

fjalë me po këtë datë ia vë në dispozicion të pandehurit N. siç edhe është përshkruar në dispozitiv I dhe II të këtij aktygjykimi.

- me çka kishte për të kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale në raport me të pandehurin Y.G., bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykatës.

Pjesa Dënuese

Të pandehurit

1.N.G., i biri i dhe nënës, e gjinisë i lindur me dt., në fsh., K., ku edhe banon në ... rr. ”....” nr....., ka të kryer shkollën fillore, me punëtor fizik, identifikohet me lnj.nr....., i pamartuar, posedon numër telefoni, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 28.04.2022 e tutje.

2. A.G.1, i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh., K., ku edhe banon në rr. ”....” nr..., ka të kryer shkollën fillore, me punëtor fizik, identifikohet me lnj.nr....., i pamartuar, posedon numër telefoni, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 28.04.2022 e tutje.

3. A.G., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh. Sferk.....ë, K., ku edhe banon në rr. ”.....” nr....., ka të kryer shkollën fillore, me punëtor fizik, identifikohet me lnj.nr....., i martuar, baba i dy fëmijëve, posedon numër telefoni, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data.28.04.2022 e tutje.

4. B.G.1, i biri idhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh., K., ku edhe banon në rr. ”.....” nr....., i pa arsimuar, me punëtor fizik, identifikohet me lnj.nr....., i martuar, baba i dy fëmijëve, posedon numër telefoni, i gjendjes së mesme ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 28.04.2024 e tutje.

5. B.G., i biri i dhe nënës, e gjinisë, i lindur me dt., në fsh. Sferkë, K., ku edhe banon në rr. ”.....”, punëtor në NTP “.....”, i martuar, baba i tre fëmijëve, ka të kryer shkollimin universitar, posedon numër telefoni, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar, shtetas i R. se Kosovës, gjendet në paraburgim nga data 28.04.2024 e tutje.

JANË FAJTORË

Sepse,

I. Të pandehurit, N.G., B.G., A.G., A.G.1 dhe B.G.1

- Me datë 28.04.2022, rreth orës 20:30, në fshatin Volljakë, K. Klinë, në parkingun e restorantit “.....”, të përgatitur paraprakisht dhe duke vepruar në bashkëkryerje, e më qëllim të hakmarrjes së paskrupullt, privojnë nga jeta personin tjetër viktimën F.H., në atë mënyrë që, të pandehurit N., A., A.1 dhe B.G.1 përderisa ishin në vend punishten “.....”, aty pari kalon i dëmtuari M.me veturën e tij të llojit “Porche”, dhe më të vërejtur këtë të fundit, të pandehurit N., B. dhe A.1, me veturën Pick-up me targa: dhe me veturën me targa, përcjellin dhe lokalizojnë vendndodhjen e të dëmtuarve, ku rreth orës 20:14 veturën Pick-up e parkojnë në parking përballë hyrjes kryesore të restorantit dhe me gatishmëri për t’u larguar, gjersa veturën tjetër “.....” paraprakisht e kishin lënë në një parking tjetër, me ç’ rast këtë informacion e bartin tek i pandehuri A., i cili kishte mbetur në vend punishten e lartcekur ku pas komunikimit të menjëhershëm me të pandehurin B.1, ky i fundit shkon dhe e merr të pandehurin A. me veturën e llojit me targa dhe më pas të njëjtit e parkojnë veturën në afërsi të veturës “.....” diku rreth 70 m larg vendit të ngjarjes dhe nga aty shkojnë në këmbë, ku rreth orës 20:21 u bashkëngjiten të pandehurve të tjerë në parkingun e restorantit, tutje i pandehuri B.1 hyn në restorant nga hyrja kryesore, shikon se ku janë ulur familja H., kthehet tek vetura ku ishin edhe të pandehurit tjerë, pastaj vazhdon për tek hyrja anësore, ulet në pjesën e tarracës dhe gjatë gjithë kohës monitoron situatën duke përcjellë vazhdimisht vendndodhjen dhe lëvizjet e viktimës dhe të dëmtuarve në brendi të restorantit dhe jashtë, ashtu që rreth orës 20:29:37, i dëmtuari M., i përcjellë nga familjarët e tjerë, del jashtë restorantit, më të dalë nga hyrja kryesore, vërehet nga të pandehurit tjerë, i pari nga vetura del i pandehuri A.1 me mjet të fortë (shkop) në dorë dhe vrapon në drejtim të dëmtuarit M., e pas tij vrapon edhe i pandehuri N. po ashtu me mjet të fortë në dorë (shkop), ku gjatë kohës së përleshjes bashkëngjiten për ti dalë në ndihmë vëllait të tyre M., fillimisht i ndjeri F.e më pas edhe i dëmtuari A., me ç’rast në kohën që po ndodhte përleshja i dëmtuari M.pëson goditje nga të pandehurit e lartcekur dhe në ora 20:30:10 i njëjti plagoset në këmbën e majtë nga gjuajtja me armë nga i pandehuri N. dhe në ora 20:30:19 sec. largohet me vrap në drejtim të hyrjes së restorantit, gjersa të pandehurit A. dhe B., veç se tani ishin përfshirë në përleshje, ku ky i fundit kishte mjet të fortë në dorë (lopatë), dhe në ora 20:30:19 sec. në ato momente ndërhyjnë edhe i dëmtuari A., i cili pas të dëmtuarit M.bëhet objekt i goditjeve të pandërprera me mjete të forta dhe grushte e shqelma nga të pandehurit, gjersa brenda intervalit kohor nga ora 20:30:22 deri në ora 20:30:27 i pandehuri N. përderisa mban pistoletën më dy duar gjuan dy herë në drejtim të të dëmtuarit A., veprime këto që vërehen nga viktimi i cili me vrap afrohet për të zbraps sulmin ndaj të vëllait, por që më të arritur, i pandehuri N. me pistoletën e llojit TT, me nr. serik:, merr shenjë në të dhe e godet me një predhë në kokë saktësisht në ora: 20:30:30 sec., pikërisht në syrin e majtë, duke tejshkuar kokën dhe duke përfunduar pas veshit të djathtë i cili rrëzohet pa shenja jete, e që ashtu i shtrirë goditet edhe dy herë me lopatë nga i pandehuri B., pastaj sulmi vazhdon prapë ndaj të dëmtuarit A., ku i pandehuri N. me pistoletën në dorën e djathtë lëvizë në vendin e ngjarjes saktësisht nga intervali kohor prej 20:30:55 deri në ora 20:30:59 sec., përderisa i pandehuri B.1 gjatë kohës derisa është në vendngjarje qëndron vetëm duke i vëzhguar dhe atë në një distancë shumë të afërt, pa marrë ndonjë veprim aktiv për t’i ndarë, të gjitha këto veprime nga të pandehurit janë

ndërmarr me motiv hakmarrjeje ku tre vëllezër të te dëmtuarve H., kishin rrahur një vëlla të te pandehurve G., për një borxh prej 300 euro, rast ky i ndodhur në Brescia - Itali, ku si pasojë e këtyre veprimeve humb jetën tani i ndjeri F.,

- me çka duke vepruar në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “**Vrasja e rëndë**” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së.

II. Të pandehurit, N.G., B.G., A.G., A.G.1 dhe B.G.1

- Me datë 28.04.2022, rreth orës 20:30, në fshatin Volljakë, K. Klinë, në parkingun e restorantit “.....”, të përgatitur paraprakisht dhe duke vepruar në bashkëkryerje, e më qëllim të hakmarrjes së paskrupullt, tentojnë të privojnë nga jeta të dëmtuarit M.dhe A.H., në atë mënyrë siç edhe është përshkruar në dipozitivin I, të pandehurit bëhen bashkë në parkingun e restorantit duke pritur të dëmtuarit, dhe rreth orës 20:29:37, i dëmtuari M., i përcjellë nga familjarët e tjerë, del jashtë restorantit, më të dalë nga hyrja kryesore, vërehet nga të pandehurit, i pari nga vetura del i pandehuri A.1 me mjet të fortë (shkop) në dorë dhe vrapon në drejtim të të dëmtuarit M., e pas tij vrapon edhe i pandehuri N. po ashtu me mjet të fortë në dorë (shkop), ku gjatë kohës së përleshjes bashkëngjiten për ti dalë në ndihmë vëllait të tyre M., fillimisht i ndjeri F. e më pas edhe i dëmtuari A., me ç’rast në kohën që po ndodhte përleshja i dëmtuari M.pëson goditje nga të pandehurit e lartcekur dhe në ora 20:30:10 i njëjti plagoset në këmbën e majtë nga gjuajtja me armë nga i pandehuri N. dhe në ora 20:30:19sec. largohet me vrap në drejtim të hyrjes së restorantit, gjersa të pandehurit A. dhe B., veç se tani ishin përfshirë në përleshje, ku ky i fundit kishte mjet të fortë në dorë (lopatë), dhe në ora 20:30:19 sec. në ato momente ndërhyjnë edhe i dëmtuari A., i cili pas të dëmtuarit M.bëhet objekt i goditjeve të pandërprera me mjete të forta dhe grushte e shqelma nga të pandehurit, gjersa brenda intervalit kohor nga ora 20:30:22 deri në ora 20:30:27 i pandehuri N. përderisa mban pistoletën më dy duar gjuan dy herë në drejtim të të dëmtuarit A., veprime këto që vërehen nga viktimi i cili me vrap afrohet për të zmbrops sulmin ndaj të vëllait, por që më të arritur, i pandehuri N. me pistoletën e llojit TT, me nr. serik:, merr shenjë në të dhe e godet me një predhë në kokë, ku si pasojë e goditjes i ndjeri F. humb jetën, pastaj sulmi vazhdon prapë ndaj të dëmtuarit A., ku i pandehuri N. me pistoletën në dorën e djathtë lëvizë në vendin e ngjarjes saktësisht nga intervali kohor prej 20:30:55 deri në ora 20:30:59 sec., përderisa i pandehuri B.1 gjatë kohës derisa është në vendngjarje qëndron vetëm duke i vëzhguar dhe atë në një distancë shumë të afërt, pa marrë ndonjë veprim aktiv për t’i ndarë, për më tepër parandalon menaxherin e restorantit – dëshmitarin E. B. që të ndërhynte për t’i ndarë, ku si pasojë e këtyre veprimeve, i dëmtuari M.ka pësuar plagë tejkshkuese me armë zjarri në regjionin e kërcirit të majtë, gërvishtje lëkurore në regjionin e laprës së veshit të majtë, dhe plagë në regjionin e pasëm dhe të djathtë të kokës me gjatësi rreth 5 cm si dhe i dëmtuari A. ka pësuar plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e pasëm të kokës, cikatrikse (vrraja) në regjionin e sipërm të vetullës së djathtë me gjatësi 0.6 cm, cikatrikse (vrraja) me gjatësi rreth 2 cm në regjionin e sipërm të gishtit të tretë të dorës së djathtë, të cilat lëndime janë klasifikuar si lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme në shëndet për dy të dëmtuarit,

- me çka duke vepruar në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale “Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 31, të KPRK-së.

III. I pandehuri N.G.

-Me datë 28.04.2022, rreth orës 20:30, në fshatin Volljakë K. Klinë, në kundërshtim me nenin 5 të Ligjit për Armë (Ligji nr.05/L-022), posedon pistoletën e llojit TT, ngjyrë të zezë, me nr. serik, me karikator dhe dy fishekë, në atë mënyrë që, natën kritike i pandehuri kryen veprat penale të përshkruara si në këtë aktakuzë, të cilën pas kryerjes së veprës penale e fsheh në vend punishten, “.....”, e që më pas arma dhe pjesët tjera përcjellëse sekuestrohen nga policia,

- me çka ka kryer veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata konform nenit 38, 40, 42, 69, 70, 76, neni 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 31 të KPP-së, nenit 173 par. 1 nën par. 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, neni 366 par 1 të KPRK-së, nenit 366 par.3 të KPRP-së, si dhe nenit 364 të KPP-së, të pandehurit i :

G J Y K O N

1.Të pandehurin N.G.

I. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së. Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 28 (njëzet e tetë) vite.

II. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite. Dhe

III. Për veprën penale, “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve”, nga neni 366 par. 1 të KPRK-së Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 1 (një) Viti

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit N.G. i shqipton:

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej, 28 (njëzet e tetë) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga dt.28.04.2022 e tutje, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

2. Të pandehurin B.1 G.,

I. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite.

II. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) vite.

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit B.1 G., i shqipton:

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej, 15 (pesëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga dt.28.04.2022 e tutje, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

3. Të pandehurin A.G.,

I. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 11 (njëmbëdhjetë) vite.

II. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëkryerje”, nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje 6 (gjashtë) vite.

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit A.G., i shqipton:

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej, 15 (pesëmbëdhjetë) vite, në të cilin dënim do të llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga dt.28.04.2022 e tutje, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

4. Të pandehurin A.G.1,

I. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite.

II. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëkryerje”, nga neni 173 par. 1, nën par. 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite.

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit A.G.1, i shqipton:

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej, 13 (trembëdhjetë) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim, nga dt.28.04.2022 e tutje, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

5. Të pandehurin B. G.,

I. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 31, të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) vite.

II. Për veprën penale, “Vrasje e rëndë e mbetur në tentativë e kryer në bashkëkryerje”, nga neni 173, par. 1, nën par. 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, Gjykata i shqipton dënim me burg në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite.

Konform nenit 76 të KPRK-së, të pandehurit B.G.1, i shqipton :

Dënim unik me burgim në kohëzgjatje prej, 13 (trembëdhjetë) vite, në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt.28.04.2022 e tutje, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit, obligohen secili veç e veç, që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguajnë shumën prej 100(njëqind) euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi

Të pandehurit obligohen secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 100 ((njëqind), në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Të pandehurit obligohen secili veç e veç, të paguajnë, taksën për programin e kompensimit të viktimave të krimit, në shumë prej 50 (pesëdhjetë)euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Konform nenit 366 par.3 të KPP-së, **KONFISKOHET-** pistoleta e llojit TT, kalibër 7.62x25mm, me ngjyrë të zezë, me nr. serik, me një karikator dhe dy (2) fishekë të pashkrepur,.

Si mjete të cilat janë përdorur në kryerjen e veprës penale, nga të pandehurit të konfiskohen, Një (1) telefon “I-phone”, Një (1) telefon “I-phone” 12, ngjyrë e zezë; Një (1) thikë, ngjyrë e zezë, me mbishkrim “Bossidun” nr. 311, Një (1) fishekë me mbishkrim të stampuar 7.62mm, TTPPU, Një (1) lopatë pune me bisht të drurit; Një (1) mjet i fortë druri me gjatësi 0.80m.

Të dëmtuarit përfaqësuesja ligjore e të ndjerit F.H.- nëna D. H., të dëmtuarit M.H. dhe A.H., për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohen në kontest civil.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë- Departamenti për Krime të Rënda, ka ngritur aktakuzë PP/L.nr.142/2022 të dt.03.02.2023, ndaj të pandehurve, N.G., B.G., A.G., A.G.1, dhe B.G.1, për shkak të dyshimit të bazuar mirë së kanë kryer veprat penale, në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nënpar 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje, “vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPPRK-së, i pandehuri N.G. edhe për shkak të veprës penale, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i pandehuri Y.G., për shkak të veprës penale, “ndihma në kryerjen e veprës penale vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, po ashtu për shkak të veprës penale, “ndihma në kryerje e veprës penale, vrasje e rëndë e mbetur në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 33 të KPRK-së, si dhe veprës penale “mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së

Gjykata, me dt. 28.02.2024, 05.03.2024, 06.03.2024, 02.04.2024, 25.04.2024, 12.06.2024, 13.06.2024, 26.07.2024, ka mbajtur seancën publike të shqyrtimit gjyqësor, në prezencë të Prokurorit të Shtetit, Lumturije Vuçetaj, të pandehurit N.G., mbrojtësit të tij av. E.K.sipas autorizimit, të pandehurit B.G., mbrojtësit të tij av. R.G.sipas autorizimit, të pandehurit A.G., mbrojtësit të tij av. N.D.sipas autorizimit, të pandehurit A.G.1, mbrojtësit të tij av. G.K., sipas detyrës zyrtare, të pandehurit B.G.1, mbrojtësit të tij av. G.K.sipas detyrës zyrtare, dhe të pandehurit Y.G., mbrojtësit të tij av. T.R.sipas autorizimit, të dëmtuarit M.H., A.H.dhe përfaqësuesit të autorizuar të dëmtuarve, av. F.K..

Meqenëse të pandehurit nuk e kanë pranuar fajësinë, Gjykata shqyrtimin gjyqësor e vazhdoi me procedurën e të provuarit, fillimisht me fjalën hyrëse të palëve, pastaj me administrimin e provave personale, me dëgjimin e dëshmitarëve- dëmtuarve, M.H., A.H.dhe të dëshmitarëve, E.B., Q.G., V.G., I.B., L.B.dhe A.T., janë dëgjuar edhe ekspertet T.H.- ekspert i balistikës, V.Sh.- eksperte e daktiloskopisë, Dr. N.U.-ekspert mjeko ligjor, dhe eksperti B.M.- ekspert në AKF- në Prishtinë, më pas janë administruar provat materiale si: Raportet e shpejta të policisë, të përpiluara nën nr. të rastit: 2022-DE-203 të dt. 28.04.2022 dhe 29.04.2022; Fotografitë të armës së konfiskuar; Raporti i oficerit Isa Raci #1340, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 28.04.2022; Raporti i hetuesit Xhevdet Kryeziu #1978, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 28.04.2022; Raporti i hetueses Saibe Shala #3679, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 28.04.2022; Raporti i hetuesit Riza Mahaj #5661, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 29.04.2022; Deklarata e të pandehurit A.G., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve në Klinë, me dt. 28.04.2022; Deklarata e të pandehurit B.G., e dhënë pranë Stacionit Policor - Njësitit të Hetimeve në Klinë me dt. 29.04.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 29.04.2022 (*telefoni i të pandehurit B.G.*); Deklarata e të pandehurit B.G.1, e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 29.04.2022; Deklarata e të pandehurit A.G.1, e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë me datë 29.04.2022; Deklaratat e të pandehurit N.G., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë me dt. 29.04.2022; Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 29.04.2022

(*pistoleta e konfiskuar nga i pandehuri N.G.*); Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 28.04.2022 (*telefoni i të pandehurit A.G.*); Raporti mjekësor me nr. 8237 i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë - Emergjencia, në emër të F.H.j; Raporti mjekësor me nr. 1441 i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga QKMF “Nënë Tereza” në Klinë, në emër të F.H.j; Raporti mjekësor me nr. i dt., i lëshuar nga QKMF “Nënë Tereza” në Klinë, në emër të M.H.; Raporti mjekësor me nr. 8236 i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë - Emergjencia, në emër të M.H.; Raporti mjekësor me nr. 8238 i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë - Emergjencia, në emër të A.H.j; Raporti i hetuesit Besnik Qupeva, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 28.04.2022; Raporti i oficerit Ragip Bytyqi #2900, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 28.04.2022; Raportet e hetuesit Imer Hylaj #4217, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203, të dt. 29.04.2022, 04.05.2022, 05.05.2022, 11.05.2022; Raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj #5554, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 29.04.2022; Raporti i hetuesit Riza Mahaj #5661, i përpiluar nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 29.04.2022; Fotografi të te pandehurit A.G.1; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit M.H., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 11.05.2022; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit A.H.j, e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 11.05.2022; Deklarata e dëshmitarit E.B., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 12.05.2022; Deklarata e dëshmitarit L.B., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 13.05.2022; Deklarata e dëshmitarit A.T., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 13.05.2022; Raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj #5554, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203 i dt. 06.05.2022, mbi shikimin dhe analizimin e video-incizimeve të siguruara nga kamerat e sigurisë të restorant “.....” K. Klinë dhe një (1) CD; Raporti i hetuesit Imer Hylaj #4217, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, i dt. 04.05.2022, mbi shikimin dhe analizimin e video-incizimeve të siguruara nga kamerat e sigurisë të restorant “.....”, K. Klinë dhe tri (3) CD; Raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes, i përpiluar me nr. TKRP-22/27, dt. 12.05.2022; Fotoalbumi i vendit të ngjarjes; Raporti i ekzaminimit të automjeteve të përdorura nga të pandehurit, i përpiluar nën nr. TKRP-22/27, dt. 16.05.2022; Fotoalbumi i ekzaminimit të automjeteve; Listat e dëshmitave, të përpiluara nën nr. TKRP-22/27; Skica e vendit të ngjarjes dhe tabela e matjeve, të përpiluara nën nr. 2022-DE-203, dt. 28.04.2022; Fotoalbumi mbi kryerjen e autopsisë të viktimës F.H.j, nën nr. ref MA22-128, dt. 29.04.2022, Akt-ekspertimi mjeko-ligjor me nr. ref: PE-34, dt. 29.05.2022 i përpiluar nga Dr. N.U., mbi konstatimin e lëndimeve të pësuar nga të dëmtuarit M.dhe A.H.j; Deklarata e dëshmitarit I.B., e dhënë pranë DRP- Sektorit Rajonal të Hetimeve në Pejë, me dt. 18.05.2022; Përgjigja e ILECU-t nën nr. I-1123-22-17 e dt. 01.06.2022; Raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj #5554, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 05.05.2022, mbi kontrollimin sipërfaqësor të telefonit, pronë e të pandehurit B.G.; Raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj #5554, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 27.05.2022, mbi shikimin dhe analizimin e listingjeve të siguruara nga kompania telefonike “VALA”, si dhe listingjet bashkëngjitur dhe një (1) CD; Raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj #5554, i përpiluar nën nr. të rastit: 2022-DE-203, dt. 03.06.2022, mbi shikimin dhe analizimin e listingjeve të siguruara nga kompania telefonike “IPKO” dhe një (1) CD; Raporti i autopsisë me nr. ref: MA22-128, dt. 29.04.2022; Raporti i ekspertimit me nr. ref: AKF-2022-0244, dt. 16.06.2022 dhe një (1) CD; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit M.H., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 21.09.2022; Deklarata e të dëmtuarit/dëshmitarit A.H.j, e dhënë pranë Prokurorisë

Themelore në Pejë-DKR, me dt. 21.09.2022; Deklarata e dëshmitarit I.B., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 22.09.2022; Deklarata e dëshmitarit E.B., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 23.09.2022; Deklarata e dëshmitarit L. B., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 26.09.2022; Deklarata e dëshmitarit A.T., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 26.09.2022; Raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin daktiloskopik të dëshmimeve nga AKF-ja me nr. AKF/2022-2020/2022-1946 i dt. 26.09.2022; Raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin e dëshmimeve nga AKF-ja me nr. AKF-2022-0244 i dt. 11.10.2022; Raporti i ekspertimit të dëshmimeve nga Sektori i Serologjisë dhe ADN-së nga AKF-ja me nr. AKF/2022-2020/2022-1945 i dt. 26.10.2022; Raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin balistikë nga AKF-ja me nr. AKF/2022-2020/2022-1947 i dt. 14.12.2022; Deklarata e të pandehurit B.G., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 05.01.2023; Deklarata e të pandehurit N.G., e dhënë pranë Prokurorisë Themelore në Pejë-DKR, me dt. 11.01.2023, plotësimi i raportit Autopsisë me nr. MA22-128, e dt. 29.04.2022, e plotësuar me dt. 14.02.2024, akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. ref. Nr. PE34A, e dt. 15.02.2024, për të dëmtuarin M.H., akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. ref.nr. PE34B, e dt. 15.02.2024, për të dëmtuarin A.H.j. Tri (3) raportet policore të hetuesit Enis Boshtrakaj, me nr. të rastit 2022-DE-203, të dt. 04.05.2022, raporti policor i hetuesit Enis Boshtrakaj, nr. të rastit 2022-DE-203, i dt. 05.05.2022, raporti policor i hetuesit Enis Boshtrakaj, me nr. të rastit 2022-DE-203, i dt. 11.05.2022, si dhe janë shikuar te gjitha shkresat e lëndës, pas administrimit të provave materiale të pandehurit kanë dhënë mbrojtjet e tyre.

-I dëmtuari - dëshmitari M. H., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të pandehurit i njeh si figura, ndërsa të ndjerin që ka vdek e ka vëlla, deklaroi se i ka tre vëllezër në Itali ata janë A. H., B. H. dhe E. H. ndërsa në Belgjike është A. H., A. H. dhe J. H. ndërsa në Kosovë kanë qenë tre M.H., A.H.dhe i ndjeri F.. I ndjeri F. nuk ka pas ndonjë lidhje apo ndonjë raport me të pandehurit dhe se nuk ka qenë në dijeni se vëllezërit e tij që jetojnë jashtë vendit kanë pas ndonjë problem me të pandehurit. Ditën kritike me dt. 28.04.2022, ka qenë në auto sallon e cila gjendet në fsh. K., në orën 08:00, më pas përafërsisht kah ora 10:00 apo 11:00, e ka dërguar një veturë në auto servis në Gjakovë, brenda një orë është kthyer përsëri në auto sallon. Ka shkuar rrugës që shkojnë gjithmonë rrugës Klinë-Gjakovë. Pasi që janë kthyer nga Gjakova ka komunikuar me familjen, e ka thirrur restorantin ka biseduar me dikë nga restoranti dhe ka rezervuar iftarin për 7 persona sepse të gjithë kanë qenë agjerueshem për veq fëmijëve te vegjël. Kur janë nis nga Kieva me veturë të markës Porche-panamera ka qenë ora 19:00 e diçka, dhe me të ka qenë edhe nusja e tij së bashku me tre fëmijët e tij, i dëmtuari me vete ka pasur telefonin dhe çantën e krahut që e mban gjithmonë, nuk ka pas armë, ndërsa i ndjeri ka qenë në një veturë tjetër të markës BMW4 me vëllain A. dhe nusen e . Kur kanë arrit në restorant, i dëmtuari e ka parkuar veturën afër derës së restorantit, e ka vërejt se po pengon aty dhe e ka parkuar në anën e djathtë të restorantit tek hyrja në distancë nga hyrja deri te vetura ka qenë diku 5,6 apo 10 metra, nuk e din saktë. Në këtë restorant i dëmtuari ka thënë se ka shkuar edhe me parë dhe i njeh stafin respektivisht pronarin e restorantit dhe vëllain e tij. Kur kanë hy në restorant i cili ka pas plot persona vëllai i pronarit (E.) i ka udhëzua për te tavolina, çdo gjë ka qenë në rregull, pasi që e kanë ngrënë iftar, vëllai i pronarit (E.) ka ardh iu ka thënë “*se paske honger ushqimin krejt*”, ndërsa i dëmtuari i ka thënë se “*nuk di nuk mujta me honger*”, dhe vëllai i pronarit (E.) ia ka porosit edhe një peshk dhe iu ka dërgu 4 pije nga shtëpia (prej shpisë), aty kanë qendru derisa

kanë ngrënë iftarin- darken nuk e din saktë se sa, për afërsisht një orë. I dëmtuari ka thënë se nga restoranti i pari ka dal vet ai së bashku me djemtë e tij, thotë se ka qenë mbrëmje mirëpo ka pas ndriçim, dhe pasi që kanë dal dy djemtë e tij i kanë mbajtur çelësat e veturave dhe i kanë qel përnjëherë veturat. Në atë kohë fëmijët kanë qenë të moshës 10 dhe 11 vjeçare, ndërsa fëmijun e vogël që e ka mbajtur bashkëshortja ka qenë i moshës 7 muajshe. Kur kanë dal nga restoranti, janë drejtuar në drejtim të veturave së bashku me dy djemtë e tij, në atë moment para se të arrijnë i dëmtuari tek vetura e ka dëgjuar një zë, ka bërë treguesin e M., duke thënë: “ruju se të mbyten”, kur e ka kthyer kryet pas, i ka parë 3 apo 4 vetë duke vrarë në drejtim të tijin. Pastaj e kanë goditur të gjithë me mjete të forta, që kanë qenë kacija, mjetet e punës, stupca etj dhe i kanë shkaktuar një plagë në shpinë, me zinxhir e kanë goditur në kokë, i dëmtuari ka treguar se i ka humb vetëdija, nuk është rrëzuar, në ato momente është kthyer pas veture, ku të pandehurit i kanë sulmuar vëllezërit e të dëmtuarit duke i goditur, dhe në ato momente i dëmtuari e ka kapur një guri në tokë dhe është drejtuar në drejtim të tyre, këtu të pandehurve, dhe në atë moment e ka dëgjuar një zë duke thënë: “vraje” ai zë ka qenë i një personi që ka qenë tek dera e restorantit tek Pisha ai personi që ishte afër dera, ka ndërtuar me dorë në brez, dhe non stop e ka vëzhguar gjendjen ka kanë goditur personat tjerë nuk ka marr ndonjë veprim, këtë person i dëmtuari ka thënë se e njeh dhe ai është B.G. e të cilin i dëmtuari e ka njoftuar nga rasti. I dëmtuari M.H. nuk e din se cili nga të pandehurit e ka goditur me armë zjarri kur e kanë plagosur vetëm e ka ndërtuar zërin duke i thënë tjetrit vraje duke e goditur dhe me armë e kanë plagosur në këmben e majtë. Në momentin kur e kanë goditur me plumb ka vrarë nga dera e restorantit, ku në pjesën e derës së restorantit, tek hyrja e restorantit, e ka parë një person tu bo me duar dhe duke thënë: “vraj”. Ka hyrë brenda në restorant dhe ka thënë: “a ka Zot dhe a ka njerëz se del na ndihmon se mbarum”. Në atë moment kur është kthyer përsëri të dal nga restoranti të shkojë tek vëllezërit, i ka parë vëllain e ndjerë ka qenë i shtrirë në tokë, në pjesën e djathtë të parkingut të restorantit, ndërsa A. ka qenë gati i shtrirë në tokë, duke u goditur nga të pandehurit me mjete të forta non stop, ndërsa fëmijët, njëri kishte hyrë në restorant, ndërsa tjetri ka hyrë brenda në restorant, pasi që i dëmtuari ka dal nga restoranti ka kërkuar ndihmë, pastaj ka dal vëllai i pronarit E.B., është munduar të i ndajë, nuk ka pas mundësi sepse të pandehurit derisa e kanë kry të vetën nuk janë ndal duke goditur dhe njërin nga të pandehurit e ka ndërtuar i dëmtuari duke thënë “se na u koçit arma, se gjithëve ju kishim vra” dhe ka shprehur në mënyrë banale dhe para se të përfundojë përleshja, i ka dëgjuar personin që ka qenë me armë duke ju thënë të tjerëve, lëshomani, duke aluduar për A., sepse sipas të dëmtuarit qëllimi ka qenë që ta vrasin A.. Më pas të pandehurit janë nisur të hyjnë në veturë, nuk e din saktë por i duket se ka qenë Pikap, i verdhë, dhe kur kanë hyrë në pikap, shoferi i pikapit A. i ka dal nga dera e shoferit të veturës edhe njëherë dhe i ka shprehur të gjithëve rend dhe ju ka thënë “krejtve kam me ju vra”. Pastaj kanë hyrë të gjithë në pikap, dhe rrugës kanë kaluar përmbi trupin e të ndjerë Fazli ku me pas ka vrarë A. dhe e ka tërhequr zvarrë të ndjerin, për të mos e shkelin me pik-up të ndjerin. Të dëmtuarit nuk i kujtohet se a ka shkuar edhe personi i cili ka vëzhguar situatën me të pandehurit e tjerë me pik-up sepse kanë vrarë së bashku me A. për të vëllai i tyre i ndjerë i cili ka qenë i moshës 22 vjeçare e të cilin e ka dërguar së bashku me të dëmtuarin tjetër A. me veturën e tyre të markës Porche për në QKMF në Klinë ku i është ofruar ndihmë të ndjerit F.. Prej ku edhe është dërguar me autoambulancë për në stacionin Regjional të Pejës. Tutje i dëmtuari ka deklaruar se më parë nuk ka biseduar asnjëherë me vëllezërit e tij për ndonjë problem që mund të kenë pasur me njërin nga vëllezërit e të pandehurve në Itali.

I dëmtuari – dëshmitari, A.H.j, gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, të pandehurit nuk i njeh. I dëmtuari ka thënë se në vitin 2020, ka ardh në Kosovë nga Italia, dhe në vitin 2021, në Shtator ka filluar punën në Auto Sallon, i cili gjendet afër rrugës kryesore në drejtim Dollc-Gjakovë në anën e djathtë. Ditën kritike, gjegjësisht dt. 28.04.2022, ka shku në auto sallonin në orën 08:00 të mëngjesit, e ka hap auto sallonin, ka filluar punën si çdo ditë, pasdite nuk e din sa ka qenë ora, kanë shkuar me vëllain e tij M. në Gjakovë, kanë bisedu me vëllain me shku me honger iftar me familje, edhe e kanë lenë me hëngër darkë-iftar me familje, sepse ka qenë ramazan, rezervim e ka bërë vëllai i tij M.. Kanë shkuar në restorant diku kah ora 19:00. Në restorant ka shkuar më veturën e tij, se bashku me të fejuarën e tij, dhe i ndjeri F.H., ndërsa i dëmtuari M. ka qenë me veturën tjetër së bashku me nusen e tij, dy djemtë e tij dhe vajzën e vogël. Punishten në atë kohë nuk e ka ditur se ku gjendet mirëpo tani e di, për të shkuar në restorant prej auto sallonit duhet me kalu kah punishtja, po i dëmtuari ka thënë se as që e ka ditë ndonjëherë se familja G., apo vëllezërit G. e kanë punëtorinë aty. I dëmtuari ka thënë se në atë restorant, ka qenë edhe herrave tjera. Atë natë në restorant kan qendru ndoshta një orë, apo një orë e gjysmë, nuk e din saktë dhe me të përfunduar darkën si dhe pagesën të cilën e ka bërë i dëmtuari – vëllai M., ku pastaj janë nisur të dalin nga restoranti. I pari ka dal M. nga restoranti, pas tij ka dal nusja e tij, M. ka qenë me dy djem para, nusja e tij ka qenë me vajzën e saj pas tij, i dëmtuari A. ka qenë me të fejuarën dhe me të ndjerin F.. Kanë ec me të fejuarën dhe me vëllain e tij tani të ndjerë F.. Para se me dal nga restoranti, i dëmtuari A. ka hy ne banjo e cila është ne anën e djathte për i pastru duart, në ato momente ka ndi do zhurma zëra të meshkujve duke bërtit jashtë në oborr, ka dal nga banjo dhe nga restoranti ka shkuar në drejtim të zhurmës ku pas shpinës e ka ndegju duke bërtit një person “o vrani, o vrani” dhe e ka pa të ndjerin F. duke e godit mbi tre persona duke i goditur me mjete të forta, si lopatë, zinxhirë, shkop dhe gjëra tjera duke e goditur F. dhe M., ka qenë natë po ka pas ndriçim se ka pas drita të restoranti po nuk ka mundur ti identifikoj se a kanë qenë të rinje apo me të vjetër po ashtu nuk i kujtohet nëse këta persona kanë pasur kapela apo maska. Pasi që ka dal nga restoranti i dëmtuari përshkruan veprimet e tija kur i ka parë vëllezërit e tij në atë gjendje ka shkuar tek vëllezërit e tij për mi i largu personat të cilët kanë qenë duke i goditur M. dhe F.. M. dhe F. nuk kanë pasur ndonjë mjet në duar e as nuk kanë pasur me vete armë. I dëmtuari shton se kur ka shkuar afër për me e zbraps sulmin në ato momente e ka kap njërin nga sulmuesit dhe në atë çast, e ka ndi vëllain e tij M., “o më kapi plumbi”. Si dhe në atë moment e ka ndi një zë tjetër, “o vraje edhe këto , o vraje edhe këto”. Të dëmtuarit i kujtohet se zëri ka ardh nga pas, si dhe e di se e ka pas edhe një person në anën e majtë, dhe e ka ndi një zë, “ o lëshom, o lëshom ta vraj edhe këto” këto zëra kanë ardh nga personat që ishin aty duke sulmuar dhe kanë gjujt në drejtim të dëmtuarit ku i dëmtuari ka treguar se plumbi i ka shku shumë afër kah fytyra. Njeri nga sulmuesit e ka pas armen nuk e dine se qfarë lloji të armës ka pas por në bazë te asaj qka dinë ka thënë se ka qenë armë e shkurtë, mirëpo nuk i njeh në bazë të tipit. I dëmtuari e ka ndegju një zë, duke thënë “o gjuaje në kry”. Ne ato momente i dëmtuari nuk ka pasur mundësi të dij se ku kanë qenë M. dhe F. sepse tre persona kanë qenë përmbi të dëmtuarin dhe e kanë godit, me lopatë me zingjir, e kanë godit në trup, në kokë dhe gjithë trupin. Pas gjithë këtyre goditjeve, i dëmtuari i ka ndëgju një apo dy të shtëna me armë, dhe ka degjuar njërin nga të pandehurit kur ka thënë “o ikni se na u blloku alltija”, por prapë nuk janë ndalur duke e godit, duke e sulmu të dëmtuarin A.. I dëmtuari ka thënë se e di se në fund i kujtohet afër hyrjes së restorantit nonstop kanë sjell mbi të, njëri ia ka marr lopatën tjetrit dhe ka fillu prapë me e sulmu e kanë godit me lopatë në pjesën e fytyrës dhe të kokës dhe

në atë moment e din se është ofruar kamarieri, vëllai i pronarit që ka tentu të ndajë sulmin, ndërsa personi që i ka thënë ec prej këtuhi në atë kohë nuk e ka njoft. Por është i bindur se ky personi është tani axha i vëllezërve G. me emrin B.1. I dëmtuari A. ka shtuar se edhe vet ai ka pësuar lëndime trupore si çarje të kokës, çarje të vetullës, çarje të gishtit, por në ato momente ka menduar vetëm për të ndjerin Fazli që ai të shpëton. Në fund i dëmtuari ka deklaruar se pas rastit që ka ndodh asnjëherë nuk kanë biseduar me familjaret e tij për arsyen pse ka ardh deri tek kjo për çfarë arsye erdhi që ditën kritike u sulmuan nga vëllezërit G., duke thënë se as ai vet nuk e din arsyet pse janë sulmuar.

Dëshmitari, E.B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se punon si udhëheqës i punëtorëve si menaxher në restorantin në fsh. Volljakë, vëllai i tij Ismeti është shefi ndërsa aty punojnë e gjithë familja. Të pandehurit nuk i ka njohur dhe as sot nuk i njeh, ndërsa të dëmtuarit M. e ka njoft, ndërsa A. dhe F. nuk i ka njoft. Të dëmtuarin M.H. e njeh se edhe më parë ka shku në restorant si mysafirë dhe e kanë shërbyer, asnjëherë nuk kanë pasur problem me të. Ditën kritike me dt. 28.04.2022 dëshmitarit i kujtohet se ka pas rezervim nga i dëmtuari M.H. me familje e vet për iftar, sepse thotë se ka qenë nata e madhe e Ramazanit dhe atë ditë dëshmitari ka qenë duke punuar si kamarier dhe e ka shërbyer M. dhe familjen e tij, përveç familjes H. ka pasur edhe mysafirët e tjerë në restorant. Tutje dëshmitari ka tregu se hyrja kryesore është para restorantit ku hyjnë mysafirët, është edhe hyrja kah kuzhina, mirëpo aty hyjnë vetëm personeli nuk është hyrje për mysafirë, është edhe një hyrje para restorantit kah bahqja, këndej hyjnë edhe mysafirët. Hyrja e dytë hyn në terasë dhe nga terrasa hyn në sallë. Ditën kritike dëshmitari ka deklaruar se mysafirë ka pas edhe në terasë, kanë pas rezervime por jo të gjitha me rezervime sepse andej pihet edhe duhani. Sa i përket shërbimit dëshmitari ka thënë se ankesa nuk i kujtohet që ka pasur nga familja H. dhe kur e kanë përfunduar iftarin pagesën ia ka bërë M., ulur nga tavolina, dhe iu kanë dhënë me vete një peshk në pjatë sepse njeri nga peshqit që e kane shërby ka qenë i djegur sepse familjen H. e kanë pasur mysafirë të rregulltë. Pas përfundimit të iftarit dëshmitari nga salla është përshëndet me M.in dhe familjen e tij dhe është kthyer me ju shërby tavolinës tjetër. Dëshmitari ka thënë se në momentin tragjik nuk ka degju asgjë sepse ka qenë me mysafirë të tjerë sepse salla ka qenë plot me mysafirë veç se e ka ndegju një fëmijë i cili ka hy brenda në restorant dhe ka bërtit, pastaj dëshmitari ka dal jashtë derës së restorantit dhe i ka parë duke u rreh, ka pa M. aty, ka qenë njëri nga të pandehurit G. ka pas të veshur tesha të baustellës me lopatë në dorë, duke e rrah me lopatë M. në kokë, dëshmitari ka hyrë në mes për me i nda, ka pas edhe tjerë por nuk i kujtohet saktë. Pastaj e ka parë një të vramë në anën tjetër, sa i kujtohet dëshmitari thotë se M. ka qenë i plagosur në këmbë, ka dëgju të shtëna, mirëpo nuk është i sigurtë sa të shtëna kanë qenë. Dëshmitari ka deklaruar se pas përfundimit të ngjarjes menjëherë e kanë njoftuar policinë që ka ndodh ngjarja e cila ka ardhur vonë, është munduar me mundësi që kanë pasur me i dhënë ndihmë M. ndërsa vëllai i tij F. ka qenë i vrarë e gjithë kjo ngjarje ka zgjat 3-4 minuta. Dëshmitarit nuk i është kujtuar se sa larg ka qenë F. dhe a ka qenë vetura e të pandehurve sepse ka qenë parkingu plot me vetura. Lokali thotë se ka qenë i mbuluar me kamera dhe ndriçim por jo shumë me pamje të qartësi si me qenë dritë. Për ditën kritike dëshmitari ka thënë se atë ditë sa ka dijeni nuk kanë pranuar mysafirë nga familja G., gjithashtu ka shtuar se nuk ka qenë në dijeni as nga stafi se ditën kritike i pandehuri B.1 ka qenë brenda në restorant, familjen G. nuk i ka njoft dhe se nuk ka qenë në dijeni se vëllezërit G. kanë qenë në parking duke prit daljen e familjarëve H.. për ti sulmuar. Dëshmitari në deklarinimin e tij ka thënë

se ka dashur të ndërhyjë ti ndaj por dikush e ka shtyrë, nuk e dinë saktë por thotë se ka qenë nga familje G. dhe ka shtuar se është e vërtet se i dyshimti ka dashtë me i ra edhe këtij por që në atë kohë sulmuesi me lopatë ka ik. Tutje dëshmitari ka deklaruar se pasi përfundoi përlëshja e ka parë me sytë e tij të ndjerin F. të cilit është munduar me i dhënë ndihmë me e shti në veturë, me ato mundësi qka ka pas, se kush e ka vozit veturën nuk e din. Dëshmitari ka thënë se vëllezërve H.nuk iu ka parë asgjë në duar përveç një qantë të krahut që e ka pas M..

Dëshmitari, I.B. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, është pronar i restorantit në fsh. Volljakë, dëshmitarin E. B. e ka vëlla e i cili punon ne këtë restorant dhe kur nuk është prezentë dëshmitari Ismet e udhëheq restorantin E., Dëshmitari ka thënë se lidhur për këtë çështje ka dhënë deklarata nuk i kujtohen datat por qëndron pranë këtyre deklaratave. Lidhur me ditën kritike të dt. 28.04.2022, dëshmitari ka deklaruar se: ka kalu një kohe e gjatë, ka qenë edhe vet i ngarkuar me obligime të tija familjare, ndërsa sa i përket rastit kur ka ndodh rastit, thotë se nuk ka qene aty, ka qenë në Prishtinë bashkë me bashkëshorten, djalin e tij që e ka pas në qerdhe, ka qenë me temperaturë, dhe kanë shku dhe e kane marr nga qerdhja dhe i kanë jep terapi, në banesë kanë ndejt bashkë me bashkëshorten dhe djalin. Bashkëshortja ka qenë me ramazan dhe kanë bë iftar. Pasi kanë bërë iftar në banesë, e kanë njoftu përmes telefonit se ka ndodh një rast me rrahje në parking të restorantit dhe janë dëgjuar krismat. Momentin kur e kanë njoftuar e ka marr bashkëshorten dhe djalin dhe është nis direkt për në restorant. Kur ka arrit në restorant ka qenë gjithçka e përfunduar, vetëm policia dhe prokuroria kanë qenë aty. Dëshmitari ka thënë se ka qenë në dijeni se ditën kritike për rezervimin që e ka bërë për iftar i dëmtuari M., koha e iftarit ka qenë më e ngarkuar, sepse restoranti nuk është shumë i madh. Rezervimi është bërë tek dëshmitari nëpërmes telefonit, sa i kujtohet e ka njoftu A.T., ai e ka shënu në fletore të rezervimit, pos atij ndoshta ka mundur të dijë edhe E.B., pasi që kanë qenë duke punuar bashkë. Kur kanë arrit në restorant dëshmitari së bashku me bashkëshorten dhe djalin e tij ka thënë se ka pa policinë dhe e ka kuptuar rastin që ka ndodh, ka qenë një rast shumë i rëndë për vendin tonë, pasi që aty ka qenë restorant familjar që nuk është bërë asnjëherë një incident më i vogël. Tutje ka shtuar se ka dëgjuar se vëllai i tij E. kur ka hy për me i nda, në atë guzhëm ka mundur ta shtyjë dikush, mirëpo nuk beson se ka qenë e qëllimshme diçka ndaj E., sepse nuk ka pas lidhje me asnjërin nga familjet. Më pas dëshmitari ka shpjeguar hyrjet për në restorant si në vijim:” hyrja nga pjesa ballore që është parkingu kjo është hyrja kryesore, kurse hyrja tjetër është nga parku, apo nga lumi siç e themi. Hyrja në kuzhinë ku mund të hyjnë kuzhinierët apo pastrueset. Në atë kohë ka qenë funksionale kuzhina verore, është e hapur poshtë, kurse lartë ka mund të jetë vetëm pastruesi i pjatave, apo dikush që ka mundur të merr diçka për kuzhinë, nga terrasa e parkut për me hy ne sallën e restorantit kane qasje edhe mysafirët, nga terasa në sallë mund te këtë pamje vetëm se varet disa pozita mund të kenë sepse janë dritaret dhe mund të shihet nga dritaret.”. Pas rastit, familjar të familjes H. apo G. në restorantin e dëshmitarit, nuk ka pa, por pas tri dite, e ka marr në telefon M. dhe i ka thënë “a mundem me ardh me vëllezër dhe mixhallarë me pa vendin se ku ka ndodh”, dëshmitari iu ka thënë se “po”. Nga familja G. nuk ka qenë kërkush deri pas shumë muajve, njëri që është në Gjermani ka ardhur dhe i ka kerku falje në emër të familjes G.për rastin që ka ndodh e që për dëshmitarin ka qenë shumë vonë. Dëshmitarit nuk i kujtohet me orë se kur kanë shkuar policia për ti marë kamerat, por e din se pasi që i kanë bërë matjet aty e kanë pyet dhe i ka drejtuar tek kamerat tek DVR dhe ju ka thënë ti marrin, mirëpo nuk ka qenë i sigurve a punojnë, pasi që paraprkisht ka qenë lokali në ujë prej vërshimeve dhe kanë qenë

disa pjesë të mbuluara. Policia e kanë ftuar në polici për me e dhënë deklaratën e kanë njoftuar se kamerat janë në polici derisa të kryhet rasti.

Dëshmitari L.B.gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, ne vitin 2022 ka qenë i punësuar në, si pjatalarës, po ashtu i kujtohet dita kritike 28.04.2022, ku ai ka qenë në kuzhinë duke larë pjata dhe i ka marr disa pjata të pastruara për ti dërguar në kuzhinë poshtë, ka qenë orari i pasdites, nuk i është kujtuar saktë ora, dhe si e ka qel derën e kuzhinës për me i dergu pjatat poshtë, ka has me një veturë Pikap, ka qenë ngjyrë e kaltër i cili ka qenë në drejtim me derë të kuzhinës (kuzhina është kapur me restorant, dera e kuzhinës me derë të restorantit mundet me qenë në distancë prej 10 apo 15 metra e cila ka dalje në parkingun e restorantit). I ka dergu pjatat në kuzhinë, dhe sa i kujtohet duart i ka pas pa pjata, dhe te dera e kuzhinës, poshtë shkallëve i ka dal një person ka qenë i veshur me trenerka të poshtme dhe me një palltë, për afërsisht nuk ka qenë as fortë i vjetër, as fortë i ri, nuk e ka njohur dhe e ka pyetur se “a bon me hy në sallë brenda” dëshmitari i ka thënë se “jo sepse është e rezervuar vetëm për persona që agjërojnë iftar” ai person prap e ka pyetur “ a bon jashtë” dëshmitari i ka thënë se “po”. Ky person i ka thënë se “jashtë ftohtë” por dëshmitari nuk ka folur asgjë vetëm ika ngrite krahët përpjete ka hy në kuzhinë. Dëshmitari ka deklaruar se vutura Reno Pikap, i kaltër, i ndalur e i parkuar në pozitën rikverc për të dal nga parkingu dhe në të ka qenë një shofer a një pasagjer nuk është i sigurte sa i kujtohet se ka qenë diçka terr, pak pa u terru distanca në mes të dëshmitarit dhe veturës Pik ap ka qenë për afërsisht 4 apo 5 metra. Tutje dëshmitari ka përshkruar ditën kritike se si i ka ndi krisma të alltisë, nuk është i sigurt a i ka ndi dy apo tri krisma, në ato momente ka qenë në kuzhinë, nga ku mund të shihet dera e hyrjes së restorantit, kur i ka ndi krismat e alltisë ka dal jashtë, dhe tek dera e kuzhinës ka mbetë i ngrirë me ngjarjen që e ka pa. Duke përshkruar situatën dhe atë: “kanë qenë 3-4 personat të cilët kanë qenë para restorantit ku njëri gjujke përpjetë me allti” sa i kujtohet ka dëgjuar vetëm një krismë, tjetri ka godit me kaci ne një person të shtrirë e që ky person ka qenë i ndjeri Fazli, dëshmitari ka thënë se nuk ka par persona të tjerë të shtrirë si dhe ka pa edhe disa persona të stafit të restorantit jashtë mirëpo nuk i kujtohen se kush ka qenë. Distanca në mes dëshmitarit dhe personit që ka shtënë me armë ka qenë diku 15 metra, ose 20 metra, ndërsa në personat tjerë që ishin prezent nuk e din largësinë në mes të personit me armë dhe personit të shtrirë. Dëshmitari ka thënë se nuk ka qëndruar deri në përfundim të rastit sepse dikush e ka tërheq dhe e ka fut brenda në kuzhinë dhe jashtë ka dal pasi që kanë ik vrasësit dhe janë shku te personi i shtrirë në tokë dhe e kanë marr personin e kanë shti në veturë. Tutje ka shtuar se ka dëgjuar disa llafe pas dy ditëve se i kanë thënë dikujt në restorant që me bo me kallzu se jena ksajde, por nuk e din tani saktësisht se prej kujt i ka dëgjuar, por janë dëgjuar në restorant këto fjalë. Në fund dëshmitari ka thënë se në kohen kur ka ndodh rasti Ismeti nuk ka qenë aty, pas rastit ka shku sa i kujtohet ka shku me gruan e vet dhe me djalë.

Dëshmitari A.T., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, ne atë kohe ka punuar si kamarier në restorantin në Volljak, dhe aty e ka njohur M. se e ka pas klient, ia ka njoft edhe disa familjar, A. e ka njohur si figurë, ndërsa F. nuk se ka njoft dhe se asnjëherë me M. dhe familjaret e tij nuk ka pasur problem. Ditën kritike ka qenë në restorant në orarin pasdite, prej orës 13:00 derisa është mbyllë restoranti për afërsisht në orën 22:00-22:30, po ashtu dëshmitarit i kujtohet se ka qenë ramazan dhe ka pas shumë rezervime për iftar diku 90% me rezervime por ka edhe të tjerë që shkojnë edhe pa rezervime. Rezervimin nga ana e familjes H. është bërë tek pronari

Ismeti në telefon, pastaj I. e ka thirr në telefon dhe i ka tregu për rezervimin, dhe ia kanë rezervu tavolinën. Dëshmitari ka treguar se kanë qenë tre vëllezërit H., dy fëmijë dhe nuk e din dy apo tri gra, beson që dy. Tutje dëshmitari ka treguar se ku kanë qenë të ulur të dëmtuarit dhe atë tavolina ku kanë qenë të ulur familja e M. ka qenë brenda në sallë në qosh, nuk është afër derës së hyrjes së restorantit. Dëshmitari ka thënë se nuk i kujtohet saktë se sa ka qendru në restorant M.dhe kur ka dal nga restoranti, por beson se afër një ore, dhe i kujtohet se e ka sherby nga një pije se i ka ndihmu kolegut te tij E. Për ditën kritike dëshmitari ka thënë se, derisa ka shku një fëmijë i vogël dhe i ka thirr nuk ka dëgjuar asgjë, ky fëmijë ka qenë i vogël ka qenë familjar i familjes H.. Në momentin kur ka hyrë brenda ky fëmijë, dëshmitari ka qenë para shankit brenda në sallë, i cili është afër derës, dëshmitari ka qenë përafërsisht 10 metra larg derës së restorantit, ky fëmija ka kerku ndihmë ka thënë se “janë duke ma rehur babën”, ka qenë duke qajt. Pastaj dëshmitari ka tentu me dal jashtë me i ndihmu, momentin që është afruar afër derës, ka pas të shtëna me armën diku dy të shtëna të njëpasnjëshme dhe është kthyer mbrapa, pastaj ka shku deri tek pjesa ku i pastrojnë pjatat brenda, ku nga stafi ka qenë L. B., pjatatarësi ka tentuar përsëri me dal jashtë pas disa sekondave, ka pas përsëri të shtëna me armë dhe përsëri është kthy, ka kaluar në pjesën e sallës, ku në ato momente është futur brenda M. i gjakosur në këmbë, duke kërkuar ndihmë, e që saktë nuk i kujtohet se çka ka thënë, por e di se ka thënë “o hajde ndihmona”, dhe tani ka dal M. jashtë. Kur kam dal jashtë e kam pa edhe E.e aty janë dëgjuar edhe dy të shtëna njëpasnjëshme”. Kjo ngjarje ka krijuar shqetësim tek mysafirët që ishin prezent aty, kanë filluar të rrëzohen karika, fëmijë duke bërtitur duke qajt, Pas herës dytë kur ka dal jashtë e ka pa të ndjerin . ka qenë i shtrirë, ka qenë i mbuluar me gjak, ndërsa A., ka qenë afër tij, M. ka qenë në këmbë duke fol me telefon duke tentuar me e thirr dikën. A. dhe i ndjeri kanë qenë përafërsisht 15 metra nga hyrja e restorantit, ndërsa M. ka qenë në lëvizje në këmbë përafërsisht 5 metra nga hyrja e restorantit. Kur ka dal jashtë dëshmitari përveç këtyre personave jashtë ka qenë E. dhe ka pa një thikë, një telefon që ka qenë duke cingëruar, disa gëzhoja dhe disa monedha metalike dhe një stupc. Pastaj kanë fillu me dal nga salla edhe stafi tjetër dhe disa mysafirë, dhe vet personalisht e ka thirr prindin e tij që punon polic, pastaj menjëherë e ka thirr edhe pronarin Ismetin. Tek viktimat ka qenë A. vëllai i të ndjerit i cili ka qenë duke e mbajt disi si në prehër, e ka kap kokën e të ndjerit si në prehër, pastaj me veturë e kanë dërgu në spital, M. kur i ka gjet çelësat e veturës e kanë marr F. e kanë qit në veturë dhe kanë vazhduar. M. ka kërkuar ndihmë që dikush ta vozit veturën sepse M. ka qenë i plagosur në këmbë por prap M. e ka vozit veturën. Më pas policia në vendin e ngjarjes kanë shkuar diku 10 apo 15 minuta, pasi që ka shkuar M.i me të ndjerin F.. Tutje dëshmitari ka deklaruar se ky restorant që munden me hy mysafirët për me hy në sallë, janë dy hyrje janë për mysafirë, tri janë gjithsejtë, njërën e përdorim ne stafi. Dëshmitari nuk ka qenë në dijeni nëse dikush nga familja G. atë natë kanë qenë në parking.

Dëshmitari Q.G., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të pandehurit i njeh i ka djem të axhallareve, ndërsa Y. e ka djalë, ndërsa të dëmtuarit nuk i njeh. Tutje dëshmitari ka deklaruar se së bashku me Y. dhe familjen e tij jetojnë në Punon murator dhe aktivitetin e tij e zhvillon në fsh. ...K- ..., ku e kanë dhe pikën kryesore, aty e kanë guroren që nxirret guri dhe e dërgojnë për përpunim, në kohën kur ka ndodh rasti i kanë dërguar në fsh. Rixhevë. Ne fshatin Rixhevë punon gati që 4 vite, sepse në fsh. Volljakë është mbyll,, arsyeja pse e kanë mbyll në Volljakë, punëtorinë është sepse ka qenë duke u ndërtuar magjistranja, diku në vitin 2020, i kanë mbyll,

guroren dhe restorantin në fsh. Volljakë dhe kanë kaluar në fsh. Rixhevë me qira. Në Rixhevë nuk kanë pas vend punishte, por kur iu kanë thënë me e liru pllacin në Volljakë sepse ka pas me u ndërto një urë-mbikalim, nuk është i sigurve, mendon se kanë pas afat 7-8 ditë për me largu restorantin dhe punëtorinë fabrikën e cila ka ndodhur shumë para rastit. Pas 7 apo 8 dite, është ndal uji, rryma dhe janë larguar nga aty dhe e kanë gjet një vend me qira në fsh. Rixhevë. Në fsh. Volljakë edhe kur ekanë rrezuar restorantin makinat e gurit ende janë brenda, dhe zyrat që kanë qenë në atë, akoma janë aty me disa vegla. Ndërsa sa i përket ditës kritike përkatësisht me dt. 28.04.2022, në orën përfaqësisht 07:45, ka qenë në fsh. Kralan, ka qenë duke punuar privat, gjatë tërë ditës ka punuar në fsh. Kralan, deri në orën 18:30-19:00, kur është kthyer në shtëpi në K.. Ndërsa djali i tij Y. ditën kritike, në mëngjes në orën 07:00-07:30, ka shkuar në shkollën private mjekësisë KEKA MED, pasdite në orën 13:30 ka shku në shtëpi, dëshmitari ka thënë se çdoherë e thërret në telefon djalin e tij, Y. të cilin e ka thirrë edhe atë dit për ti thënë të pushoj të mos të del në punë pasi që ishte agjerueshem, ditën kritike me Y. ka fol vetëm njëherë përfaqësisht në orën 14:00, po ashtu ka fol me bashkëshorten e tij përfaqësisht kah mbrëmja, dhe biseda ka qenë nëse don diçka me ble për iftar, si bisedë mes bashkëshortëve. Atë natë në shtëpi kanë pasur edhe mysafirë, një familje nga fsh. Rokovinë –Gjakovë, Adnani ka qenë atë natë për iftar me bashkëshorten e tij dhe një vajzë të vogël përfaqësisht 4 apo 5 muaj. Dëshmitari ka theksuar se raportet me të pandehurit N., B., A. A.1 dhe Bahri, i kanë të mira pasi se i ka djem të axhës, sa për vizitë kanë pas shumë pak rrallë vizita, e din se njëherë ka qenë A.i, sa i kujtohet ka qene 3 vite para ditës kritike, ndërsa për tjerët nuk i kujtohet se kanë qenë. Prej se kanë dal në punëtori në fsh. Rixhevë, shumë pak janë pa me djem të axhës, Y. ka qenë në shkollë, normal se kur janë taku kanë bisedu, mirëpo nuk mund të thotë se të pandehurit kanë pas shoqëri me ta. Dëshmitari nuk ka dëgjuar asnjëherë për ndonjë mosmarrëveshje apo problem eventual që mund të kenë pasur të pandehurit me familjen H., para ditës kritike, po ashtu edhe pas ditës kritike, nuk ka dëgjuar nga askush e as nga familja e tij se ata te pandehurit mund të kenë pasur ndonjë konflikt me familjen e të dëmtuarve. Tutje dëshmitari ka theksuar se H. G.e ka vëlla dhe punon si teknik medicinal në ambulanten në Kline dhe se ditën kritike mbrëmjen e dt. 28.04.2022, H.ka qenë atë natë në ambulanten në Klinë dhe ka dëgjuar që ndihmën e parë në atë rast, ka qenë vëllai i tij H.. Tutje dëshmitari ka thënë se në Volljakë në fabrikë se janë makinat e punës, ndërsa në zyre janë gjërat të kontabilistit, disa vegla pune, ndërsa për njollat e gjakut të cilat janë gjetur në zyrën e tij ne Volljake ka thënë se ka dëgjuar se ato njolla gjaku janë të Y., duke cekur se *”para se me ndodh rasti, 3 apo 4 ditë para rastit, unë kam punuar në Kralan, ndërsa Ylli ka punu në Rixhevë, në mbrëmje, Y. vjen nga Rixheva, në Volljakë, ndërsa unë nga Kralan, kam shkuar në Volljakë, mirëpo atë ditë jam vonuar më shumë se ditëve tjera, Y. ka qenë agjërueshëm dhe unë i kam bo telefonatë dhe i kam thënë Yll po na vonon diçka pronari në Kralan, dhe ti pusho, Ylli më ka thënë është duke më dhimt koka shumë dhe mos u vono shumë sepse është koha e iftari. Unë kam ardh prej Kralanit në Volljakë, e kam marr Y. dhe jemi nis në drejtim të Klinës. Ylli pasi që kemi shkuar në shtëpi në Klinë më ka tregu, se i kanë pik hundët gjak në Volljakë, sepse i ka dhimt koka. Unë i kam bërtit i kam thënë është dasht me e prish agjërimin, dhe mos me u smu. Y. çdo ramazan ka problem me hundë”*. Tutje dëshmitari ka deklaruar se te pandehurit e kanë pllacin e vet, afër tyre, në fsh. Volljakë, dhe i kanë të ngjitura mexhat, ndërsa vëllezërit G.kanë punuar në Volljakë ku e kanë pas të ndërtuar një shupë ku kanë qenë të vendosura dy makina me të cilat prehet guri. Ndërsa lidhur me mënyrën se si është ardhur dëshmitari ne dijeni për armën e cila është gjetur në vend punishten në Volljakë, ka deklaruar se kur e kanë

thirr policia i kanë thënë se “ta kemi bastis zyrën”, dhe i kanë thënë se është gjetur arma aty ai ka dëgjuar se aty i është gjetur arma për të cilin nuk e ka ditur se çfarë lloji armesh ka qenë, se ku saktësisht e kanë gjet, pas ballafaqimit me fotot e bashkangjitura shkresave të lëndës (respektivisht fotoalbumi me nr. 44 dhe 45 në fotografinë e dytë në faqen 44), dëshmitari ka deklaruar se “sipas fotove, është gati në fund të pllacit, ku janë të vendosura disa raqe-halete të punëtorisë. janë në pllacin tim”. Dëshmitari ka deklaruar se lidhur me rastin është njoftuar nga telefoni, prej rrjeteve sociale, ndërsa nga vëllai i tij H.e ka kuptuar se djemtë e agjes janë të përfshirë në rastin, i cili i ka thënë se është një rast shumë i keq, dhe nuk kanë biseduar më dhe as nuk është takuar me H..

Dëshmitarja- V. F. – G., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se të pandehurit i njeh si kushëri të burrit, ndërsa Y. e ka djalë. Më parë kanë jetuar në fshatin, por tani që për afërsisht para 7 viteve jeton në me bashkëshortin e saj Q. dhe me tre fëmijët e saj Y., Y. dhe E., nuk është në marrëdhënie pune i kryen punët e shtëpisë. Me dt. 28.04.2022 thotë se ka qenë tërë ditën në shtëpi, atë ditë Y. ka qenë në shkollë paradite nga ora 07:30 dhe është kthyer në orën 13:30, ndërsa tere pasditen ka qene ne shtëpi. Y. nuk është dal atë ditë nga shtëpia. Y. kur është kthyer nga shkolla, ka pushu dhe i ka ndihmua dëshmitares Vahide në oborr me heq barin. Dëshmitarja thotë se ditën kritike respektivisht gjate pasdites nuk ka shkuar askush ne shtëpi te tyre, bashkëshorti i saj Q., ka qenë atë ditë në punë. Dëshmitares i kujtohet se atë ditë ka qenë ramazan dhe e gjithë familje kanë agjëruar përveç djalit të vogël dhe se atë ditë (ditën kritike) kanë ngrënë iftar e gjithë familja se bashku, po ashtu dëshmitarja ka treguar se Y. gjithmonë e mundon Ramazani dhe se nuk ka qenë mire me shëndet , njehërit ka thënë se atë ditë kanë pasur mysafirë shokun e bashkëshortit A. H. nga fsh. K- Gjakovë se bashku me bashkëshorten e tij, A.1a H.. Dëshmitarja shton se Y. përveç shkollës punon çdo ditë me gurë me babain e tij. Arsyeja pse i kujtohet kjo ditë dëshmitarja thotë se i mban mend të gjitha sepse atë ditë ka ndodhur ngjarja (rasti) për të cilin ka dëgjuar në shtëpi nga burri dhe nga krejt familja që kanë qenë aty. Dëshmitares nuk i kujtohet se sa kanë qëndruar mysafirët mirëpo e di se kanë qenë aty kur kanë dëgjuar për rastin.

Eksperti i balistikës T. (A.) H., gjatë shqyrtimit gjyqësor se ka deklaruar se me profesion është ekspert i balistikës, të pandehurit nuk i njeh. Është përpilues i raportit të ekspertimit i cili mban dt. 14.12.2012, me AKF/2022-2020/2022-1947 dhe qëndron pranë këtij raporti, kësaj ekspertize dhe i qëndron konstatimeve të dhëna në këtë ekspertizë. Eksperti tutje ka theksuar se ka pas në ekspertim dëshmitë të cilat janë cek në faqe 2 të këtij raporti, të cilat janë konstatu se 4 gëzhoja me kal.7.62 X25mm, janë shkrepur prej pistoletës evidentuar si dëshmi #19, po ashtu kanë qenë edhe dy fishekë të kalibrit të njëjtë në ekspertim. Sa i përket llojit të armës eksperti e ka deklaruar se kjo lloj armë bën pjesë në armët e shkurtra, është prodhuar në fabrikën e emërtuar Norenko, në shtetin e Kinës, në vitin 1954 dhe për atë quhet “Type 54”. Arma në fjalë pistoletë si objekt ekspertize ka qenë plotësisht funksionale dhe nuk ka paraqitur asnjë pengesë në funksionimin e saj, gjatë testeve balistike. Pistoleta si objekt ekspertimi e ka poseduar karikatorin, kur ka arritur për ekspertim, karikatorin nuk ka qenë i vendosur në armë, veç tjerash në këtë rast kanë qenë edhe dy fishekë, të cilat nuk kanë qenë të vendosur në karikator, por si të ndara. Vetëm kur shkrepet fisheku, mbetet gëzhoja, në këtë rast këta dy fishekë të cekur më lartë nuk kanë qenë të shkrepur. Tek ky lloj i armës, shpejtësia e daljes së predhës nga tyta është 420 metra për sekondë,

ndërsa temperatura nuk e kanë konstatu sepse mund të jetë specifike e prodhuesit, por si ekspert e dinë se kaq shpejtësi zhvillon predha në momentin e daljes nga tyta. Po ashtu edhe sa i përket gëzhjës temperatura mund të jetë specifike dhe varësisht nga prodhuesi. Ndërsa për përcaktimin se sa mund të arrij temperatura e gëzhjës në momentin kur hedhet eksperti ka deklaruar se nuk mund të përgjigjet sepse kjo nuk ka qenë si kërkesë me rastin e ekspertimit, gjatë përvojave të tyre në AKF, nuk kanë përcaktua temperaturë të gëzhjësve asnjëherë.

Ekspertja e balistikës V. (L.) Sh., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se, me profesion është juriste punon në AKF si eksperte e gjurmëve të gishtave-daktiloskopisë, të pandehurit nuk i njeh, në AKF punon që nga viti 2004 si eksperte e daktiloskopisë, deri me tani ka të përfunduara 2500 raste. Në AKF punojnë me standarde evropiane, laboratorit i tyre është i akredituar me standarde evropiane ISO17025, që janë laboratorë të akredituara dhe të mbikëqyra nga zyra e auditimit të Kosovës. Ekspertja ka deklaruar se është përpiluese e raportit të ekspertimit të dt. 26.09.2022, me nr. AKF/2022-2020/2022-1946, dhe qëndron pranë përmbajtjes dhe konstatimit të bërë në këtë raport. Tutje ekspertja ka përshkruar mënyrën se si pranohen dëshmitë për ekspertim duke thënë se të gjitha dëshmitë që pranohen në AKF, fillimisht pranohen në zyrën e provave, aty bëhet paketimi në prezencën e hetuesit të rastit, evidentohen të gjitha dëshmitë dhe mbyllën me shirit ngjites, si dhe nënshkruhen nga ana e hetuesit që i ka sjell, dhe numri i ID dhe data kur është bërë paketimi, këto dëshmi ekspertet shkojnë në dhomën e dëshmive i marrin, ekziston sistemi LIMS, dhe përmes sistemit LIMS i marrin dëshmitë, shton se gjatë ekspertimit përveç dëshmive, gëzhjësve ka pas në ekspertim, edhe një mjet të fortë druri, një thikë e zezë me gjatësi rreth 7 cm dhe një lopatë pune me bisht druri. Ekspertja tutje ka deklaruar se sa i përket deklaramentit të saj, të cekur në faqen 3 të ekspertizës në rubrikën konstatimi dhe mendimi përfundimtar, në rreshtin e fundit ka konstatuar “se nuk janë nxitur –zhvilluar asnjë gjurmë e vijave papilare”, e që në rastin konkret janë përdorur metodat adekuate të cilat përdoren në laborator për sipërfaqet poroze dhe jo poroze, në këtë rast kanë përdorur kimikalin super ngjitesin cyano crylate, kjo metodë përdoret në sipërfaqet jo poroze, siç është qelqi, hekuri etj, po ashtu në dëshmitë 5 dhe 26, ku kanë qenë një mjet i fortë druri dhe një lopatë me bisht druri, është përdorur metoda e ninhidrinës me anë të spërkatjes që është metodë për sipërfaqe jo poroze. Dhe përdoret për letra, për dru të papërpunuar etj. Ekspertja në fund ka deklaruar se faktorët që mund të ndikojnë në mos gjetjen e gjurmëve të gishtave-vijave papilare në dëshmitë e ekzaminuara, shkencëtarisht ka shumë faktorë, ndër to janë temperatura, lagështia, reshjet atmosferike varet, po ashtu një ndër faktorët është edhe dorëzat, nëse janë përdorur dorëzat, nuk dalin gjurmët e gishtave, po ashtu ka persona që nuk djersiten shumë nuk tajojnë djers në duar-duart i kanë të pastra, mund të jetë edhe koha deri sa të vijnë në ekspertim. Në laboratorit i përdorin metodat që mund ti zbulojnë edhe gjurmët që janë deri 20 vjet të vjetra me anë të kimikaleve që i përdorin. Ndërsa gjurmët e freskëta merren edhe në vend të ngjarjes me anë të pluhurave.

Eksperti N. (R.) U., gjatë shqyrtimit gjyqësor se ka deklaruar se punon në institutin e mjekësisë ligjore që nga Shtatori i vitit 2008. Tutje ka deklaruar se është përpilues i autopsisë të ndjerit F.H. e evidentuar nën shenjën MA 22-128, dhe qëndron pranë të njëjtit në tërësi. Eksperti në raportin e tij të ekspertizës ka konstatuar se gjatë ekzaminimit të jashtëm trupor është konstatuar një plagë tej shkuese me vrimën hyrëse në regjionin e zgavrës së syrit të majtë, e cila plagë është plaga vdekje pruese, trajektorja e së cilës ka dëmtuar organin vital jetësor-trurin, duke shkaktuar

gjakderdhje trurore e si pasojë vdekjen dhe eksperti përshkruan ne detaje vrimën hyrëse dhe dalëse te predhës si ne vijim: në regjionin e kapakut të sipërm të syrit të majtë, është konstatuar vrima hyrëse nga predha e hedhur nga arma e zjarrit , e cila ka drejtim nga majtas djathtas dhe pjerrtas , nga lartë poshtë, në drejtimin e pjesës së pasme të veshit të djathtë. E që i bie se arma me të cilën është shtënë ka qenë pak më lartë se vrima hyrëse dhe dalëse. Në faqen 3 të raportit të autopsisë, te ekstremitetet e sipërme dhe të poshtme është e përshkruar edhe dëmtimet trupore që janë konstatuar si rezultat i veprimit të grimcave të barotit gjatë hedhjes së predhës nga arma e zjarrit, të cilat janë shoqëruar me djegie të imta lëkurore, e që në bazë të praktikave tona mjeko ligjore, kualifikohen në plagë rezistuese të të ndjerit. Kjo plagë e evidentuar dëshmon se distanca e qitjes nuk ka qenë më e madhe se 1 metër nga tani më i ndjeri. Sa i përket pozicionit se ne çfarë pozicioni ka qene personi gjatë qitjes, ka thënë se nuk ka të dhëna të mjaftueshme, në bazë të cilave do të mund të deklarohet lidhur me pozicionin e qitjes përveç se e shtëna ka ndodhur nga ana e majtë e të dëmtuarit, në të djathtë, predha ka shku prej majtas në të djathtë, ndërsa nuk mund të din se i dëmtuari a ka qenë ulur apo në këmbë. Tutje eksperti ka deklaruar se bazuar në fotot që i ka foto me nr. 24, pasi është pastruar trupi, nuk konstatohet ndonjë dëmtime tjetër trupor përveç njollës kufomore, që ndryshe quhet për ngjyrim apo libiditet kufomor që paraqitet si rezultat i qëndrimit të trupit në njërën anë si rezultat i stazave të gjakut menjëherë pas vdekjes. Ndërsa për foton me nr. 23, nga raporti i autopsisë në regjionin e sipërm të djathtë, të shputës së këmbës së djathtë, shihet gjak mbledhje nën lëkurore me formë ovale të çrregullt, dhe për ngjyrim të kuqërremtë në të mbyllur, që mund të korrespondojë me ditën e incidentit. Plagët që janë të dukshme në fotografitë e raportit të autopsisë, me nr. 11 dhe 12, e cila gjendet në regjion e sipërm të majtë ballor, ka formë të një vije lineare me për ngjyrim të kuqërremtë, dhe me besueshmëri deklaroi se është shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit mbrehtës(jo i mbrehtë), sikur edhe plaga tjetër e cila është evidentuar në fotografinë me nr. 10, e cila duket në formë të vijës lineare në raport me vetullën e syrit të djathtë , është shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit mbrehtës (jo i mbrehtë). Ka shtuar se gjatë procedurave të autopsisë nëse gjenden çfarëdo pjese e predhës së hedhur nga arma e zjarrit, fotografohet skicohet dhe evidentohet si në raportin e autopsisë, në rastin konkret nuk kemi konstatuar asnjë pjesë të mbetur nga e vetmja predhë që është hedhur nga arma e zjarrit. **Ndërsa lidhur me lëndimet e te dëmtuarit M.,** eksperti ka shtuar se i dëmtuari M.H. ka plagë tej shpuese me armë zjarri në regjionin e kërcirit të majtë ka thënë se akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. ref. PE nr. 34, i kryer me urdhëresë të prokurorisë themelore në Pejë, është akt ekspertim mjeko ligjor në bazë të dokumentacionit të çështjes, gjatë dhënies së mendimit kanë në dispozicion raportet mjekësore, dhe varen krejt nga përshkrimi i mjekut përkatës që e ka kryer vizitën mjekësore dhe ka përpiluar raportin mjekësor pas vizitës. Në përshkrimin e raportit mjekësor me nr. 8236, i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga Spitali i përgjithshëm në Pejë, figuron diagnoza mjekësore vulnus sklopetarium transpenetrans, regio cruris sim , cum exorationes cutis auri culae sim , që do të thotë nga latinishtja vrima në plagën e M.është tej shkuese e cila ka kuptimin që e ka vrimën hyrëse trajektoren dhe vrimën dalëse, e cila plagë atakon të paktën indet e buta (muskulin), kurse ajo përshkuese e ka kuptimin e përshkimit të sipërfaqësor të lëkurës dhe indit nën lëkuror. Në raportin e spitalit të përgjithshëm në Pejë përveç diagnozës përfundimtare është e evidentuar edhe provat se të njëjtit i është kryer rëngeni i konckave të gjurit dhe të kërcirit që ka rezultuar pa veçori patologjike si dhe rëntgeni i kokës, i cili po ashtu ka rezultuar pa veçori patologjike, po ashtu ekziston e dhëna se i njëjti ka refuzuar hospitalizimin. Për plagën që është konstatuar

në regjionin e kërcirit, ekzistojnë të dhëna të mjaftueshme që dëshmojnë që është rezultat i veprimit dinamik i predhës të hedhur nga arma e zjarrit, kurse dëmtimi tjetër i regjistruar në vazhdimin e diagnozës si gërvishtje lëkurore në regjionin e laprës së veshit të majtë, është shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit të fortë, mbrehtës, (jo të mbrehtë). Në mungesë të përvojës së tyre mjeko ligjore, raste shumë të rralla shënohen faktorët plotësues të qitjes, nga mjekët e lëmive të tjera, kurse në rastin konkret nuk kanë pasur konstatim të prezencës të faktorit plotësues të qitjes, në mungesë të të cilit përshkrim nuk mund të deklarohej për distancën e qitjes. Ndërsa sa i përket të dëmtuarit A. eksperti ka deklaruar se edhe mendimi mjeko ligjor për dëmtime trupore të të dëmtuarit A.H.j, është dhënë bazuar në dokumentacion mjekësor, i cili dokumentacion mjekësor është evidentuar me nr. 8238, i dt. 28.04.2022, i lëshuar nga spitali i përgjithshëm në Pejë, e në të cilin është vendosur diagnoza mjekësore, e njëjta është përshkruar latinisht e që e ka kuptimin plagë shqyese ndrydhëse në regjionin e pasme të kokës. Përveç diagnozës mjekësore është konstatuar se i dëmtuari ka refuzuar qepjen e plagës.

Eksperti B. M., gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se në Agjencinë e Kosovës për Forenzikë jam i punësuar që nga viti 2005. Eksperti ka deklaruar se dëshmitë të cilat janë cekur edhe në raportin nga nr. 1 deri nr. 26, janë përdorur metodat që janë përdorur në rastin në fjalë për analizën e ADN-së janë metodat e pranuar të cilat përdoren edhe në laboratorë të vendeve të ndryshme të botës. edhe për pajisjet vlen e njëjta përgjigje, do të thotë janë të pranuar dhe aplikohen apo përdoren nëpër laboratorë të ADN-së nëpër vende të ndryshme të botës. Nga dëshmia me nr. 26#Y.G, e kam nxjerr profilin e ADN-së së personit Y.G., mostër ka qenë mostër referent pështymë nga Y.G.. Sa i përket gjasës së paraqitjes së profilit në populacion, kur është fjala tek pika 4 faqe 6, atëherë ky profil sipas kalkulimit statistikor ka dal që shpeshësia e tij në populacionin botëror është 1 në 141 triljard individ, që nënkupton se ky profil është përputh me profilin e ADN-së së Y.G.. Tutje eksperti ka thënë se nga dëshmia #1, që është një gëzhgojë e fishekut, është fituar një profil i përzier i ADN-së nga së paku dy persona dhe kur është bërë krahasimi me profilet e ADN-së së A.H.j, M.H., F.H.j, N.G., A.G.1, A.G., B.G.1, B.G.t dhe Y.G.t , atëherë të gjithë personat tjerë janë përjashtuar kurse kemi përputhje me profilin e ADN-së së Y.G. në këtë përzierje. D.m.th. njëri nga personat në këtë përzierje ka dal të jetë Y.G., ndërsa personat tjerë që i përmenda më parë janë përjashtuar. Në pikën 8 faqja 6, ku është konstatuar se nga dëshmia #25, e që i bie një fishekë, është fituar një profil i pjesërishëm i ADN-së, e që gjithë personat nga pika 1 faqes 5 të këtij raporti janë përjashtuar si kontribuues të ADN-së, personi është i panjohur , ndërsa sa i përket se a është personi i njëjtë i panjohur siç është cekur edhe në pikën 7, ky profil i pjesërishëm i ADN-së i fituar nga dëshmia #25, nuk përputhet me profilin e përzier të ADN-së të fituar nga dëshmia 1, do të thotë ky person i panjohur , profili i të cilit është fituar nga dëshmia #25, përjashtohet si kontribuues i ADN-së në dëshminë 1. Kjo nënkupton se në dëshminë me nr. #1 dhe #25 , kemi të bëjmë edhe me dy profile e ADN-së të dy personave të panjohur. Në faqen 2 të përshkrimit të dëshmimeve sipas ekspertit me numër rendor 10 dëshmia #19, një revole, një karikator dhe dy fishekë, ndërsa në pikën 11 të faqes 6 keni është konstatuar se nuk është fituar profil të ADN-së për shkak të sasisë të pamjaftueshme të ADN-së dhe kualitetit të dobët të mostrës, dhe për këtë arsye ka qenë edhe kualiteti i dobët për të fituar ndonjë profil të përshtatshëm të ADN-së. Po ashtu edhe në faqen 6 te raportit pika 4, që nga #20,#21, #22 dhe #23, që janë njolla gjaku, e përshkruar në faqen 2 nr. 11, 12 13 dhe 14, është përfituar një profil i ADN-së së Y.G.t dhe i cili përkon plotësisht me mostrën referente të

pështymës sipas faqes 2, nr. 26, përputhet me profilin e ADN-së së Y.G.t. Te profilet e ADN-së, është fjala për profilet e përziera të ADN-së, rol të madh luan se rezultati a është i plotë në të gjitha lokuset e ADN-së. Që në rastin konkret të dëshmia #1, kemi disa ramje nëse e vëreni profilin e ADN-së së dëshmisë #1, dhe krejt kjo luan rol në përputhshmërinë dhe shpeshhtësinë e paraqitjes së atij profili në popullacion. Profilet e përziera të ADN-së fitohen nga ato dëshmi në të cilat kemi apo janë të depozituar material biologjik prej më tepër se një personi. Përzierja nuk ndikon në rezultat kur rezultati i asaj përzierje është i plotë në të gjitha lokuset që ne i analizojmë. Disa lokuse tek dëshmia #1 siç e cekta edhe më herët, siç e vëreni edhe në faqen 3 të raportit dëshmia #1, rubrika lokusi SE 33, nuk ka rezultat.

I pandehuri N.G., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se, ditën kritike dt. 28.04.2022 nuk ka pas qëllim, as ai dhe asnjë vëllai i tij me ndodh rasti që ka ndodh. M.H. e njeh para rastit, për arsye se kanë punuar me gurë dhe kanë pas rastin me marr vetura me punë dhe pasi që i kanë marr veturat me punë, ju kanë ofruar mundësinë M.H. se a ka interes me i ble veturat. Dhe kemi ra në dakord me Pazar dhe jo një rast, por shumë raste kemi shit vetura të llojeve të ndryshme të dëmtuarit M.. Sa i përket A. H. dhe të ndjerin F.H. nuk i ka njoft. Tutje i pandehuri ka deklaruar se ditën kritike kanë qenë duke punuar në fsh. Meje të Gjakovës, rreth orës 17:30-18:00, e kanë lon punën në fsh. Meje dhe kanë shku tek pllaci në fsh. Volljakë, që është në magjistralen Klinikë Gjakovë dhe aty kanë shku i pandehuri N., vëllai i tij, B.G.1, A.G.1. Kanë shkuar në pllac dhe aty ka qenë vëllai A.i, aty ka qenë axha i tij I. G. dhe djali i tij I. G. dhe ata janë nda dhe kanë shku në pllacin e tyre afër që e kanë pas me qira. Duke dal nga pllaci, për me shku në restorant E. për me pi kafe dhe për ti pritur njerëzit që ishin duke ardhur nga Rugova, në lokal kanë qenë duke shkuar i pandehuri N., Bahria, A.li dhe A.G. dhe aty duke kaluar rrugën, e kanë parë veturën e M., Porsche paramera, ka kaluar para tyre, e ka ul shpejtësinë e ka qel xhamin e pasagjerit, i ka shikuar të pandehurit dhe ka jep veturës shllajf. I pandehuri N. dhe A.i kanë kaluar rrugën pasi që shkoi M. dhe vëllai A.li dhe B.G.1, e kanë marr veturën e ... dhe janë nisur në drejtim të Gjakovës dhe N.i i ka pyet “ku po shkoni”, A.li i ka thënë se “nuk vonohem hyni pini kafe se kthehem për pak”. Derisa kane qene N.i e A.i në restorant “Ermali” duke pirë kafe. A.li që e ka pas telefonin e N.it, i ka shkruar A.it, apo e ka thirr nuk i kujtohet dhe i ka thënë thuj “N.it merre Pikapin dhe hajde tek parkingu i restorantit Ujvara se na është prish vetura”. N.i e ka lënë A.in në restorant, e ka marr Pikapin, ka shkuar tek parkingu i restorant Ujvarës dhe aty ka qenë B. dhe A.li. Aty N.i i ka pyet “se çka ka kerri”, dhe A.li i ka thënë se “nuk është në rregull nuk po e merr gazin”. N.i i ka thënë që ta lojnë në parking, të hyjnë të pijne nga një kafe tek restoranti Ujvara e Mirushës, mirëpo aty ka pasur tollovi, ka pasur aheng apo diçka, dhe aty kur janë dal prej parkingut të restorantit Ujvara e Mirushës, N.i iu ka thene se “po e lojmë kerrin në parking të restorantit dhe po shkojmë tek restoranti, dhe po pijmë nga një kafe dhe po shikojmë se çka po bojmë me kerr”. Kur janë shku tek restoranti me pikap, duke u parkuar, dritat e pikapit kanë reflektuar në veturën e M.H. dhe aty nuk janë hy me pi kafen, N.i iu ka thënë të pandehurve se koka M.H. këtu dhe nuk bën me hy me pi kafe se i njeh dhe e din që ka problem me ta pastaj në pikap kanë qëndruar N.i, B.a dhe A.li. Tutje i pandehuri N. ka thënë se në pikap në parkingun e restorantit, kanë qëndruar 10 -15 minuta, dhe aty ka dal M.H. nga restoranti. Nga vetura ka dal vëllai i te pandehurit A.li, pas tij ka dal i pandehuri dhe aty ka fillu përleshja në mes M. dhe të pandehurve. Në përleshje e sipër M.H. e ka pas çantën përpara, gjatë përleshjes e ka nxjerr armën prej çante dhe ka gjujt në tollovi. M. e

ka shkrep armën në tollovi dhe aty është vrarë vëllai i tij, tashmë i ndjeri F.H., pa dëshirën e M.H.s. Gjatë përleshjes i pandehuri A.1i, e ka godit në dorë M.H.me shklop dhe aty i ka ra arma në tokë. Nga frika se mos të i vriste e ka kap armën nga toka, ka lëviz me armë, por nuk e ka përdorur armën, sepse nuk ka dit me përdor armë, sepse kur në jetën e tij nuk ka përdorë armë. Pas rastit që ndodhi, i pandeuri N. së bashku me vëllezërit e tij Bahri dhe A.1in kanë shku tek pllaci në fsh. Volljakë, ku aty edhe e kanë lënë armën. Atë natë është arrestuar përafërsisht 40 minuta deri në 1 orë pas rastit dhe ka dhënë deklaratë në polici në orën 00:30 të natës, sa i kujtohet, që i bie data 29.04.2022. Edhe një herë i pandehuri deklaroi se ditën kritike nuk ka pas në posedim armë, dhe as që e ka përdor armën. Tutje i pandehuri gjate ballafaqimit të tij me deklaratën e dhënë në polici me dt. 29.04.2022, në orën 12:00, në faqen e 2, rreshti i fundit, në orën 12:00 ka filluar intervista dhe në rreshtin e fundit të faqes së dytë, duke vazhdu në tre rreshtat e parë të faqes së tretë në fillim, ku i pandehuri ka thënë se : “derisa ishim duke u rrahur kam pa se njëri vëlla ma kishin sulmuar dy prej tyre dhe ishim në tub, ashtu unë kam shkrep alltinë në drejtim të tyre, një herë dhe pastaj edhe një herë. E kam pa kur F. ka rënë për tokë dhe ka mbet i shtrirë me plumbin e dytë nuk e di a e ka rrok M., por kam gjuajt këmbëve”, për te cilin deklaram i pandehuri ka deklaruar se nuk është e vërtetë se ka deklaruar ashtu, këto janë supozime të kota. I pandehuri ka thënë se pyetje i ka bërë një polic, apo hetues nuk e din, ka shënu, mirëpo i pandehuri nuk e ka dëgju se çka ka shënu, mirëpo në fund ia ka dhënë me nënshkru deklaratën apo procesverbalin dhe jo diçka tjetër, e te cilin nuk e ka lexu me zë vetëm i është ofruar procesverbali për nënshkrim. -Tutje i pandehuri N.G., lidhur me ditën kritike ka thënë se problemi ka nis në mes të vëllezërve të M. në Itali, dhe vëllait të tij E. G.1 në Itali, për shkak të një borxhi prej 300 euro, se kinse vëllai i të pandehurit ia ka pas vëllezërve të M., Pas këtij rasti M.H., e thirr në telefon vëllain e të pandehurit E1. e kërcënon e shan në mënyrë banale dhe i thotë “ke mu detyru me e lëshu Italinë”, pasi që E1. ia ka tregu të pandehurit N. se ka bisedu me M. rreth ngjarjes, N.i e ka thirr në telefon M., e ka përshëndet si shok, si tezak dhe i ka thënë se çfarë problemi kanë vëllezërit e tij me vëllain e të pandehurit në Itali, ku M.H. i thotë për shkak të një borxhi, N.i i ka thënë M. fol me vëllezër, thirri në telefon nuk kan punë me E1., sepse une jav japi 300 euro. M.H. i ka thene N.it, se vëllai juaj E1. ka me u detyru me e lëshu Italinë, nga ai moment nuk ka pas asnjë kontakt me M.. Nuk kanë kaluar dy javë, B. H., vëllai i M.H. e ka thirrë E1. në Itali dhe i thotë E1. që ka shku në Itali, dhe ku po pijmë kafe. Vëllai i të pandehurit E1. kur del prej banese me shku me u taku me B. ne Itali, aty midis rruges i dalin 4 apo 5 vetë dhe e rrahin vëllain E1. në prezencë të bashkëshortes dhe djalit 7 apo 8 muajsh dhe E1. e bëjnë për spital. I pandehuri N. ka thënë se kjo ka qenë motivi për me rreh M. sepse jo vetëm nga fakti se vëllezërit e tij e rrehen E1. në Itali, por M.përsëri bënte provokime të llojeve të ndryshme. Pasi që mbrojtësi i të pandehurit N. ka përfunduar pyetjen ne drejtim të mbrojturi të tij, i pandehuri N.G., deklaroi se nga aj moment do të mbrohet në heshtje.

I pandehuri B.G., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se të akuzuarit tjerë i ka djemtë të vëllait, ndërsa Y.G. e ka djalin e djalit të axhës, të dëmtuarit M.H. dhe vëllezërit e tij, ka thënë se para rastit nuk i ka njoft asnjërin, ndërsa këtu të dëmtuarit M.dhe A.H., i ka njoft vetëm pasi që i ka parë në gjykatë. Ditën kritike me dt. 28.04.2022 është zgjuar ka honger pak mëngjes, ka ra prapë me pushu sepse ishte i lodhur, nuk e din pastaj ka dal në një shitore në fsh. Sverk dhe është taku me disa kushëri, njëri kishte ardhur nga Italia, dhe kanë filluar me pi birra me atë kushëririn D.G.,

dhe një kushëri tjetër. Aty në shitoren në Sverk kanë qëndruar deri në orën 20:00 përafërsisht, mirëpo nuk është krejt i sigurve për orën. Pastaj është nda nga kushërinjtë e tij, ka shku tek shtëpia e tij përafërsisht rreth orës 20:00, është ulë me honger bukë me familje, ata vetëm e kishin pas kry iftarin, i ka thënë djalit apo vajzës shtima telefonin me u mbush sepse iu ka ndal se nuk kishte rrymë në telefon. Nuk ka vonu shumë dhe është aktivizuar-ndezur telefoni, e ka pranuar një thirrje prej A.G.t, këtu të pandehurit, nuk është i sigurve a e ka thirr në numër apo në rrjetet sociale, dhe i ka thënë xhaxh a po vjen me më dërgu deri tek, së pari i pandehuri B.1 ka hezituuar sepse ka pasur me u zgju herët dhe i ka thënë se po priton, mbasi që i ka thënë edhe njëherë se kanë shku ata djemtë për vëllezër të vet me pi kafe tek, e më duket ishte M.aty e po tutna se po bojnë fjalë apo ndonjë send, B.1ka shkuar në Volljakë në vend punishten e A.it, e ka marr A.in dhe është nis për ta derguar A.in në restorantin “.....”. Kur kanë shku aty, A.i e ka pa veturën e vet të parkuar tek Pastaj kanë dal nga kerri afër ku ishte parkuar vetura e A.ite llojit Fiat. A.i ka thënë se nuk qenka Pikapi këtu, mos janë shku në restorantin Pasi nuk është larg në, veturën e te pandehurit B.1 e kane lënë aty dhe kanë shkuar në këmbë, nga ai parking në restorantin Si kanë hyrë në hymje të oborrit të restorantit, A.i i ka thënë të pandehurit se qe ku qenka Pikapi. Tani ka dal nga pikapi nuk e din sigurve a ka qenë N.i, apo cili nga vëllezërit, mirëpo i duket se ka qenë N.i të cilit i ka thënë se “nëse doni me bo fjalë mos më merrni në qafë”. N.i iu ka përgjigj se jo nuk e kemi mënden me bo fjalë me askënd por jemi ardh me pi kafe. Pastaj A.i i ka thënë B.1shko hin brenda në restorantin, porosite një kafe sepse edhe ne po vijmë, B.1 është nis me shku në restorant, thotë se nuk ka pasur logjikë të shëndoshë sepse ka qenë i dehur, dhe ka filluar për me shku me hy në restorant, e ka kap rrezen e derës së restorantit, me sa i kujtohet e ka hap derën, një kamarier i ka thënë se më fal se është e rezervuar. B.1i ka thënë kamarierit se a ka vend dikund tjetër, kamarieri i është përgjigjur, jo këtu ska vend dhe B.1është kthy. Kur është kthy, pak pa shku tek djemtë e vëllait, tash nuk i kujtohet se a i ka thënë një kamarier tjetër se ka vend në terasë me pi kafe. Pastaj ka shkuar tek këtu të pandehurit dhe ju ka thënë se po shkon në terasë, sepse brenda nuk kishte vend dhe është nis pas kamarierit për me shku në terasë. Nuk është i sigurve se kah ka hy në terasë, ama është i sigurve se nuk ka hyrë nga dera e restorantit në terasë, është shku është ul në terasë dhe e ka porosit një kafe. Kafja si ka shkuar ende, nuk i kujtohet saktë sa minuta, vetëm e ka ndi një krismë, pas pak çasteve e ka ndi edhe një krismë, nuk e di a ka qenë një apo dy krisma dhe është ngrite nga aty dhe ka fillu nëpër sallë me dal jashtë restorantit me e pa se çka po ndodh. Kur ka dal tek shkallët e restorantit, e ka pa një njeri të shtrirë përballë shkallëve, kurse tre katër vet në anën e majtë kanë qenë duke u përleshur. Aty e ka pa se janë djemtë e vëllait të tij. Nuk ka zgjat shumë ajo përleshje dhe nuk e din sepse ka qenë i dehur dhe është shtangë sepse e ka kap njëfarë panike dhe vetëm ka ndejt si me qenë i pitë pa reagu asgjë aty e ka pare edhe A.ini cili nuk ka pasur arme zjarri ne duar. Me sa i kujtohet e ka pa pikapin e djemve të vëllait të tij kur është larguar nga parkingu i restorantit. B.1 thotë se ka qëndruar edhe pak aty dhe ka hy brenda në sallë. Tutje i pandehuri B.1 ka deklaruar se për së fundi herë kur ka dal nga restoranti, pas ngjarjes, është nis me shku në shtëpinë e tij, nuk e din më kah ka shkuar, por pasi që i ka pa video incizimet, atëherë e ka vërejt se ka shku edhe në restorant, arsye pse nuk e din se kah ka shkuar ka qenë për shkak të stresit dhe në ndikimin e alkoolit. I pandehuri ka thënë se ka qenë në njohuri për problemin që e kanë pas familja e vëllait të tij, me njërin nga vëllezërit H. në Itali dhe thotë se është e vërtet se vëllai i të pandehurve E1.është në Itali, me të cilën në Shkurt të vitit 2022 është taku sepse e ka djalë të

vëllait, është takuar edhe në Klinë, ka qenë edhe baba i E1., është takuar edhe në shtëpi. Me sa i kujtohet takimi ka qenë pas rastit që ka ndodh në Itali. Gjate takimit me E1.i pandehuri ka thënë se bisedë nuk kanë bërë mirëpo ka ra biseda aty dhe E1. i ka thënë hiq punë se nuk ka qenë asgjë. B.1 thotë se nuk e ka zgjat më shumë sepse ka menduar se E1. nuk po don që B.1 të dijë më shumë dhe nuk e kanë zgjatë më. Në atë kohe i pandehuri ka poseduar telefonin ajfon me sim kartelë 049/350-084 dhe i njëjti i është sekuestruar nga ana e policisë. Në këtë telefon i pandehuri ka thënë se e ka pasur një mesazh që e ka pa pasi që ka shku në polici respektivisht mesazhin “ej po të pres te rruga”, e që sipas të pandeurit ka të bëjë me rrugën për me shku tek vend punishtja me e marr e me dergu tek

I pandehuri A.G.1, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se me të dëmtuarin M., A. dhe te ndjerin F.H. është njohur edhe para ditës ktitike. I pandehuri ka thënë se ditën kritike ka qenë duke punu në Meje të Gjakovës së bashku me vëllezërit e tij A.in, B. dhe N.in. Kanë punuar deri kah ora 17:30 përafërsisht ora 18:00, A.i e ka lënë punën më herët për arsye se e kishte lënë takim me disa shokë nga Rugova për çështje pune. Ndërsa të tjerët e kanë përfunduar punën, kanë shkuar tek pllaci, e kanë takuar A.in aty dhe kanë vendos që të hyjnë me pi kafe në restorantin E2. Duke tejkaluar autostradën për me dal tek restoranti, ka shkuar M.H. me veturë Porsche ngjyrë e kuqe, i cili ishte në shpejtësi, e ka ndal shpejtësinë, e ka hapur xhamin e veturës dhe i ka shikuar, pastaj e ka mbush kerin shllajf, nuk e ka ndi se ka fol diçka. Aty kanë vazhdu kanë pi kafe në lokal A.1i, A.i, N.i dhe B.. Kanë pi kafe pastaj kanë pas që të takohen me pronarin e punës, që ishin duke punuar në Meje të Gjakovës, A.1i dhe B. janë nisë, për me shku në Gjakovë për me u taku me pronarin e punës që ishin duke punuar në Meje të Gjakovës. E kanë marr veturë Reno Clio, A.1i ia ka marr telefonin vëllait të tij N.it, për arsye se nuk ka pas bateri në telefonin e tij. N.i ka ndejt tek pllaci me A.in për me i prit myshterinjtë për punët që kishin marr. Pastaj janë nisur me Bahrain që të shkojnë në Gjakovë, pasi që e kanë kaluar ujëvarën e Mirushës, janë kthyer sepse ju është prish vetura. Janë shkuar me vështirësi deri tek Aty e ka kontaktuar vëllain e tij A.in i ka thënë “thuj N.it merre Pikapin e hajde tek Ujëvara sepse na u ka prish kerri”. Pastaj për pak minuta ka shku N.i dhe e kanë vendos që të pijnë kafe tek Janë afruar deri afër për me hy në restorant, por ka qenë si tollovi dhe kanë vendos që të shkojnë tek E kanë parkuar veturën përmbi parking të Ujëvarës dhe kanë shkuar tek Duke u parkuar në parking e kanë parë veturën e M., e cila ishte në parking. Kanë qenë në pritje 10 apo 15 minuta për të biseduar me M. dhe për t’ia dhënë 2 apo 3 flakaresha, sepse M. me vllaznin e vet i kanë ra vëllait të pandehurit, në prezencë të gruas dhe djalit të vëllait. Me flakaresha ka nënkuptuar me ia dhënë dy apo tri shuplaka. M.ka dal i pari prej restorantit, pas M. ka dal i ndjeri F., pastaj ka dal A., ka fillu përleshja, i pandehuri i ka ra M. si person, pastaj ka shku një vëlla i M. dhe i ka ra të pandehurit, nuk e dinë cili ka qenë, edhe në ato momente M.H. e ka nxjerr revolen nga çanta dhe ka gjuajt dy herë në drejtim të A.it dhe N.it, përderisa N.i ishte i mbjami duke ardhur. Pastaj A.1 ka qenë duke u përlesh me një vëlla të M., nuk e din cili ka qenë, e ka pa se M. e ka armën në dorë. Përderisa A.1i ka qenë duke u përlesh iu ka shmangur atij personi që ishte duke u përleshur me të dhe i ka ra në duar M.H.s, i cili e kishte armën në dorë hala, i ka ra arma nga dora, është përkulur N.i që ta merr armën nga toka, është mundu M. prapë e ka shty për me marr armën, Në ato momente e ka marr N.i armën prej tokë, por nuk e ka pa se ka gjuajt në drejtim të ndokujt. I pandehuri ka thënë se ditën kritike kur e ka parkuar automjetin te restoranti i lartcekur nuk e ka pa automjetin e M.H. dhe nuk e ka dite se i njëjti me familjen e tij ndodhen aty. Tutje

i pandehuri ka thënë se dikush i ka ra atij nuk e din M. apo A. cili ka qenë, pastaj i ka ra shkopi në tokë, dhe për afër për 1 minutë ka qenë si pa vetëdije, një javë apo më shumë e ka pas shpinën zi, sepse ka pas lëndime. I pandehuri ka deklaruar se as ai e as vëllezërit e tij nuk kanë pasur armë me vete dhe nuk kanë pasur plan as qëllim për ta privu dikënd nga jeta, por qëllimi ka qenë aty për aty me ia jep dy tri flakaresha M.H.. Pasi që mbrojtësi i të pandehurit A.1, ka përfunduar pytjen në drejtim të mbrojturi të tij, i pandehuri A.G.1, deklaroi se nga aj moment do të mbrohet në heshtje.

I pandehuri A.G., ka deklaruar se nuk e ka dit se natën kritike ka vdekur një person në rastin e ndodhur, këtë fakt e ka kuptuar pasi që e ka marr policia, pasi që e ka dhënë deklaratën, policia i ka tregu se është një vrasje. Tutje i pandehuri ka deklaruar se ditën kritike pasi që është kthyer nga Gjakova ku ishte me shoqen dhe me fëmijët, prej atyhit e ka marr rrugën për tek punëtorja ku ka punuar në fsh. Volljakë me veturën e tij Reno Clio. Ka pas për mu taku me një person për punë, tek punëtorja ka shkuar pasdite nuk i kujtohet ora. E ka kryer me atë person bisedën për çështje pune, pasi që ka shkuar ai person i pandehuri ka qenë së bashku me vëllezërit e tij, B., A.1i, N.i, axha i tij I., ka qenë sepse punojnë bashkë, kanë qenë tek punëtorja duke e përgatitur do material për punë dhe në ato momente nuk i kujtohet ora sa ka qenë, ka kaluar M. me veturën Porsche dhe kur ka shkuar drejt më punori ku kanë punuar të pandehurit, e ka ndal veturën sepse nuk ka qenë duke ec shpejtë dhe e ka hap dritaren dhe i ka ofendu dhe i ka kërcënu dhe i ka dhënë sllajf kerrit. A.1i dhe vëllai B., e kanë marr veturën Reno Clio dhe janë nis në drejtim të Gjakovës, dhe i kanë thënë A.it “po shkojmë po takohem me M. dhe po e pyesim pse edhe na ke rreh vëllain edhe prapë nuk po i ndal kërcënimet ndaj neve”. A.i ka qëndruar në punëtori 40 minuta, deri 1 orë pasi që kanë shku vëllezërit e tij. Pasi që vëllezërit e të pandehurit kane shkuar në këtë periudhe kohore dikush nga vëllezërit nuk e din cili e ka thirr A.in apo i ka dërgu sms nuk është i sigurte dhe i ka thënë se M. qenka tek Në ato momente A.i nuk ka pasur veturë aty dhe e ka thirr në telefon apo messenger axhën B.1 dhe i ka thënë axhës së tij, “a po vjen deri tek punëtorja në Volljakë se kanë shku ata djemtë me u taku me M., dhe po tutna mos po bojnë problem, a ka mundësi me ardh me më dërgu mu deri tek villa dhe kthehu shko në shtëpi”. B.1 ka shku tek A.i në punëtori me automjet të tipit BMW, nuk e din se sa është vonuar dhe janë nisur për tek, B.1 ka qenë edhe në ndikim të alkoolit bukur shumë, rrugës i pandehuri A. i ka thënë B.1 “ mujshim me shku ma shpejtë e ti ndali ata djemtë se mos po bojnë problem”. Kur kanë shkuar tek villa, Park automjetin e B.1 e kanë lënë në parkingun e një lokali të S.B., në Volljakë. Nga aty ku e kanë parkuar veturën, në këmbë janë shku deri tek, dhe i kanë pa vëllezërit e tij që ishin me Pikap, A.i ka hy nga dera e pasagjerit në Pikap dhe është ul përpara. Iu ka thënë vëllezërve të lejnë e të mos bëjnë problem edhe axha B.1 iu ka thënë amoni ju koft mos të bojnë problem. Axha B.1 ka desht me hi në sallë me pi kafe dhe një punëtor, kamarier apo nuk e din, i ka thënë axhës se është vetëm me rezervime. B.1 në ato momente ka shku në terasë të me pi kafe. Tutje A.i ka thënë se atë dite nuk ka pasur armë me vete e as vëllezërit e tij thotë se nuk kanë pas, ato mjete që janë përdor në vendin e ngjarjes nga te pandehurit thotë se ato kanë qenë mjetet e punës që punojmë, ka qenë lopatë dhe një bisht i krampes. Gjatë rrëmujë-rrahjes, ka dëgjuar dy apo tri krisma të armës. Nuk e ka pa kush ka gjuajt. I pandehuri ka thënë se ditën kritike prej orës 18:20 deri pak pas incidentit në mes të pandehurit A. dhe të pandehurit N. apo B., i ka 62 thirrje-hyrje dalje, ka thënë se nuk ka kontaktuar, vetëm ka thirr mirëpo nuk ka arrit me bisedu me ta. Dhe nëse ka biseduar ndonjëherë

ka thënë se ka biseduar vetëm për çështje pune. Pas përfundimit të incidentit, pasi që janë hy në automjet, së pari kanë shkuar tek punëtorja në fsh. Volljakë, prej punëtorisë kanë shkuar në shtëpinë e babait të tij dhe vëllezërve të tij në fsh. Sverkë. I pandehuri A.i e pranon se në mes vëllezërve të tij dhe vëllezërve të M. ka ekzistuar një problem. Pasi që mbrojtësi i të pandehurit A., ka përfunduar pyetjen në drejtim të mbrojturi të tij, i pandehuri A.G., deklaroi se nga ai moment do të mbrohet në heshtje.

I pandehurit B.G.1, në mbrojtjen e tij ka deklaruar se vetëm M.H. e ka njohur para ditës kritike, kanë punuar me gurrë dhe kanë marr disa vetura me punë prej klientëve, edhe ia kanë shitur M.. Tutje i pandehuri ka përshkruar ditën kritike se kanë qenë në punë në Meje të Gjakovës, kanë qenë me A.lin, me N.in dhe A.in. A.i ka lëvizur gjatë procesit të punës, sepse e ka pas bashkëshorten e sëmurë. Kanë punu deri në orën 18:00, në Meje të Gjakovës, kanë fillu me A.lin dhe N.in me shku tek pllaci në Volljakë, kanë shku tek pllaci aty, aty ka qenë A.i vëllai me disa mushteri të Rugovës së Pejës, duke biseduar për punë. Kanë fillu me dal në restorantin E.2, B., A.i, N., A.li dhe ata myshterinjtë prej Rugovës së Pejës. Duke shkuar në lokal ka shku M. me veturë, dhe i ka provokuar në mënyrë banale të panevojshme me disa sllajfa, e ka zvogëlu shpejtësinë kur i ka pa të pandehurit duke kaluar asfaltin i ka jep gaz dhe ka jep shllajf, nuk ka fol, ka qenë vetëm. M. e kanë parë kur te pandehurit ishin duke shkuar në restorant, pastaj ne kanë shku në restorant, kanë qëndru dikund 40 minuta deri 1 orë. A.li është dal i pari nga restoranti E.2. I pandehuri ka dal pas A.lit dhe i ka thënë A.lit ta marrim Renon , që të shkojnë deri në Meje të Gjakovës, sepse kanë pasur me u marr vesh me myshterinjtë që kanë punuar. E kanë marr veturën Reno dhe janë nis me A.lin në drejtim me shku në Gjakovë, diku përtej, gjatë rrugës kerri nuk ka qenë diçka në rregull. A.li i ka thënë se kerri nuk është ka bon diçka. I pandehuri i ka thënë A.lit kthehu këtu, janë kthyer qashtu qysh kanë mujt ngadalë, dhe janë shku në parking të E kanë lënë veturën në parking të, nuk e din a e ka thirr apo i ka shkru A.li, N.it duke i thënë, merre Pikapin dhe hajde në parking të “.....”. Ka shku N.i me Pikap, i kanë hek disa vegla prej Renos, disa mjete të punës, i kanë vendos në Pikap. Iu ka thënë vëllezërve A.lit dhe N.it, a të hyjmë të pijmë kafe tek, kur kanë shku deri në gjysmë të oborrit, kanë ndegju muzikë, si zhurmë, si darsëm në N.i iu ka thënë a të shkojmë tek restoranti të pijmë kafe. I kanë thënë po po shkojmë. Janë shku me Pikap, janë hy në oborr të restorantit, duke parkuar dritat e Pikapit bie në veturën e M.dhe i pandehuri iu ka thënë vëllezërve se “vetura e M. koka këtu”. Pas diku pas 15 minuta, ka dal M. nga restoranti dhe të pandehurit gjatë kësaj kohe kanë qenë në Pikap dhe i pandehuri iu ka thënë “unë dal e merrna vesh me M.”. I pandehuri ka thënë se ai nuk ka pas me vëllezër të M. asgjë, mirëpo ka pas me M.. I pandehuri tutje ka thënë gjatë kohës pasi që ka ndodh rasti më vëllain e tyre, së paku tri herë në ditë M.ka shku kah pllaci i të pandehurve dhe ka hy në pllacin e tyre dhe aty ka shllajfit me veturë duke vazhduar deri tek një pompë e derivateve më poshtë dhe prapë është kthyer. I pandehuri ka thënë se nuk e ka kanë ditur se M. atë natë ka qenë me familje në Restorante. I pandehuri ka mohuar faktin se ai e ka goditur te ndjerin F. duke thënë se as që e ka parë dikund, duke shtuar se ai e ka sulmuar vetëm A. me lopatë dy herë nga pas, kur e ka pa duke u përlesh me A.in. Aty ia ka kap lopatën dikush nga dora, edhe nuk e din, dhe dikush nga pas i ka ra me diçka dhe ka fillu drejtë ka shku deri në Pikap ku ka ndejt në Pikap. I pandehuri ka thënë se as ai e as vëllezërit e tij atë ditë skanë pas armë.

Pasi që mbrojtësi i të pandehurit Bahri, ka përfunduar pytjen në drejtim të mbrojturi të tij, i pandehuri B.G.1, deklaroi se nga aj moment do të mbrohet në heshtje

I pandehuri Y.G., në mbrojtjen e tij ka deklaruar se jeton në Klinë që 4-5 vite, punon me gur, përafërsisht dy vite është mjeshtër i gurit ku kryesorja është në fshatin fsh. Sverk, ku e nxjerrin gurin, ndërsa e përpunojnë në fsh. Rixhevë. Para fsh. Sverkë, e kanë pasur në Volljakë, por që 4 apo 5 vjet nuk është i sigurtë, nuk punojnë aty. Në fsh. Volljakë, akoma gjenden makinat, mirëpo meqenëse nuk ka rrymë dhe ujë nuk janë kushtet me punu. Me dt. 28.04.2022, ditën kritike: në mëngjes si zakonisht ka shku në orën 08:00 në shkollë, deri përafërsisht kah ora 13:30, ka qenë në shkollë, më pas ka shku në shtëpi ku ka qenë nëna, vëllai dhe motra e tij. Në shtëpi ka pushu pak sepse ka qenë me Ramazan, i kujtohet se e ka rregullu pak barin në oborr, dhe e ka prit iftarin dhe ka bërë iftar në shtëpi. Atë ditë nuk është dal nga shtëpia në qytet. Atë ditë pas mësimi, si zakonisht edhe atë ditë e ka thirrë babën në telefon, i cili ka qenë në punë po në cilin vend nuk i kujtohet. Sa i kujtohet për rastin e ka marr vesh nga rrjetet sociale. Në fillim nga rrjetet sociale, ndërsa më vonë i ka treguar edhe axha i tij H. G.. Axha i tij H. ka qenë në shërbim teknik medicinal në QKMF në Klinë në urgjencë. Tutje i pandehuri ka deklaruar se ishte me punëtorë në punëtori në Rixhevë tri apo katër ditë para rastit. Në ora 17:00 e kryejnë punën të gjithë, i kanë dërgu disa punëtorë në fsh. Sverkë, ndërsa i pandehuri ka zbrit në Volljakë, e ka telefonu babën, për me shku me u bo bashkë në fsh. Volljakë për me shku për iftar në shtëpi. Baba ka qenë duke punuar në një fshat Kralan në Gjakovë, dhe i ka thënë se “vonohem pak sepse pronari i shtëpisë po më vonon pak”, i ka thënë “hyn pusho ose në veturë, ose në zyrë në fsh. Volljakë”. I pandehuri me veturën Golf II ka shku në zyrë në punëtorinë e quajtur Buka prej Guri në pllacin në fsh. Volljakë, ka hy në zyrë ka pushu pak. Në momentin kur është ngritur si shpejtë i kanë qit hundë gjak si shumë dhe aty në zyrë nuk ka pas as ujë as palloma. Gjaku i ka pike në tokë, është mundu me e fshi me këmbë dhe mandej ka dal prej derës së zyrës dhe ka shku tek maqinat jashtë zyrës me lyp ujë apo pallomë për me i fshi hundët. Por nuk ka gjet as pallomë as ujë dhe është deshtë me maicë dhe me duar me i mbajt hundët. Tutje ka thënë se me të pandehurit e tjerë është familjar dhe se para ditës kritike nuk është shoqeru me dal me pi kafe apo me dal bashke, dhe se para ditës kritike nuk është takuar me asnjërin dhe se nuk i kujtohet se kur ka qenë hera e fundit se kur është takuar me ta mirëpo raportet i kanë të mira. Ndërsa për familjen H. ka thënë se para ditës kritike nuk i ka njoft dhe nuk ka dëgjuar për ta dhe nuk e ka ditë për ndonjë mosmarrëveshje eventuale që mund të kenë pasur familja e të pandehurve me familjen H.a e edhe pas rastit nuk e ka kuptuar se ndonjë familjarë i tij të ketë ditur se familja e të pandehurve me familjen H. kanë pas ndonjë mosmarrëveshje. I pandehuri tutje në mbrojtjen e tij ka thënë se ditën kritike nuk ka qenë në restorant, po ashtu nuk ka prek ndonjë fishekë apo gëzhjojë në vendin e ngjarjes dhe është në njohuri se familja Gashi, ka një punëtori afër ish punëtorisë së të pandehurit në fsh. Volljakë, është ngjitur me ish punëtorinë e tyre, vetëm muri i ndanë dhe se nuk është i sigurtë mirëpo i duket se punëtorja e familjes G. ka qenë funksionale. Ndërsa lidhur me gjetjen e armës në punëtorinë e tyre, me dt. 29.04.2022, me të cilën dyshohet se është kryer vepra penale, ka thënë se nuk e ka pa as armen e as fishekë të armës nuk ka pas në dorë. Ndërsa lidhur me raportin e ekspertimit të dt. 26.10.2022, me nr. AKF/2022-2020-2022-1945, ku është konstatuar se një gëzhjojë e gjetur në vendin e ngjarjes evidentuar si dëshmia #1, është fituar profil i ADN-së nga dy persona, ku njëri prej tyre është konstatuar se është i të pandehurit, i pandehuri ka thënë se nuk ka ndonjë sqarim. I pandehuri ka thënë se nuk

ka qenë në dijeni se arma e cila është gjetur në punëtorinë e tyre por thotë se ka dëgjuar pas disa kohe prej mixhallarëve apo prej dikujt nuk është e sigurte.

Prokurorja e shtetit Lumturije Vuçetaj, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar se pas administrimit të provave gjatë shqyrtimit gjyqësor, dëgjimit të të dëmtuarve M.dhe A.H., dëshmitarëve të shumtë dhe ekspertë të fushave të caktuara si dhe mbrojtjes se të pandehurve është vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë gjendja faktike si në dispozitivat e përmirësuar si më lartë. Faktet e vërtetuara gjatë shqyrtimit gjyqësor, e të cilat konsistojnë në figurën e veprës penale për të cilën edhe është ngritur aktakuza janë si në vijim: Të pandehurit janë familjar vëllezër, axhë dhe nip; Vëllai i katër të pandehurve /vëllezërve G.-E1. G. me banim në Itali-Brescia ishte rrah nga tre vëllezërit e viktimës dhe te dëmtuarve, Hakmarrja ka qenë qëllimi i përbashkët i familjes G. ndaj familjes H.; B.1 ka qenë në dijeni se nipi i tij E1. ne Itali është rrah nga vëllezërit H. te cilët jetojnë në Itali, Këtë informacion e ka marrë drejtpërdrejt nga E.1 përderisa kanë pi kafe në Klinikë së bashku vetëm dy muaj para rastit. B.1 axha i tyre ka qenë në dijeni për faktin se të pandehurit janë shku me ba telashe me familjen H.nga i pandehuri A.; I njëjti nuk ka marr asnjë veprim për ti parandaluar përkundër kësaj i ka lënë në parking në pritje te daljes se vëllezërve H.; B.1 duke e dit se vëllezërit G.janë në parking dhe kishin ardh me qëllim “për me ba telashe” me M.H. i lenë ata në parking dhe futet nga një hyrje te tjetër e restorantit duke shikua sallën dhe ulet në një terasë për të pi kafe me qëllim vëzhgimit të lëvizjeve të të dëmtuarve H.; Planifikimi për tu hakmarrë ishte bërë kohë me parë; Monitorimi i lëvizjes se te dëmtuarve dhe vënia në dispozicion e informatave ishte siguruar nga axha i tyre / i pandehuri B.1; Shkuarja me pick-up në parking te restorantit dhe parkimi me mundësi lëvizje të menjëhershme; Ardhja në këmbë e të pandehurit B.1 me te pandehurin A. në parking të restorantit dhe lënia e veturave të tyre në një parking tjetër tregon qëllimin e tyre; Pajisja me armë, mjete të mprehta si lopatë, stupca, thikë, etj e të cilat disa mbeten në vend të ngjarjes e disa i tërhoqën, të njëjtat tregojnë përgatitjen e tyre; Hyrja në restorant nga i pandehuri B. dhe marrja e informatave nga stafi i personelit brenda dhe jashtë restorantit; Sulmi ndaj te dëmtuarit M.në momentin e daljes nga restoranti me familje nga vëllezërit G.dëshmon që të njëjtit nuk kishin shkuar për të biseduar ashtu siç po pretendojnë të pandehurit; Sulmi me mjete/armë te ftohta në duar ndaj vëllezërve tjerë F.ë dhe A. tregon se nuk ishte qëllimi vetëm ndaj të pandehurit M.ashtu siç po pretendojnë të pandehurit; Shtënja me armë në drejtim te dëmtuarit M.dhe goditja në këmbën e majtë, e pason me shtënje edhe në drejtim të të dëmtuarit A. por rezulton pa sukses si dhe në drejtim të të ndjerit F.i cili goditet për vdekje; Paraprakisht të dëmtuarit pësojnë goditje të njëpasnjëshme me mjete shkop e lopatë në kokë dhe në të gjitha pjesët e trupit; Të gjitha këto përderisa te dëmtuarit ishin duar bosh dhe në prezencë të familjarëve që ishin gra dhe fëmijë; Qëndrimi indiferent i të pandehurit B. në vendngjarje pa marr asnjë veprim për te ndërhyrë qe te ndaloj edhe përkundër që moshja e tij në raport me të pandehurit e tjerë nënkupton pjekurin e tij dhe vetëdijen për peshën dhe pasojën e veprimeve, edhe përkundër kësaj i njëjti parandalon menaxherin këtu dëshmitarin E.3 që të ndërhyjë për ti ndarë; Gjatë largimit me veturë përsëri ndalon për një moment njëri nga te pandehurit, hap derën dhe iu drejtohet të dëmtuarve me fjalë; Largimi nga vendi i ngjarjes i të pandehurve dhe fshehja e armës në vend punishten “.....” pronë e babait/ dëshmitarit Q. te të pandehurit Y. G. si dhe lënia e veturës në oborrin e të pandehurit B.1; Ndalja e të pandehurit B.1 në restorant kinse për te mbuluar vetën për te pas alibi se i njëjti nuk ka qenë në vendngjarje; Vend

punishtja ishte pasive, pa rrymë, jo funksionale dhe në mexhë me punishten e vëllezërve G.i ; Aty kishin mbetur njolla gjaku të cilat kishin rezultuar pas ekzaminimit se janë të pandehurit Y.G.; Dëshmia #1 - gëzhgjë 7.62x25mm e gjetur në vendngjarje, ka rezultuar me profil të ADN-së së paku nga dy persona, ku njëri prej tyre është e pandehurit Y.G.; Ky i fundit nuk kishte qenë në vendngjarje dhe në asnjë mënyrë nuk kishte ardhë në kontakt fizik me dëshmitë / gëzhgjat në vendin e ngjarjes; Eksperti... konfirmoi profilin e ADN-së të pandehurit Y.; Marrja dhe largimi i te pandehurit A. nga shtëpia e babait te tij nga i pandehuri B. tregon involvimin e këtij të fundit që nga fillimi deri në fund; Provat e siguruar në vendin e ngjarjes, në veturën që kanë përdorë për transport dhe armën në vend punishten si me lart janë indikator që të njëjtit kanë pas qellim të fshehin provat ashtu siç thotë fjala popullore “*Gjuaje gurin dhe fshehe dorën*”; Shkalla e lartë e dashjes dhe kontributi i secilit prej tyre në kryerjen e veprës penale manifeston qëllimin dashakeq të pandehurve; Komunikimet tyre me telefon para, gjatë dhe pas rastit është një prej mënyrave të parapërgatitjes për kryerjen e veprës penale; Provat e siguruar dhe të ekzaminuara vërtetojnë kryerjen e veprave penale, pasojat e shkaktuara, fajësinë e secilit të pandehur, shkallën e përgjegjësisë penale për secilin veç e veç. Tutje prokurorja e shtetit ka cituar dhe elaboruar provat me të cila ka vërtetuar gjendjen faktike si në dispozitivat të kësaj aktakuze dhe atë si në vijim: raportin e hetuesit Enis Boshtrakaj i dt. 05.05.2022 me nr.2022-DE-203 dhe nr. ref 2022-HRP-57 , Vërtetimin mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.28.04.2022, raportin e hetuesit Imer Hylaj me nr.2022-DE-203 dhe nr. ref 2022-HRP-57 i dt.29.04.2022, Vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve e dt.29.04.2022, Raportin mjekësor në emër të të pandehurit B.G.1 me datë 29.04.2022 ora 00:30, Raportin mjekësor në emër të të pandehurit A.G.1 me datë 29.04.2022 ora 00:35, Vërtetimin mbi sekuestrimin e sendeve e dt.28.04.2022, raportin e ekzaminimit të veturës me nr.TKR-Pejë,22/27 i dt. 28.04.2022, ekzaminimin e veturës të llojit BMW–pronë e të pandehurit B. me targa 03-947-FK dhe veturës Renault Clio me targa pronë e të pandehurit A.G. nuk janë gjet dëshmi apo ndonjë provë materiale, Fotoalbumin e vendit të ngjarjes TKR-Pejë,22/27 i dt.28/29.04.2022, Raportin e Autopsisë me nr. ref: MA22-128 të dt. 29.04.2022 i kryer nga Dr. N.U.– Ekspert Mjeko-Ligjor pranë Departamentit të Mjekësisë Ligjore – Prishtinë, i cili ka nxjerrë Përfundimin e tij lidhur me shkakun e vdekjes, Dëshmia e ekspertit Dr. N.U.të dhënë para gjykatës, Deklaratën e ekspertit e dhënë në këtë shqyrtim gjyqësor, plotësimin i raportit të obdukimit i dt.14.02.2024 nga dr. N. U., raportin mjekësor me nr. 8237, të dt. 28.04.2022, të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë - Emergjenca, në emër të F.H.j, raportet nën nr. të rastit: 2022-DE-203 dhe 2022-HRP-57 i dt. 04/06.05.2022 i përpunuar nga hetuesi Enis Boshtrakaj dhe Imer Hylaj, video-incizimet e restorantit “.....” dhe atë nga Cam. 2, 6, 12 dhe 13 të cilat ka mbulueshmëri të parkingut, hyrjes dhe brendisë në restorant “.....”, kamerat e restorant “.....”, ku ka ndodhur ngjarja kritike, kamera 07, kamerat 06 Tri CD-të të siguruar nga vendet e ngjarjes “.....” dhe “....., deklarin e Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Av. F.K. të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe atë se në fq.10 rreshti i 15 kah fundi deklaron se në ora 07:30:27 shihet ku goditet me armë i dëmtuari A. dhe në 07:30:24 shihet kur i pandehuri N. gjuan prapë në drejtim të M. ose të A. ndërsa në rreshtin e 9 kah fundi nga ana e prokurorisë është konstatuar se në ora 07:30:28 shihet gjuajtja e dytë me armë në drejtim të të dëmtuarit A.. Në fq.11 rreshti 11 mbrojtësi i të pandehurit B.1 Av. R.G.deklaron: “Tani këtu shihet një person duke hyr në restorant nga dera e terrasës i cili, mund të jetë i mbrojturi im B.1dhe është disa sekonda pas daljes së familjes H. jashtë.” Pas këtij deklarami i pandehuri B.1 e pohon me fjalët

se “*po unë jam personi në fjalë*”, Akt-ekspertimin mjeko-ligjor nën nr. ref: PE-34, dt. 29.05.2022 nga Dr. N. U., plotësimin e akt-ekspertimit mjeko ligjor nga Dr. N.U.i dt. 15.02.2024 sipas urdhrit të gjykatës, raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj më numër 2022-DE-203 të datës 03.06.2022, raportin lidhur me analizën e thirrjeve telefonike “IPKO”, raportin e hetuesit Enis Boshtrakaj me numër 2022-DE-203 i datës 27.05.2022 lidhur me analizën e thirrjeve telefonike “VALA”, lista e dëshmime me nr. TKR-Pejë-22/27 e dt.04.05.2022. Nga evidentimi i këtyre dëshmime sipas prokurores së shtetit vërtetohet së në vendin e ngjarjes janë gjetur katër gëzhoja që vërteton faktin se është shkrepur arma katër herë, gëzhojat kanë të njëjtën kalibër, më pastaj është gjetur një fishek po më të njëjtin kalibër i cili na adreson tek fakti se arma është bllokuar dhe si rezultat i mos shkrepjes ka rënë fisheku si dëshmi për të mbetur në vendin e ngjarjes dhe nëse e bëjmë një paralele me gjetjen edhe të një fisheku me kalibër po ashtu të njëjtë në dysheme të veturës, vërteton fuqishëm së në një moment arma nuk ka shkrep dhe si pasojë fishekët kanë rënë një në vendin e ngjarjes e një në veturë. Nga të gjeturat si me lartë prokurorja e shtetit parashtron pyetje se: Pse arma është marrë me vete në veturë nga ana e të pandehurit N.G. nëse e njëjta nuk ka qenë e tij por e M., pse i njëjti e fshehu armën në punishten e të pandehurit Y.G.-kushëririt të tij për të mbuluar vrasjen e të ndjerit F.H. nëse këtë të fundit i pandehuri N. pretendon se nuk e ka vrarë ky, po vëllai i tij M.?

Sipas prokurores së shtetit lënia e armës në vend të ngjarjes do rezultonte me gjetjen e gjurmëve të gishtërinjve të të njëjtit dhe të dëmtuarit M.nëse ky i fundit e ka pas armën në posedim.

Andaj, pikërisht këto rrethana venë në pah haptazi të pavërtetat e të pandehurit N. dhe të pandehurve të tjerë, të cilët si qëllim kryesor kanë marrë mbi vete që edhe pas kryerjes së veprës penale edhe pas tregimit të vendndodhjes së ku është fshehur arma, të krijojnë armiqësi brenda për brenda familjes H. me teorinë se kinse dorasi është këtu i dëmtuari M., shtrohet pyetja pse ? Sepse qëllimi i vetëm i tyre është krijimi i iluzionit publik dhe tjetërsimi i tërësishëm i të vërtetës dhe dërgimi tek thënia popullore : “*Përçaj dhe sundo*”. Skica e vendit të ngjarjes të punëtorisë “.....” e hetuesit Blerim Tigani e cila ka të evidentuar dëshmitë #22 dhe #23 si njolla të kuqe në brendi të objektit e emëruar si zyre po ashtu dëshmitë #20 dhe #21 në pjesën e objektit të emëruar si punëtori kurse dëshmia #19- pistoleta është evidentuar në afërsi të objektit të emëruar si punëtori, në pjesën anësore të objektit, Skica e vendit të ngjarjes tek restoranti “.....”, raporti i ILEC-U i datës 01.06.2022 me numër 1-1123-22-17, raporti i ekspertimit numër AKF/2022-0244 i datës 16.06.2022 në vend punishten “.....”, Raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin e dëshmime nga AKF-ja me nr. AKF-2022-0244 i dt. 11.10.2022,raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj mbi analizën e Raportit të ekspertimit të dëshmime nga AKF-ja me nr. AKF-2022-0244 i dt.31.10.2022, Raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin e dëshmime nga AKF-ja me nr. AKF/2022-0244 i dt. 18.01.2023; raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1945 i datës 26.10.2022, dëshmia #1 (një gëzhjojë e fishekut) e gjetur në vendngjarje është fituar një profili përzier i ADN-së nga së paku dy persona, dhe atë në këta dy persona Y.G. nuk mund të përjashtohet si kontribues i ADN-së në këtë përzierje, dëshmia #25 (një fishek), mostra #26C (tampon nga pjesa e sipërme e bishtit të lopatës), dëshmia #7 (një thikë metalike me ngjyre të zezë) e gjetur në vendngjarje, dëshmitë #2 (një gëzhjojë e fishekut) dhe #19 (një revole) dhe dëshmia #3 (gëzhjoje fisheku), #5 (një shkop druri), #8 (një gëzhjojë fisheku) dhe #12 (një fishek), Eksperti B.M.specialist i serologjisë dhe ADN-së në shqyrtimin gjyqësor te dt.30.01.2024, raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1946 i datës 26.09.2022, Eksperti

daktiloskopik Valbona Shala, raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1947 i datës 14.12.2022, Eksperti T.H. si ekspert për armë të zjarrit në shqyrtim gjyqësor të dt28.02.2024, raporti i hetuesit Imer Hylaj me nr.2022-DE-203 i datës 29.04.2022.

Prokurorja e shtetit tutje ka elaboruar deklaratat e të dëmtuarve M.H. dha A.H. deklaratat e dëshmitarve I.B., E.B., R. B.a L.B.B.B., A.T., duke shtuar se të njëjtave duhet falur plotësisht besimi duke qenë se korrespondojnë edhe me deklaratimet e tyre të mëparshme në polici dhe po ashtu gjejnë mbështetje edhe në provat tjera të siguruara dhe administruara, ndërsa që të mos u falet besimi deklaratimeve të te pandehurve, ngase janë të orientuara në tendencën për shmangien e përgjegjësisë juridiko-penale dhe nuk gjejnë mbështetje në provat tjera të siguruara dhe administruara dhe janë kundërtënëse njëra me tjetrën si në polici ashtu edhe në prokurori(ata të cilët kanë deklaruar) po ashtu edhe në kundërshtim me provat tjera të shtjelluara si më lart.

Deklarata e dëshmitarit Q.G., e dhënë në Shqyrtim Gjyqësor me dt.28.02.2024, prokurori e shtetit ka gjetur se deklarata e dëshmitarit Q., është kundërtënëse në deklarinimin e tij në përgjigjet e dhëna në pyetjet e mbrojtësit të te pandehurit Y.G. në raport me përgjigjet e dhëna në pyetjet e parashtruara nga ana e prokurorit të shtetit dhe përfaqësuesit e autorizuar nga palët e dëmtuara, po ashtu edhe dëshmitarja V.G. nuk ka dhënë ndonjë deklaratë relevante lidhur me rastin dhe nuk është përfshirë fare në këtë fjalë përfundimtare, ndërsa në raport me dëshmitarin Q. i propozon gjykatës që të njëjtit mos t'ia falë besimin meqenëse i njëjti në këtë fazë të procedurës është dëgjuar për herë të parë e cili me patjetër deklarinimin e tij e ka orkestruar së bashku me mbrojtjen e te pandehurit Y.G. i cili është djali i tij. Prokurorja e shtetit ka elaboruar edhe deklaratimet e të pandehurve B.1 dhe A.G. dhe referuar përmbajtjes së deklaratave të elaboruara, i propozon Gjykatës që të njëjtit mos t'ia falë besimin sa i përket deklarinimit në Gjykatë pasi që ky deklarinim është bërë pothuajse dy vite pas rastit dhe deklarata e dhënë në polici është deklarata më e afërt me kohën reale të kryerjes së veprës penale dhe konsiderohet se të dhënat janë më të freskëta në memorien e secilit individ e në rastin konkret të pandehurit A.. Për të pandehurin B.G.1, prokurori i shtetit, ka përshkruar kundërtënie e gjetura në deklaratimet e te pandehurit te dhëna gjate fazave te ndryshme të procedurës penale dhe atë: Fillimisht në polici ka deklaruar se i njëjti nuk ka qenë fare në punëtori dhe se me vëllezërit N.in dhe A.1in ishte taku pas rastit në shtëpi dhe se kinse e ka pyet N.in se çka u ba dhe ai ka thënë se ka ba fjalë me M.. Në Gjykatë e deklaronte të kundërtën duke thënë se ka qenë në punëtori së bashku me tre vëllezërit e tij se e ka parë M. dhe ky i fundit ka bërë shllajfa me veturë. Nga këto deklarata të cilat qartazi shihen që janë totalisht kundërtënëse në tërë përmbajtjen e tyre, dhe kjo vërteton se të njëjtit qysh në fillim kanë marrë përsipër se cili çfarë roli do të luaj në këtë ngjarje duke tentuar të kamuflojnë se kinse ngjarja ka ndodhur pa u përfshirë herë njeri vëlla e herë tjetri e në disa raste nuk përfshihet as xhaxhai i tyre këtu i pandehuri B.1. Gjithashtu vlen që theks i veçantë ti jepet pjesës ku i pandehuri B. thekson që hakmarrjen ndaj familjes H. e kanë planifikuar dhe që kjo do të ndodhte herët apo vonë. Në deklarinimin të pandehurit A.G.1, hasim kundërtënie të shumta që nga momenti i fillimit të ngjarjes e deri në përfundimin e saj me vdekjen tragjike të te ndjerit F.. Në polici fillimisht deklaronte se B. nuk ishte prezent gjatë tërë kohës e më pas në shqyrtimin gjyqësor del që ky i fundit ishte prezent në momentin kritik. E përbashkëta e deklaratës së të pandehurit A.1 me të pandehurit e tjerë del çdo herë të jetë motivi i kryerjes së veprës penale e që ishte hakmarrja ndaj të dëmtuarit M., për një rrahje të ndodhur

në Itali para disa muajve nga vëllezërit e te njëjtit të cilët jetojnë dhe veprojnë atje por jo nga i dëmtuari M.. Deklarimi i të pandehurit Y.G., dhe ballafaqimi me raportin e ekspertimit të dt.26.10.2022, ku është konstatuar nga ekspertë të ADN-së, nga këndvështrimi i parashtrimit të pyetjeve të mbrojtësit të tij dhe prokurorit të shtetit rezulton kundërthënia sa i përket shkuarjes së tij në fshatin Volljakë tek punëtorja ku i njëjti fillimisht deklaroi se ka zbrit në Volljakë pasi që i kishin dërguar disa punëtorë në fshatin Sferkë ndërsa me pas në pyetjen e prokurorit deklaroi të kundërtën se në Volljakë ka shkuar me veturën “Golf 2”. Nga deklarimi i të pandehurit N.G. gjejmë se i njëjti tri deklaratat e dhëna i ka dhënë në versione të ndryshme duke i përshtatur në varësi të situatës në të cilën është gjetur dhe atë fillimisht në deklaratën e parë e dhënë në polici nuk e përmend fare armën, në deklaratën e dytë e dhënë në polici në prezencë edhe të prokurorit të shtetit e pohon të këtë shtënë në armë dhe atë tri herë dhe së më pas e ka pa se i ndjeri Fazli ka rënë për toke, ndërsa e potencon se gjatë të shtënave dyshon se e ka plagosur edhe M.in, si dhe ka mbajtur armën pas gjuajtjeve në gjendje gatishmëri, kurse në deklarin e tij pranë Gjykatës tanimë ka ndërruar në tërësi versionin e mbrojtës duke ndërruar fillimisht rrjedhën e ngjarjes në momentin kur i dëmtuari M.ka kaluar me veturë, se cili prej tyre ka shkuar me pick up pas tij dhe më tani se kinse kanë shkuar te pasi që ju kishte prish vetura e jo pse hamendësonin se tek ai restorant kishte shkuar M. për darkë dhe në fund e mohon që të këtë përdorur ai armën që sipas tij e kishte pasur në posedim këtu i dëmtuari M.dhe më të ai pa dashje kishte qëlluar të ndjerin F.. Nga këto deklarata të cilat qartazi shihen që janë kundërthënëse në përmbajtjen e tyre e po ashtu të njëjtat bien në kundërshtim edhe me provat e tjera të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor e në veçanti më pamjet e video-incizimet e kamerave të restorantit “.....” të cilat janë nxjerrë në shqyrtimin gjyqësor.... e te cilat qartazi paraqesin momentin kur i ndjeri F. bie përtokë si pasojë e goditjes me armë zjarri nga i pandehuri N., e që në ato momente i dëmtuari M.nuk ishte fare në vend të ngjarjes pas që paraprakisht i plagosur në këmbën e majtë veç se kishte hyre brenda në restorant për të kërkuar ndihmë. Andaj, nga të lartcekurat mbetet në tërësi pranë aktakuzës dhe kualifikimit juridik si dhe plotësimin të saj si me lart, i propozon gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtorë, duke i shqiptuar dënimin e merituar në raport me përgjegjësinë penale për veprat penale për te cilat janë akuzuar, duke pas parasysh se qëllimi i dënimin të jetë në proporcion me peshën e veprave penale dhe rrethanat në të cilat janë kryer veprat penale si, shkallën e përgjegjësisë penale, motivin për kryerjen e veprës penale, intensitetin e rrezikimit gjatë kryerjes së veprës penale, dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale. Gjykatës i propozon që me rastin e matjes së dënimin si rrethana rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, të merr për bazë: Shkallën e pjesëmarrjes e secilit akuzuar; shkallën e lartë te dashjes, mosha e viktimës, shkallën e dëmit te shkaktuar viktimës apo familjes së tij dhe të kaluarën kriminale.

Përf. i aut. i të dëmtuarit av. F.K., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka thënë: qëllimin e vrasjes së të ndjerit F.H. dhe qëllimin për ti vrarë A. e M. në prani të grave dhe fëmijëve dhe fillimisht ka përshkruar momentin se çfarë kanë vepruar vëllezërit G. kur i ndjeri F. ishte i shtire në tokë, i vrarë ku i njëjti luftonte me frymën e tij të fundit të shpirtit për të mbetur gjallë, ku lufta për mbijetese nga goditja fatale e vëllezërve G. e në të njëjtën kohë i shtrirë në tokë merrte goditje pandërprerë duke mos pasur mundësi të paktën të lëshoj një zë “se unë tanimë jam në procesin e fundit të jetës. Tutje përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka paraqit arsyet se pse vëllezërit G. dhe Axha i tyre B.1duhet të dënohen sikurse e përcakton aktakuza.

Sipas përfaqësuesit së palës së dëmtuar të gjithë të pandehurit kanë përpiluar planin dhe janë organizuar, në atë mënyrë që të dëmtuarit t'i zënë në prit dhe t'i vrasin ashtu siç përshkruhet edhe në aktakuzë, e që në këtë organizim të njëjtit i kanë ndarë rolet. Përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka përshkruar momentin para ekzekutimit të viktimës se si të pandehurit në mes veti e krijojnë hapësirën për të ekzekutuar të dëmtuarin M., të cilin vetëm arrijnë ta plagosin, pas plagosjes M. largohet nga vendi i ngjarjes. Pas ikjes së M. nga vendi i ngjarjes, personi me armë në dorë që për gjykatën dhe palët në procedurë është i identifikuar, me arme në dorë e ndjek të dëmtuarin A. ku ishte duke u goditur në vazhdimësi nga vëllezërit G., me mjetet e ndryshme, mundohet që ta lokalizoj kokën e tij për ta privuar nga jeta, mirëpo për fat të mirë ajo shkrepte e armës kalon afër kokës së të dëmtuarit A. pa pasoja. Pas dëgjimit të krismës së tretë i ndjeri F. afrohet tek vëllai i tij A. për ti ndihmuar apo për ta nxjerrë nga ajo rrëmujë në ato momente personi me armë në dorë, shtie në drejtim të të ndjerit F. ku ajo goditje ishte fatale për të. Edhe përkundër plagosjes së dëmtuarit M. dhe vrasjes së të ndjerit F. ku pasuan edhe goditje gjersa ishte i shtrirë në tokë, vëllezërit Gashi të pangopur me këto veprime, vazhdojnë ta godasin të dëmtuarin A. në vazhdimësi me mjete të ndryshme të forta. Përshkrimin e situatës përfaqësuesi e përshkruan duke përmendur si provë CD-në ku shihen video inqizimet ku vërehet axha i vëllezërve G., saktësisht i pandehuri B.1 i cili nuk e lejon që pronari i restorantit ta ndale sulmin që behej ndaj A.. E që ky veprim i të pandehurit B.1 vërteton se i njëjti ka pasur qëllim, dëshirë për kryerjen dhe realizimin e veprave penale të kryera në drejtim të vëllezërve H., po ashtu edhe veprimet e tjera të të pandehurit B.1 duke thënë “Vrani , Vrani” kontribut ky që ka ndikuar psikikisht dhe emocionalisht në veprimet e vëllezërve Gashi. Tutje përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka paraqit disa nga provat që janë administruar të cilat janë shkresa përbërëse të lëndës dhe atë deklaratën e dëshmitarit A.T. të dhënë në polici me dt. 13.05.2022, deklaratën e dëshmitarit I.B. me dt. 22.09.2022, deklaratën e dëshmitarit R. B. e dhënë me dt. 23.09.2022 para prokurorit, Deklarimin e dëshmitarit B. B. të dhënë me dt. 13.05.2022, deklarin e dëshmitarit E.B. të dhënë me dt. 23.09.2022, Përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka thënë se nga dëgjimi i këtyre dëshmitarëve u vërtetua videoinqizimi nga vendi i ngjarjes. Tutje përfaqësuesi i palës së dëmtuarve ka thënë se për elementet e veprës penale për të cilën akuzohen të pandehurit dhe kontributin e tyre të dhënë për kryerjen e kësaj veprë penale ka elaboruar deklaratat e të pandehurve të dhëna në prani të mbrojtësve të tyre në fazat e mëhershme dhe kunderthenjet në mes tyre. Po ashtu përfaqësuesi i palës së dëmtuar ka elaboruar deklaratën e dëshmitarit L.B.. Në fund përfaqësuesi i palës së dëmtuar në fjalën e tij përfundimtare ka propozuar gjykatës që të pandehurit ti shpallë fajtorë, ti dënoj sipas ligjit duke marrë në konsideratë edhe të kaluarën e tyre kriminale.

I dëmtuari M.H., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e përfaqësuesit të tij të autorizuar.

I dëmtuari A.H.j, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e përfaqësuesit të tij të autorizuar.

Mbrojtësi i të pandehurit N.G. av. E. K., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar se: bazuar në provat që janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk vërtetohet se i pandehuri N.G. të i ketë kryer veprat penale për të cilat akuzohet. Mbrojtja ka bërë analizën e provave të papranueshme duke përshkruar se kur ka ndodhur ngjarja se si është

arrestuar nga policia i pandehuri N. dhe deklarimin e tij të dhëna ne polici i cili është marr dy herë në pyetje nga policia pa të drejtën e shfrytëzimit me u konsultu me mbrojtësin e tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. Sh.B.. Intervistimi i dytë i të pandehurit N. në polici rezulton në kundërshtim me nenin 257 par. 2 pika 4 nën pika 4.1 të KPPRK-së, sepse i pandehuri për herë të dytë është marr në pyetje ende pa kaluar 12 orë nga hera e parë kur ishte marr në pyetje pra i pandehuri N. është marr në gjendje kur ishte tepër i lodhur dhe i traumatizuar nga ajo që kishte ndodhur një natë më parë. Prandaj deklarata e parë e dhënë në polici sidomos deklarata e dytë e dhënë në polici, rezulton se deklaratat e tilla janë në kundërshtim me nenin 257 par. 2 pika 4 nën pika 4.1, 4.3 dhe 4.4 të KPPRK-së (KPPRK-së i vitit 2012 ishte në fuqi gjatë hetimit) dhe si të tilla rezulton me të drejtë se janë prova të papranueshme në pajtim me nenin 257 par. 6 të KPPRK-së. Tutje mbrojtja ka përshkruar të gjeturat nga raporti i ekspertimit te Agjencisë së Kosovës për Forenzike me nr. ref./ AKF-2022-0244 të dt. 16.06.2022, ky raport sipas mbrojtjes është provë e pranueshme por ndërlidhet me 3 CD të e shikuara në shqyrtim gjyqësor e që janë prova te papranueshme. Mbrojtja konsideron se këto 3 CD-te janë prova te papranueshme ka qenë bazë të këtyre pamjeve të këtyre CD- ve janë përpiluar edhe raportet e hetuesit Imer Hylaj nr. 4217 i përpiluar me nr. të rastit 2022-DE-203 i dt. 04.05.2022 Mbrojtja po ashtu ka theksuar se janë shikuar vetëm pamjet e CD-ve që shkojnë në favor të aktakuzës, duke u shikuar vetëm njërin anë të së vërtetës, dhe kjo që nuk shihet sigurisht nga errësira se kush ka shkrepu me armë në drejtim të viktimës shihet vetëm një lloj flakë nuk shihet kur armen në tokë e merr i pandehuri N. i cili ishte mbrojtur se e njëjta arme ka rënë nga dora e të dëmtuarit M.H. e sipas të pandehurit N. kjo armë ka qenë në posedim të M.H..

Mbrojtja ka theksuar se reportet policore janë lexuar ne kundërshtim me nenin 256 të KPPRK-së ne të cilin nen askund nuk potencohet, se mund që të shikohen apo të lexohen provat e propozuara nga prokuroria e shtetit e të cilat gjykata i ka lexuar gjatë shqyrtimit gjyqësor (citen provat si në faqen 5 dhe 6 pasusi i III-të në fjalën përfundimtare. E po ashtu edhe deklaratat e të pandehurve dhe dëshmitarëve të dhëna në polici dhe në prokurori për kundër faktit se mbrojtja e kundërshton leximin e deklaratave të tilla sepse deklaratat e tilla do të mundën që të lexohen vetëm në rrethanën nëse ndonjë dëshmitar është i pa arritshëm që të dëgjohet gjatë shqyrtimit gjyqësor, dhe dëshmia e atij dëshmitari te jetë marrë në pajtim me dispozitat ligjore të KPPRK-së, ndërsa deklarata e të pandehurit nuk mundet të lexohet sepse i njëjti duhet të jetë prezent ne shqyrtimin gjyqësor për derisa nuk plotësohen kushtet ligjore për gjykim në mungese ne pajtim me nenin 303 të KPPRK-së e në këtë çështje penale të gjithë të pandehurit ishin prezent gjatë shqyrtimit gjyqësor. Mbrojtja ka bërë edhe analizimin e provave të tjera si deklaratimet e të dëmtuarve M.e A.H. dhe të dëshmitarëve E.B., I.B., L. B., A.T., Q.G. dhe V.G., Mbrojtja dëshminë e te dëmtuarve M.dhe A.H.e vlerëson subjektive dhe plotësisht të një anshme, kështu që për veç faktit që kanë dëshmuar ekzistimin e konfliktit fizik me të pandehurit, pjesa tjetër e dëshmisë se tyre nuk përputhet me gjendjen faktike. Dëshmia e M. është e njëanshme edhe nga fakti se ai nuk e pranon se ditën kritike ka pasur me veti armen të vendosur në çantën e tij të cilën e ka mbajtur në pjesën e përparme të trupit te tij e i cili deklarim është në kundërshtim me dëshminë e të pandehurve N., A., A.1, B.. Mbrojtja ka shtuar se edhe në deklaratimet e dëshmitarëve E.B., I.B., L. B., A.T. si dhe dëshmitarëve R. dhe B. B., asnjeri nga dëshmitarët e cekur nuk e kanë vërejtur se kush e përdori armen në atë konflikt fizik apo kush shkrep me armë, prandaj vlerësimet e më tejme të dëshmisë së këtyre dëshmitarëve për mbrojtjen janë jo

relevante. Sa i përket armës ka rezultuar se e njëjta nuk ka karakteristika identifikuese apo ne të njëjtën nuk janë gjetur gjurme te vijave papilare se a e ka pasur në përdorim i dëmtuari M. e po ashtu nuk janë gjetur as vija papilare te pandehurit N. ani pse ky e pohon faktin se armen e ka marr ne tokë duke shtuar se këtu flitet për një ekzaminim jo profesional apo kur arma është dërguar për ekzaminim ne Agjencinë e Kosovës për Forenzikë. Mbrojtësi ka shtuar se i pandehuri N. dhe vëllezërit e tij ditën kritike nuk kanë pasur armë me vete dhe se qëllimi i të pandehurve nuk ka qenë ta vrasin dikënd, por vetëm ta rrahin M. krejt kjo për arsye të problemit i cili ka nis në mes vëllezërve te M. ne Itali dhe vëllait të tij E1. G. ne Itali për shkak të një borgji në shumën prej 300 euro se kinse vëllai i N.it ia ka pasur vëllezërve të M. dhe vazhdon me përshkrimin në detaje se si ka rrjedh krejt ngjarja në Itali në mes të vëllezërve të M. dhe vëllait të N.it e që nga këto mosmarrëveshje kanë rezultuar me rrahjen e vëllait te N.it E1. dhe duke vazhduar prap me provokime të tjera nga të dëmtuarit M.H.. Sipas mbrojtjes elementi qenësor i veprës penale Dashja ne veprimet e të pandehurit N. nuk mundet që të përcaktohet në mënyrë të qarte siç këtë element të veprës penale e përcaktojnë nenet 21 dhe 22 të KPRK-së pra Prokuroria e shtetit nuk ka arrit edhe në fjalën përfundimtare qe te vërteton elementet qenësore te veprës penale dashjen dhe qëllimin e kryerjes se veprës penale siç e përcaktojnë neni 21 dhe 22 të KPRK-së (citon nenin 21 dhe 22 të KPRK-së) e që bazuar nëse analizohen dhe interpretohen drejte dispozitat e cekura ligjore atëherë shihet qarte se ne veprimet e të pandehurit N. nuk ka ekzistuar qëllimi për ta kryer veprën penale siç pretendon aktakuza. Sipas mbrojtjes pavarësisht faktit se disa nga provat janë siguruar në kundërshtim me dispozitat ligjore të cekura me lartë të njëjtat nuk argumentojnë veprime inkriminuese të të pandehurit N. ashtu siç pretendon edhe në fjalën përfundimtare prokuroja e shtetit. I mbrojturi i tij nuk i ka kryer asnjë nga veprat penale objekt i akuzës kurse marrja e armës në tokë ne momentin kritik kur të dëmtuarit M. nga arsye e cekura si më lartë i kishte rënë arma në tokë nuk do të thotë se e ka kryer edhe veprën penale mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së sepse nuk e ka mbajtur në pronësi sipas kësaj nuk është përmbushë as kushti ligjor i veprës penale në fjalë sepse marrja e armës në tokë nga i pandehuri N. kishte për qëllim vetëm faktin që i dëmtuari M. që të mos këtë mundësi që të njëjtën ta përdor në drejtim të pandehurve dhe vëllezërve të tij. Mbrojtja është e bindur se në veprimet e të pandehurit N. nuk manifestohen veprime inkriminuese ndërsa për çfarëdo rrethane gjykata ka mëdyshje në ndonjë nga provat e administruara atëherë e në pajtim me nenin 3 par. 2 të KPRK-së te aplikoj parimin In dubio Pro Reo ashtu që provat e tilla eventuale të i interpretohen në favor të pandehurit N.. Në fund mbrojtja ka theksuar se nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor rezulton se nuk është vërtetuar që i pandehuri N. të i ketë kryer veprat penale për te cilat akuzohet, por nga provat e administruara është vërtetuar se në veprimet e të pandehurit N. manifestohen elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 187 par. 2 i KPRK-së.

I pandehuri N.G., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, dhe ka shtuar se rastin e ditës kritike e ka përjetu, e di mirë se çka ka ndodh, dhe kush është fajtor, me provat që janë administru gjatë shqyrtimit gjyqësor, provat janë të manipuluar nga policia dhe hetuesia. Prej këtyre provave prokuroja e shtetit ka krijuar supozime dhe pretendime për veprat për të cilat akuzohet. Me këto prova nuk është vërtetuar se te pandehurit janë fajtor për veprat për të cilat akuzohen. Kërkon që të ketë vetëm drejtësi dhe të shpallen fajtor vetëm për çka janë fajtor dhe jo për çka akuzohen. I vie keq për rastin, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Mbrojtësi i të pandehurit B.G. av. R. G., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar, se nga provat personale dhe materiale të shqyrtuara në këtë çështje penale është vërtetuar se aktakuza është e pa mbuluar me prova të besueshme dhe se edhe ato që i ka sjellë janë të papranueshme në kuptim të nenit 243 pika 1.1 të KPP-së, te pa mbështetshme në kuptim të nenit 243 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së dhe në kundërshtim me nenin 243 par. 1.2 me rregullat e Kapitullit XVI të këtij kodi dhe në kuptim të nenit 363 pika 1.3 të KPP-së duhet të hedhet poshtë nga Gjykata si e pabazuar. Tutje mbrojtja ka theksuar se prokuroria mundohet që me provën materiale videoinqizimet e kamerarave të sigurisë të restoranteve në CD-të, ku ka ndodh ngjarja dhe provat personale dëshmitë e palës së dëmtuar ta inkriminoj të pandehurin në këtë çështje penale. Vetëm se ka qenë prezent në vendin e ngjarjes është elementi i veprimit të inkriminimit në këtë çështje penale. Pretendimet e prokurorisë për të provuar versionin e saj të aktakuzës e mbështet edhe në deklaratën e të dëmtuarve M.dhe A.H. të cilën kanë dëshmuar se kinse i pandehuri B.1 ka qenë pjesë e kësaj ngjarje e duke i informuar të pandehurit e tjerë lidhur me vendin dhe lëvizjet e të dëmtuarave deri edhe te fakti se kinse i pandehuri B.1 duke qëndruar në vendin e ngjarjes ka dhënë urdhra për vrasjen e vëllezërve H. duke bërë titur “vrani, vrani” vetëm në deklaratat e të dëmtuarave të dhëna në polici, prokurori dhe në gjykatë e të cilat deklarime sipas mbrojtjes janë deklarime tendencioze dhe jo të vërteta. Kjo vërtetohet me deklaratat e tyre kontradiktore dhe kundërtënëse në mes të atyre të dhëna në polici, prokurori dhe në gjykatë. Mbrojtja ka shtuar se nga video incizimet nga Restoranti, vërtetojnë se i pandehuri B.1 nuk ka qenë fare në vendin e ngjarjes kur ka ndodh rasti konkretisht kur është shti me armë, por ai ka dal jashtë pas përfundimit të ngjarjes respektivisht pasi që qëllohet viktimat F.H. dhe se kjo provë sa i përket B.G.t përputhet me deklaratën e të dëmtuarit M. të dhënë në polici. Po ashtu edhe nga deklaratat e të dëmtuarit i A.H. e dhënë në polici me datën 11.05.2022 dhe dhënë prokurori me datën 21.09.2022 shihet se në deklaratën e dhënë në prokurori është komplet e ndryshuar në raport me shumë gjera por konkretisht me të pandehurin B.G.. Tutje në fjalën përfundimtare mbrojtësi ka paraqitur kundërtënësit e dëshmisë së dëshmitarit M.dhe A.H. lidhur me të akuzuarin B.G.. Po ashtu edhe deklarimet e dëshmitarit E.B. të dhëna në polici, në prokurori dhe gjatë shqyrtimit gjyqësor refuzojnë plotësisht pretendimet e aktakuzës dhe se dëshmitari E.2 e ka sqaruar shumë mirë edhe faktin se restoranti i ka tri hyrje, një kryesoren, një nga parku që del në terrasë dhe një nga kuzhina verore për të hyre në banak, prove kjo e cila vërteton se i pandehuri B.1 nuk ka hyrë në sallën e restorantit por në terrasë dhe pas të shtënave nga terrasa hynë në restorant dhe del jashtë sallës veç kur ndalojnë të shtënat ku plagoset i dëmtuari M.dhe vdes viktimat F.. Ndërsa për dëshmitë e dëshmitareve të tjerë të dhëna në këtë çështje penale mbrojtja ka thënë se asnjëri prej këtyre dëshmitareve nuk dëshmon asgjë për të mbrojturin e tij B.G.. Mbrojtja ka shtuar se edhe nga deklarimet e të pandehurve të tjerë nuk dëshmojnë se B.G. është i inkriminuar në këtë çështje. Ka shtuar se i pandehuri B.1 fare se ka ditur për veprimet që kanë ndodhur ditën kritike, por ai ka ditur vetëm për faktin se ata po shkojnë për të biseduar dhe hiq më shumë. Pretendimet e prokurorisë se i mbrojturi i tij ka kryer veprën penale si bashkë kryes si dhe pretendimeve të prokurorisë se i mbrojturi i tij ka vepruar në bashkëkryerje duke e penguar dëshmitarin E.B. për të ndarë palët në përleshje, po ashtu edhe nga provat materiale video incizimi ku fare nuk shihet as nuk vërehet se i mbrojturi i tij ka marrë ndonjë veprim të pengimit për ndarje siç pretendon prokuroria. Mbrojtja ka shtuar se edhe pretendimet e prokurorisë se i pandehuri B.1, ka qenë bashkë kryes në këtë çështje penale,

prokuroria këtë nuk e vërteton me asnjë provë personale e as materiale, ka shtuar se për tu përmbushur vepra penale në bashkëkryerje duhen të përmbushen disa kushte të domosdoshme e që në rastin konkret nuk janë përmbushur (citen nenin 31 të KPRK-së). Ka përmend edhe ekspertizat e eksperteve përkatës në këtë çështje penale e që asnjëra prej tyre nuk gjejnë ndonjë gjë, send ose veprim të cilat e përfshijnë të mbrojtin e tij në këtë çështje penale. Ka shtuar se bazuar në provat materiale dhe personale që janë shtjelluar i konsideron si prova të paprovuara nga ana e prokurorisë së shtetit, dhe kërkon nga gjykata ta liroj të pandehurin B.G. konform nenit 363 pika 1.3 të KPPRK-së.

I pandehuri B.G., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Mbrojtësi i të pandehurit A.G.1 av. G. K., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar: për të ekzistuar bashkëkryerja gjithsesi duhet të ekzistoj vendimi i përbashkët i të gjithë bashkëkryerësve, që të kryhet një veprë e caktuar penale, me vetëdije dhe dëshirën e të gjithëve bashkë kryesve, të bëjnë planin e përbashkët paraprakisht dhe njëkohësisht me pëlqimin e të gjithë bashkëkryerësve. Prokuroria në rastin konkret sipas mbrojtjes ka dështuar të vërtetoj faktin se tek të pandehurit si bashkë kryes a ekzistonte vendimi i të gjithëve për të privuar nga jeta të ndjerin F.H. si dhe të plagosin të dëmtuarit M.dhe A.H.. Mbrojtja nuk e ka kontestuar se familja G. me familjen H. paraprakisht kane pasur një mosmarrëveshje që ka rezultuar me rrahje të vëllait të të pandehurve nga ana e vëllait të M. dhe A.H. në Itali dhe për këtë rrahje këto dy familje nuk kanë arritur pajtimin. Mbrojtja tutje ka cituar dispozitivin e parë, ashtu që nga ai përshtkrim sipas mbrojtjes shihet qartë se ditën kritike nuk ka pasur ndonjë përgatitje apo plan të përbashkët që si bashkë kryes të kryejnë veprën penale të vrasjes ngase të pandehurit nuk kane ditur që ditën kritike do ta takojnë të dëmtuarin M.i cili sipas të pandehurve i ka provokuar të njëjtit. Mbrojtja ka cituar dy rreshta e dispozitivit të I-rë dhe atë “Ku i pari nga vetura del i pandehuri A.1 me mjet të fortë (shkop) në dorë i cili vrapon në drejtim të të dëmtuarit M.” kjo është e vërtet ngase një veprim i tillë shihet qarte edhe ne video incizimet nga vendi i ngjarjes, mirëpo në këtë incizim e kemi parë se A.1i me shkop në dorë del nga vetura dhe vrapon në drejtim të të dëmtuarit M., mirëpo derisa ishte duke vrapuar ne drejtim të M. , A.1i kalon për skaj tani të ndjerit Fazli edhe pse e vëren të njëjtin e tejkalon dhe shkon tek i dëmtuari M.e të cilin fakt A.1i ka thënë se e ka parë F. por ka shku në drejtim të M. për t’ia dhënë disa shuplaka për provokimet që iu ka bërë dhe asgjë tjetër. Pra nga kjo shihet se nuk ka ekzistuar dashja që të privohet kushdo qoftë nga jeta nga anëtarët e familjes por vetëm të rrahët M.për shkak të provokimeve të vazhdueshme dhe rrahjes së vëllait të të pandehurve nga vëllai i M.. Edhe nga video incizimi i vendit të ngjarjes shihet kur A.1i kthehet nga vendi që vraponte në drejtim të M. dhe tani pa shkop në dorë, ngase ky shkop i kishte ra nga dora, pasi që ishte godit nga pas nga familjaret H. dhe në momentin kur dëgjohej krisma e armës A.1i ishte larg vendit ku ishte privuar nga jeta i ndjerit F.H.. Sipas mbrojtjes nuk ishte kontestuese që në këtë përleshje përveç A.1it që kishte shkop druri (që i ka sherby më parë për punët e përditshme) shkop të drurit kishte edhe N.i, e po ashtu edhe i pandehuri Bahri kishte një shkop druri në dorë, pra tani nëse përdoret logjika në këtë mes shtohet pyetja “nëse sipas aktakuzës vëllezërit G. për shkak të hakmarrjes së paskrupullt si bashkë kryes kanë planifikuar të kryejnë veprën penale të vrasjes së familjareve H. pse të marrin pjesë edhe katër vëllezërit në këtë ngjarje dhe tre prej tyre me shkop druri?”

këtë mbrojtja e thotë nga fakti se po të ekzistonte dashja që në ditën kritike ta privojnë nga jeta ndonjërin nga familjaret e familjes H., me sigurinë ma të madhe kishte dalur për kryerjen e hakmarrjes vetëm njeri nga vëllezërit dhe atë në kohën dhe vendin e caktuar, kur kishte me qenë vetëm këtu i dëmtuari M., sepse siç e kanë deklaruar të pandehurit e tjerë dhe vet i pandehuri A.1, qëllimi ka qenë që të rrahet M. për shkak të provokimeve të vazhdueshme që i njëjti i ka bërë vëllezërve G.. Tutje mbrojtja ka shtuar se i mbrojturi i tij sipas dispozitivit të dytë akuzohet se si bashkë kryes ka kryer veprën penale të vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë nga neni 173 par. 1 nën 1.5 dhe 1.8 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPRK-së. Meqenëse edhe në këtë dispozitiv përshkruhen veprimet e njëjta për të mbrojturin e tij A.G.1, si në dispozitivin e parë, si mbrojtës konsideron se të gjitha pretendimet për dispozitivin e parë vlejné edhe për dispozitivin e dytë të kësaj aktakuze. Mbrojtja konsideron se në këtë çështje penalo juridike tek i mbrojturi i tij në rastin e pavolitshëm formohen elementet e veprës penale të pjesëmarrjes në rrahje nga neni 187 par. 1 të KPRK-së. Andaj kërkon nga gjykata që aktakuzën e Prokurorisë Themelore në Pejë ta ndryshoj asisoj që të pandehurin A.G.1 ta shpalli fajtor për veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 187 par. 1 dhe njëherëit të ia ndërpresë masën e paraburgimit.

I pandehuri A.G.1, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Mbrojtësi i të pandehurit A.G. av. N. D., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar: fillimisht ka bërë përshkrimin e dispozitivave sipas së cilave akuzohet i mbrojturi i tij A.G. dhe atë për veprat penale vrasje e rëndë e kryer në bashkëkryerje nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 e lidhur me nenin 31 si dhe vrasje e rëndë e mbetur në tentativë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 e lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së. E më pas mbrojtja ka cituar deklaramet e të mbrojturit të tij të dhëna në polici dhe deklaramet e tij të dhëna gjatë shqyrtimit gjyqësor e të cilit deklarim pra këtij të fundit i mbrojturi i tij qëndron pranë. Tutje mbrojtja ka theksuar se asnjëri nga të pandehurit nuk e vërteton faktin se i pandehuri A. në një mënyrë i ka urdhëruar të pandehurit e tjerë të shkojnë dhe të e përcjellin të dëmtuarin M. sa do që i pandehuri A. në një mënyrë në deponimin e tij të le përshtypje se i njëjti ju ka treguar për M. se në ç drejtim ka shkuar, por të pandehurit –vëllezërit e tij vërtetojnë të kundërtën se dhe ata vetë kanë qenë prezent kur ka kaluar M. dhe pa urdhrin e askujt kanë shkuar pas tij. Mbrojtja ka përmendur edhe deklaramet e dëshmitarëve E.B., I.B., L. B., A.T., R. R. dhe B. B. të cilat deklarime sipas mbrojtjes nuk vërtetojnë asgjë nga faktet apo përshkrimi faktik i aktakuzës, asnjëri nga këta dëshmitarë nuk din e as nuk kanë parë asgjë nga veprimet konkrete të pandehurit A., qak nuk vërtetojnë dhe nuk e din se a kanë parë në vendin e ngjarjes pasi që këta dëshmitar janë dalur nga restoranti pasi që kanë dëgjuar të shtënat dhe pas të shtënave sipas provave materiale dhe ka përfunduar gati çdo gjë. Mbrojtja si provë të rëndësishme ka cituar dhe elaboruar CD-të nga kamerat e siguruarat në restorantin e nga të cilat gati në mënyrë të sigurt shihen veprimet konkrete të çdo njërit të pandehur. Sipas mbrojtjes për prokurorin ka mjaftuar fakti se të pandehurit kanë qenë vëllezër kanë jetuar në një bashkësi familjare e kanë patur vëlla personin që vëllezërit e viktimave e kanë rrahur në Itali, e kanë patur motivin të gjithë për hakmarrje, kanë qenë të gjithë në vendin e ngjarjes dhe bashkërisht janë larguar nga vendi i ngjarjes, këto fakte për prokurorin kanë mjaftuar që nuk janë kontestuese për të i trajtuar të gjithë si bashkë kryes. Me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar fakti i ndonjë marrëveshje paraprake

në mes të pandehurve se do të kryejnë këtë veper penale, kur, ku dhe si do të e kryejnë si elemente të tjera që vërtetojnë ndonjë veprim paraprak apo marrëveshje paraprake të pandehurve për kryerjen e kësaj vepre penale (elaboron formën e bashkëpunimit si veper penale). Provat personale dhe materiale kanë vërtetuar se deri te takimi me të dëmtuarit është ardhur rastësisht. I pandehuri A. deri sa ishte duke prituri në auto i fundit del nga autoja ka dalur pa asnjë mjet apo armë në dorë ka sulmuar me grushta dhe në ndërkohe e ka marr një shkop nga një i bashkëpandehur dhe e ka goditur një herë apo dy në viktimën por jo në të ndjerin Fazli. I pandehuri A. nuk ka pasur asnjë kontakt me të ndjerin F., asnjë përleshje me të dëmtuarin M., nuk ka qenë afër personit që ka shtënë me armë madje kur personi ka shtënë me armë i pandehuri A. ka qenë i ndarë nga të pandehurit e tjerë siç shihet në CD-në. Prandaj pranë gjendjes së përshkruar të fakteve sipas bindjes së mbrojtjes pa mëdyshje rezulton se i pandehuri A. nuk ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet, provat sa i përket këtyre veprave janë të pamjaftueshme dhe të pabesueshme për të rrëzuar prezumimin e pafajësisë së të mbrojturit të tij (neni 3 i KPP in dubio pro reo). Nuk është vërtetuar veprimi i natyrës objektive apo subjektive për kryerjen e kësaj vepre penale apo ndonjë vepre tjetër nga kapitulli i këtyre veprave, përjashton lëndimin e lehtë trupor apo të rëndë nga neni 185 dhe 186 të KPRP-së. Në fund mbrojtja ka kërkuar nga gjykata që kërkesa e tij ka qenë që para marrjes së vendimit të shikohen edhe një herë provat dhe të merret një vendim në përputhje me gjendjen e vërtetuar faktike të lirohet i pandehuri A.G. duke mos përjashtuar mundësinë e ri cilësimit bazuar në gjendjen e fakteve të vërtetuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Të merren parasysht rrethanat lehtësuese pasi që rrethana rënduese nuk ka.

I pandehuri A.G., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Mbrojtësi i të pandehurit B.G.1 av. G.K.1, në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar se aktakuza është në kundërshtim me dispozitat e nenit 235 par. 1.5 par. 1.7 të KPPRK-së, se prokurori i shtetit nuk jap asnjë arsye të vetme se me cilat prova personale dhe materiale erdhi deri te konstatimi se i pandehuri B.G.1 ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Tutje mbrojtja ka parashtruar pyetje se si është e mundur që të akuzohen 4 persona kinse kanë kryer vepren penale vrasje e rëndë nga neni 173 par. 1 nën par. 1.5 dhe 1.8 të KPRK-së, a e përdoren të gjithë të pandehurit armën në fjalë në momentin kritik? Me pas mbrojtja citon përshkrimin e dispozitivit duke apostrofuat personin në aktakuze dhe atë: merr shenjën në drejtim të viktimit dhe i godet me predhe në kokë, pikërisht në syrin e majtë ku viktimë rrëzohet pa shenja jete. Prandaj në rastin konkret do të kishte ekzistuar vetëm në këto rrethana do të kishte bashkëkryerje në përdorimin e mjeteve të tjera të forta, edhe mjeku ligjor dr. N.U. në faqen e 3 (tre) të plotësimit të raportit të autopsisë ka konstatuar se në regionet e ndryshme trupore nuk ka lënë gjurmë të dëmtimeve përveç gishtërinjve, dërmishje dhe ndrydhje. Mbrojtja ka cituar deklarin të mbrojturit të tij se si ai nuk ka qenë në vendin e ngjarjes dhe ka shpjeguar se ka qenë në largësi prej rastit që ka ndodhur dhe nuk e ka ditur në ato momente se kush dhe si është vrarë i ndjeri. E që një pretendim i tillë është vërtetuar edhe nga deklarinet e të pandehurve të tjerë. Mbrojtja e vë në dyshim kualifikimin juridik sepse motiv i pandehuri nuk mund të kishte përderisa i pandehuri dhe viktimë nuk janë njohur më parë këtë prove mbrojtja e konsideron si me të rëndësishme që e dëshmon këtë pretendim. Pastaj mbrojtja si çështje të rëndësishme që është lidhja kryesore shkak- pasojë e që në rastin konkret nuk qëndron ngase pasojë vdekja e

viktimës F. nuk ka ardh si shkak i goditjeve të cilat Prokurori i shtetit ia vë në barrë të mbrojturit të tij pa asnjë dëshmi apo prove valide, por ka ardh si rezultat i përdorimit të armës nga dikush tjetër e jo nga i mbrojturi i tij. Prokurori i shtetit me çdo kusht dëshiron ta implikojë të mbrojturin e tij kinse i pandehuri e ka godit me lopate te ndjerin edhe pse ne video inqizimet nga vendi i ngjarjes shifet se i pandehuri B. nuk e ka goditur të ndjerin F. me lopatë. Ka cituar edhe pjesën e dispozitivit kur prokurori i shtetit e akuzon të pandehurin B. në bashkëkryerje ka kryer veprën penale vrasje e rëndë e mbetur në tentative e që dispozitivitë II- të i aktakuzës bie në kundërshtim me vetveten. Sepse për tu realizuar ky kualifikim i veprës penale kërkohet të realizohet elementi objektiv dhe subjektiv. Në rastin konkret nuk ka ekzistuar mizoria, dinakëria apo shkaktimi i vuajtjeve që vë në pikëpyetje ekzistencë e më tejshëm ndaj të dëmtuarit A., po ashtu nuk ka prove që mund të dëshmonte që i pandehuri B. në bashkëkryerje ka dashur të privojë A. apo dikë tjetër nga jeta. Mbrojtja ka thënë se nga vetë fakti se i pandehuri ka pranuar fajin që ka pasur një lopate pune në dorë dhe me të ka goditur dy herë të dëmtuarin A. ne pjesën e poshtme të trupit është jo kontestuese se i pandehuri vetëm i ka shkaktuar lëndime të lehta trupore të dëmtuarit A. dhe se asnjëherë i pandehuri B. nuk dashur të privojë nga jeta atë. Shpreson që nga gjykata të këtë drejtësi me objektive dhe të paanshme duke u bërë rikualifikimi juridik dhe i pandehuri Bahri i akuzuar për bashkëkryerje të vrasjes së rëndë të mbetur në tentativë të akuzohet dhe të mbahet përgjegjës vetëm për lëndime të lehta trupore, ku fajësinë për të njëjtat (lëndime të lehta trupore) veçse i ka pranuar.

I pandehuri B.G.1, në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Mbrojtësi i të pandehurit Y.G. av. T. Rr., në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim ndër të tjera ka theksuar se, Organi i akuzës në pamundësi të vërtetimit të pretendimeve të veta me prova të mirëfillta personale dhe materiale, tentonte të bartë barrën e provës tek i pandehuri Y.G.. Se sa i pafajshëm është klienti Y.G. për veprat penale që i vihen në barrë, dhe sa padrejtësisht i njëjti gjendet para bankës së të akuzuarit, i akuzuar për tre vepra penale Sipas mbrojtjes, dikush mund të konsiderohet si ndihmës duhet plotësuar këto kritere sic janë : 1. kriteri objektiv (*ndërmarrja e veprimit që paraqet kontribut në kryerjen e veprës*) dhe 2. Kriteri subjektiv (*respektivisht dijenia e ndihmësit se veprimi i tillë do të kontribuojë në kryerjen e një vepre penale*). Në rastin konkret prova e vetme që ka paraqitur PTHP, në mbështetje të konsumimit të këtyre dy kushteve madje madje vetëm njërit kusht atij objektiv, e që besa tri veprave penale që klientit të tij i vihen në barrë është, Raporti i Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare Për Forenzikë nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, sipas të cilit raport nga dëshmia #1-gëzhjojë 7.62x25 mm e gjetur në vendin e ngjarjes, është përfituar një profil i ADN-së i përzier nga dy persona ku njëri prej tyre është profili i Y.G.t. Tutje ka thënë se ekziston mungesa e kredibilitetit të Raporti AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022 si prove materiale, mund të nxirret nga vetë mangësitë, kontradiktoriteti dhe pasiguria që vetë përpiluesi i këtij raporti Bashkim Muatafa i ka shprehur në përpilimin e kësaj ekspertize. Sepse aty ku eksperti ka qenë i sigurve për saktësinë e konstatimit të tije e ka thënë shprehimisht qoftë në ekspertizë qoftë gjatë këtij shqyrtimi gjyqësor. Psh, kur është fjala për njollat e gjakut #20#21#22#23 gjetura në vendin e punëtorinë “.....” i njëjti në faqe 6 pika 4 e Raporti nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, i njëjti thekson se nga këto njolla është

përfitur një profil i ADN-së së Y.G.t dhe jep marzhën e ngjashmërisë që ky profil ka në popullacionin botëror në 1 në 141 triliard banor. Sipas deklaratimit të ekspertit në këtë shqyrtim gjyqësor, qëllimi dhënies së kësaj marzhe është për të treguar se ky profil nuk ka mundësi të jetë i dikujt tjetër pos i Y.G.t, sepse bota i ka 7 miliardë banorë e ndërsa ky profil përsëritet një herë në 141 triliard banorë (*shif faqe 10 pasuesi i fundit dhe vazhdim i faqe 11, dhe faqe 13 pasuesi 11 i procesverbalit të datës 30.01.2024*). Nëse alelet nga mostrat referuese me profilin e nxjerrur nga gëzhoja nuk përkojnë as për së afërmi njëra me tjetrën, si ka mundësi që konstatimi se në gëzhojën #1 është përfitur një profil i ADN-së i Y.G.t. Në anën tjetër, nga tabelarët e mësipërm të gjitha alelet nga mostrat referuese janë në plotni në dakordancë me alelet nga profili i ADN-së, të nxjerra nga njollat e gjakut #20, #21, #22, dhe #23, dhe mu për këtë arsye konstatimi i ekspertit është i saktë se njollat e gjakut i takojnë Y.G.t, dhe mu për këtë arsye i njëjti ka dhënë edhe marzhën e ngjashmërisë në popullacion në 1 në 141 triliard banorë. Pra kjo që u tha nuk mund të jenë të dy këto konstatime në vëllimin e njëjtë të saktësisë, por njëra është e sigurtë që njollat e gjakut i takojnë Y.G.t, e rrjedhimisht nuk është e sigurtë se nëse profili i nxjerrur nga gëzhoja është kontribues Y.G., andaj mbrojtja e konsideron këtë ekspertizë të mangët se nuk ka fuqi provuese të mjaftueshme nga arsyet e cekura me lartë. Pastaj mbrojtja ka thënë se ekziston mungesa e relevancës së Raporti i Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare Për Forenzikë nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022 ngase organi i akuzës është shërbyer me përfundime logjike dhe dedukcione, ku në bazë të fakteve që e njëjta pretendon se i ka vërtetuar, ka ardhur në përfundimin e ekzistencës së fakteve të pavërtetuara. Prokuroria, ka mjaftuar fakti që e njëjta ardhur në përfundim se profili i ADN-së, së Y.G.t është gjetur në një gëzhojë, për ti veshur të njëjtit se i njëjti ka dhënë edhe armën e gëzhojës të pandehurit N.G., dhe atë në punëtorinë ‘..... I mbrojturi i tij Y.G. ditën kritike gjatë paradites ka vijuar mësimin në Shkollën e Mesme (e cila as për prokuroren nuk është kontestuese), ndërsa gjatë pjesës së pasdites i njëjti është kthyer në shtëpi ku gjatë kësaj kohe as nuk është takuar me ndokënd, e as që ka ardhur në shtëpi ndokush për të kërkuar, deri në dark imin e iftarit ku i ftuar në familjen e tij kishte qenë një mik i babait të tij nga fshati Rakovinë K.K Gjakovë. Pretendimin se i mbrojturi i tij kinse i ka dhënë armën të pandehurit N., PTHP përveç prezumimeve të lartcekura, e ka mbështetur edhe në rrethana periferike si, faktin që arma është gjetur në parcelën e punëtorisë ‘..... Sa përket armës së gjetur, vetë i akuzuari N. ka deklaruar se pas rastit, i njëjti e ka hudhë armën me vëlluan e tij A.1in dhe B. e tek pllaci në fjalë, ndërsa nuk është kontestuese faktin se pllacet e të pandehurve me pllacin e babait të klientit të tij janë fqinjë, dhe vetëm një muri i ndanë. Po ashtu mbrojtësi ka theksuar kundërligjshmërinë e nxjerrjes së Raporti i Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare Për Forenzikë nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, mbrojtja e arsyeton për faktin se e njëjta është nxjerrur bazuar në mostrat e pështymës së dhënë nga Y.G. në cilësi të dëshmitarit dhe në kundërshtim me nenin 145 par 3 Kodit të atëhershëm të Procedurës Penale Nr. 04/L-123. Për më tepër shif, Procesverbalin e Marrjes në Pyetje të Dëshmitarit me nr. të rastit 2022-DA-203 2022-HRP-57 i datës 17.05.2022. Në bazë të kësaj që u tha më lartë, Y.G. në polici vetëm formalisht është proceduar në cilësinë e dëshmitarit, mirëpo faktikisht është trajtuar në cilësi të të dyshimit. Nëse, Y.G. është marrë në pyetje në cilësi të dëshmitarit, shtrohet pyetja se nga cila normë juridike zyrtarët policor e nxorën tagrin apo autorizimin për marrjen e mostrave të ADN-së, nga dëshmitari duke e ekspozuar kështu të njëjtin para ndjekës penale, kur Kodi i Procedurës Penale përcakton në mënyrë eksplicite se vetëm të pandehurve dhe të dëmtuarve mund tu merren mostrat e tilla. Pra në bazë

të kësaj që u tha më lartë, përderisa Raporti i Eksperimentimit i Agjencisë Kosovare Për Forenzikë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, është përpiluar bazuar në mostrat e pështymës së marra nga Y.G., në kundërshtim flagrant me dispozitat e Kodit të procedurës, automatikisht i njëjti raport është provë e pavlefshme për të mbrojturin e tij. Po ashtu mos plotësimi i kriterit subjektiv nga organi i akuzës pasi që prokurorja nuk e ka vërtetuar dijeninë e të mbrojturit të tij për qëllimin e kryerësit me "dhënien e armës" e aq më tepër motivit apo shkakut, në fakt mbrojtja e ka vërtetuar që i mbrojturi i tij lere që nuk ja ka dhënë armën ndokujt, e lere që nuk ka ditur për qëllimin e ndokujt, por as që ka pasur motiv për të bërë një gjë të tillë bazuar nga një varg rrethanash të provuar në shqyrtim gjyqësor. Po ashtu ka cekur se xhaxhai i të pandehurit Y. respektivisht Hasan Gashi natën kritike, i ka dhënë ndihmën e shpejtë të ndjerit duke ngasur makinën e autoambulancës nga QKMF në Klinikë për në Spitalin Rajonal në Pejë. sipas mbrojtjes sikur H. G. të dinte për problemin e familjes H. me familjen e të dëmtuarve, atë natë do të ishte e nuk do të qëndronte në ato momente afekti dhe tronditje duke ekspozuar vetën para një rreziku permanent për jetën e tij. Mbrojtja tutje ka theksuar në aktakuzë ka Mungesa formale të aktakuzës (mungesa e aktvendimit për fillimin e hetimeve për veprën penale V të aktakuzës PP/I Nr. 142/2022). Mbrojtja është e bindur që trupi gjykues do të zgjidh prezumimin e pafajësisë karshi paragjykimeve, sigurinë juridike karshi persekutimit, dhe rehabilitimin karshi damkosjes dhe stigmatizimit. E kjo sipas mbrojtjes mund të arrihet vetëm përmes një aktgjykimi lirues për klientin e tij Y.G. nga neni 363 par 1 të KPRK-së.

I pandehuri Y.G., në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet në tërësi fjalën e mbrojtësit të tij, nuk ka tjetër çka të shtojë.

Gjendja faktike e vërtetuar nga gjykata

Pjesa Liruese

Gjykata pas administrimit të provave në shqyrtimin gjyqësor, vlerësoi se nuk ka prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se i pandehuri Y.G., ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet sipas aktakuzës së, Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.142/2022 të dt.03.02.2023.

Sipas aktakuzës se lartë cekur i pandehuri Y.G., akuzohet për tri vepra penale dhe atë për shkak të veprës penale, ndihma në kryerjen e veprës penale "Vrasja e rëndë" nga neni 173, par. 1, nënpar. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 33, të KPRK-së.

Veprës penale ndihma në kryerjen e veprës penale "Vrasja e rëndë në tentativë" nga neni 173, par. 1, nën par. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 33, të KPRK-së, dhe Veprës penale, "Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë si një nga format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale edhe "Ndihmen" e cila është paraparë ne nenin 33 të KPRK-së. Neni 33 par 1 ka paraparë 1. "Kushdo që me dashje ndihmon personin tjetër për kryerjen e veprës penale dënohet më dënim më të butë sesa kryesi i veprës". Ne paragrafin 2 të po këtij neni është cekur

se cilat veprime konsiderohen si ndihmë, e që përfshinë, “Ndhma për të kryer një vepër penale përfshin, por nuk kufizohet në: dhënien e këshillave ose udhëzimeve se si të kryhet vepra penale; vënien në dispozicion të mjeteve për kryerjen e veprës penale; krijimin e kushteve ose mënjanimin e pengesave për kryerjen e veprës penale; ose premtimi paraprak se do të fshehë provat e kryerjes së veprës penale, kryesin apo identitetin e kryesit, mjetet e përdorura për kryerjen e veprës penale ose përfitimet që rrjedhin nga kryerja e veprës penale”

Sipas aktakuzës i pandehuri, Y.G. akuzohet se të pandehurit N.G. i ka siguruar armën/pistoletën e llojit TT, me nr. serik: 7588839661962, duke i vënë në dispozicion të njëjtën me qëllim të kryerjes së veprës penale në dëm të tani viktimës F.H. dhe të dëmtuarve M.dhe A.H..

Për tu konsiderua se i pandehuri ka ndihmuar në kryerjen e veprës penale, duhet të përmbushur elementi subjektiv e që është dashja, tek i pandehuri duhet të ekzistoj dashja për ti ndihmuar një personi qe i njëjti ta kryejë veprën penale, e që vetvetiu kuptohet se nëse ekziston dashja atëherë ekziston edhe dijenia se po e ndihmon një person ne kryerjen e veprës penale.

Kushti i dytë, për tu përmbushur figura e veprës penale, ndihma ne kryerjen veprës penale është elementi objektiv e që është ndërmarrja e veprimit që paraqet kontribut në kryerjen e veprës penale, e që ne rastin konkret i pandehuri Y.G. akuzohet se te pandehurit N. i ka ven ne dispozicion, armën me qëllim të kryerjes së veprës penale në dëm të tani viktimës F.H. dhe të dëmtuarve M.dhe A.H..

Para se të vlerësohet kriteri subjektiv se i pandehuri Ylli me dashje i ka siguruar pistoletën te pandehurit N., gjykata gjeti se në rastin konkret nuk është vërtetuar as kriteri objektiv, përkatësish nuk ka prova se i pandehuri Y.G., i ka vënë ne dispozicion armen te pandehurit N.G., për me tepër prokuroria nuk ka afruar prova se i pandehurit Ylli te ketë poseduar ndonjëherë atë pistoletë.

Prokuroria faktin se i pandehuri Y.G. ja ka siguruar armen të pandehurit N. e mbështet në, Raportin e Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare Për Forenzikë nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, sipas të cilit raport nga dëshmia #1-gëzhojë 7.62x25 mm e gjetur në vendin e ngjarjes, është përfituar një profil i ADN-së, i përzier nga dy persona ku njëri prej tyre është profili i Y.G.t, si dhe ne faktin se ne pllacin- punëtorinë ku është gjetur pistoleta me te cilën është kryer vepra penale, janë gjetur disa njolla gjaku qe i përkasin të pandehurit Y.G..

Edhe pse sipas ekspertizës, nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, nga dëshminë #1-gëzhojë 7.62x25 mm, e gjetur në vendin e ngjarjes, është përfituar një profil i ADN-së, i përzier nga dy persona ku njëri prej tyre është profili i Y.G.t, për gjykatën, nuk është provë që vërteton edhe faktin se i pandehuri Y. i ka siguruar armen, përkatësish pistoletën te pandehurit N., gjykata vlerëson se kjo provë vërteton se i pandehuri Y.G., një herë ka mundur të ketë kontakt me atë fishek –gëzhojë të asaj pistolete por kurrsesi nuk vërteton se i pandehuri Y.G., i ka siguruar pistoletën të pandehurit N., pasi qe ne ketë rast nuk kemi ndonjë provë tjetër materiale apo personale që mbështet këtë fakt.

Prokuroria gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk ofroi asnjë provë të vetme se i pandehuri Y.G. te ketë pas kontakt me të pandehurit tjerë, ditën kritike apo edhe disa ditë para ditës kritike, përveç faktit se të njëjtit janë kushërinj dhe punëtoritë i kanë afër njëra tjetrës në kufi (mexhë) me njëra tjetrën në fshatin Volljak. Prokurori nuk ofroi ndonjë prove se i pandehuri Y.G., të ketë pasur ndonjë motiv për të kryer këto vepra penale, pasi që i pandehuri Y.G. deklaroi se familjen H., para ditës kritike nuk i ka njoftë dhe nuk ka dëgjuar për ta dhe nuk e ka ditë për ndonjë mosmarrëveshje eventuale që mund të kenë pasur familja e të pandehurve me familjen H..

Sa i përket armës së gjetur në punëtorinë ‘.....’ e cila punëtori është pronë e babait të Y.G.t, dhe fakti që në zyrën e të njëjtës punëtori janë gjetur disa gjurmë gjaku që i takojnë Y.G.t, sipas vlerësimit të gjykatës nuk vërtetojnë se i pandehuri Y.G. i ka siguruar pistoletën të pandehurit N., sepse edhe vetë i pandehuri N. në deklaratën e dhënë në Polici dhe Prokurori, ka deklaruar se pas rastit, i njëjti e ka hudhë armën me vëllezërit e tij, A.1in dhe B. tek pllaci në fjalë, ndërsa nuk është kontestues fakti se pllaci- punëtorja e të pandehurve me pllacin- punëtorin e babait të Y.G.t, janë fqinjë dhe vetëm një muri i ndanë.

Gjurmëve të gjakut të gjetura në zyrën e punëtorisë ‘.....’, nuk vërtetojnë, faktin se te njëjtat gjurmë kanë lidhje me rastin konkret të ndodhur ditën kritikë, përderisa Prokurori nuk ka ofruar ndonjë, provë që i pandehuri Y.G. të ketë qenë në vendngjarje ditën kritike. I pandehuri Y.G. deklaroi se te pikat e gjakut në punëtorinë “.....” që është pronë e babit të tij, janë aty se paku katër ditë para ditës kritike, ku i pandehuri ishte në punëtorin “.....” duke e pritur babain e tij, këtu dëshmitarin Q.G. të kthehej nga fshati Kralan ku ishte duke punuar dhe të shkonin bashkë për në Klinikë, dhe gjaku i kishte rrjedhur nga hunda të pandehurit Y.G..

Dëshmitarja V.G., deklaroi se djali i saj Y.G. ditën kritike me dt. 28.04.2022, ka qenë në shkollë, nga ora 07:30 dhe është kthyer në orën 13:30, faktin se Y. ka qenë në shkollë nga ora 07:30 e deri në ora 13:30, nuk e ka kontestuar as Prokurori i Shtetit. Dëshmitarja V., deklaroi se pasi që Y. është kthyer nga shkolla ditën kritike, atë ditë nuk ka dal nga shtëpia asnjëherë por ka qëndruar në shtëpi ku ka pushuar dhe i ka ndihmuar në disa punë të oborrit të shtëpisë.

Po ashtu dëshmitari Q.G., babai i të pandehurit Y.G., deklaroi se ditën kritike, ka qenë duke punuar në fshatin Kralan, ndërsa djali tij Y., ka qenë në shkollë nga ora 07:00 ose 07:30 e deri në orën 13:30, dhe kur është kthyer nga shkolla, dëshmitari e ka telefonuar djalin e tij Y. përafërsish ka ora 14:00, ku në këtë rast dëshmitari i ka thënë Y., meqenëse je axherushëm te mos del hiq në punë. Dëshmitari Q.G., është kthyer në shtëpi diku në orën 19:00 dhe kur është kthyer në shtëpi Y. e ka gjetur në shtëpi. Atë natë për darkë-iftar, kanë pas mysafirë një familje nga fsh. Rakovinë e Gjakovës, në të cilën familje kanë punuar dhe kanë raporte miqësore. Ndërsa sa ju përket raporteve me të pandehurit tjerë dëshmitari ka deklaruar se, raportet i kanë normale si djem të axhës, ndërsa për vizita i kanë shumë rrallë e dinë se A.i ka qenë njëherë përafërsish para 3 vite, ndërsa te tjerët nuk i kujtohet se kanë qenë ndonjëherë. Po ashtu dëshmitari ka deklaruar se nuk ka dëgjuar për mosmarrëveshjen që kanë pas familja H. me të pandehurit tjerë këtu.

I pandehuri Y.G., ne deklaratën e tij te dhënë ne Gjykatë deklaroi se me dt. 28.04.2022, në mëngjes si zakonisht ka shku, në shkollë ne ora 08:00, deri për afërsisht kah ora 13:30, më pas është kthyer në shtëpi, ka pushu pak sepse ka qenë me Ramazan, e ka rregullu pak barin në oborr, dhe e ka prit iftarin dhe ka bërë iftar në shtëpi. Atë dite nuk është dal nga shtëpia asnjëherë ne qytet. Lidhur për pikat e gjakut të gjetura ne punëtorinë “.....” ka deklaruar tri apo katër ditë para rastit, ka qenë ne punëtorinë e tyre duke e pritur babain e tij, për me shku me u bo bashkë në fsh. Volljakë për me shku për iftar në shtëpi. Baba i tij ka qenë duke punuar në një fshat Kralan në Gjakovë, dhe i ka thënë se vonohet pak dhe të hynë për te pushuar pak në veturë, ose në zyrë në fsh. Volljakë I pandehuri Ylli, ka hy në zyrë në punëtorinë e quajtur “.....” në pllacin në fsh. Volljakë, ka pushu pak dhe në momentin kur është ngritur si shpejtë i kanë qit hundë gjak, aty në zyrë nuk ka pas as ujë as palloma prandaj gjaku i ka pike ne tokë, dhe mandej ka dal prej derës së zyrës dhe ka shku tek makinat jashtë zyrës me lyp ujë apo pallomë për me i fshi hundët. Tutje ka thënë se me të pandehurit e tjerë është familjar dhe para ditës kritike nuk është shoqëruar, me dal me pi kafe apo me dal bashke, dhe se para ditës kritike nuk është takuar me asnjërin dhe se nuk i kujtohet se kur ka qenë hera e fundit se kur është takuar me ta mirëpo raportet i kanë të mira.

Sa i përket ditës kritike nuk ka prova se i pandehuri Y.G., te ketë pasur çfarëdo kontakti me te pandehurit tjerë, e po ashtu dëshmitaret Q. dhe V.G., si dhe i pandehuri Y. ne deklaratat e tyre te dhëna në gjykatë deklaruan se ditën kritike i pandehuri Y.G., ka shkuar ne shkollë ne mëngjes dhe pasi qe ka përfunduar shkollën është kthyer ne shtëpi ku ka qëndruar ter ditën, ndërsa Prokurori i Shtetit nuk ka ofruar ndonjë provë qe vërteton faktin se i pandehuri ditën kritike apo disa dite para ditës kritik te ketë pasur ndonjë kontakt me të pandehurit, e aq me pak te ketë biseduar apo t’ju ketë siguruar pistoletën te pandehurve tjerë me qellim qe te njëjtë te kryenin veprat penal te cekur me lartë.

Andaj gjykata ju fali besimin deklaratave të pandehurit Y.G., dëshmitarëve Q.dhe V.G., se i përket faktit se ditën kritike i pandehuri Y.G., nga ora 07:30 deri ne orën 13:30, ka qëndruar ne shkollë (fakt te pa kontestuar as nga ana e Prokurorisë), pastaj pasi qe është kthyer nga shkolla ka qëndruar në shtëpi ku ka ber iftare se bashku me familje. Prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë qe vërteton të kundërtën e kësaj, përkatësisht nuk ka afruar asnjë provë se i pandehuri Y.G., ditën kritik pasi qe është kthyer nga shkolla te ketë dalë nga shtëpia apo te ketë pasur çfarëdo kontakti më të pandehurit tjerë te këtij rasti.

Për gjykatën vetëm fakti se ne njëjërën gëzhjojë është gjetur profili i ADN-së, së të pandehurit Y.G., mbështetë një dyshim te bazuar mirë se i pandehuri Y.G., ka mundur ta posedoj atë pistolette por kursesi nuk mjafton për ta shpallur fajtor të pandehurin Y.G., për veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, pasi qe nuk ka prova tjetër materiale e as personale që vërteton, se i pandehuri Y.G. të ketë poseduar ndonjëherë atë pistoletë. Përveç faktit se ne njëjërën gëzhjojë është gjetur, profili i ADN se të pandehurit Y.G., e gjitha përtej kësaj mund vetëm të supozohet, se i pandehuri Y.G. a kishte kontakt vetëm me atë fishek- gëzhjojë, në të cilën është gjetur profili i tij i ADN-së, apo si ka mundur te arrij ky profil i ADN-së, ne atë gëzhjojë, pasi qe është fakt i njohur botërisht se fishekët edhe mund te ndahen nga pistoleta dhe jo gjithmonë e kanë burimin e njëjtë se ku mund te sigurohen.

Po ashtu prokuroria nuk ka ofruar prova që vërteton se, tek i pandehuri Y.G. të ketë ekzistuar dashja që të pandehurve tjerë, në ketë raste të ju siguroj ndihmë për kryejnë veprave penale për të cilat gjykata i shpalli fajtor si ne dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për me shumë prokuroria nuk ka ofruar asnjë provë se i pandehuri Y.G., te ketë pasur njohuri lidhur me problemet që kanë ekzistuar ne mes të familjes H. dhe familjes së te pandehurve tjerë këtu.

Gjykata pas administrimit të provave, përkatësisht pasi dëgjoji të dëmtuarit M.dhe A.H., dëshmitaren V.G., dëshmitarin Q.G., dhe te pandehurin, Y.G., vlerësoi se nuk ka prova që vërteton faktin se i pandehuri Y.G., ka poseduar pistoletën llojit TT, me nr. serik: 7588839661962, ndërsa vetëm profili i ADN-së, i të pandehurit Y. i gjetur ne njëren gëzhgojë ditën kritike, nuk është provë e mjaftueshme që vërteton përtej dyshimit të bazuar mirë se pistoletë e përdorur ditën krikët ka qenë në posedim të pandehurit Y.G., e për me tepër i pandehuri Y.G., ti ketë siguruar pistoletën të pandehurit N., me qellim që i pandehuri N. te kryej veprat penale për te cilën gjykata e shpalli fajtor si me lartë.

Gjykata me kujdes analizoi dhe vlerësoi mbrojtjen e të pandehurit Y.G., i cili nuk pranon faktin te ketë poseduar ndonjëherë atë pistoletë. Ndërsa si provë që lidhte të pandehurin Y.G. me atë pistoletë kishim vetëm ekspertizën nën shenjë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, ku nga dëshminë #1-gëzhgojë 7.62x25 mm, e gjetur në vendin e ngjarjes, është përfituar një profil i ADN-së, i përzier nga dy persona ku njëri prej tyre është profili i Y.G.t, për gjykatën, nuk është provë që vërteton faktin se i pandehuri Ylli e ka pasur në posedim, përkatësisht ti ketë siguruar te pandehurit N. G., pistoleten me qellim që i pandehuri N. ti kryej veprat penale te lartcekura, prandaj mbi bazën e këtyre dhe duke pas parasysh parimin “in dubio pro reo” përkatësisht nenin 3 par 2 te KPP-se ku thuhet se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”

Prokurorja gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk arriti që t’i argumentojë me prova para gjykatës se i pandehuri Y.G., ka kryer veprat penale për te cilat akuzohet. Andaj nisur nga të gjitha këto, Gjykata të pandehurin Y.G., e liroi nga aktakuza për veprën penale; “ndihma në kryerjen e veprës penale Vrasja e rëndë” nga neni 173, par. 1, nënpar. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 33, të KPRK-së ,për veprën penale “ndihma, në kryerjen e veprës penale Vrasja e rëndë në tentativë” nga neni 173, par. 1, nën par. 1.5 dhe 1.8, lidhur me nenin 28 dhe 33, të KPRK-së dhe veprën penale “Mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim te paautorizuar të armëve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së

Gjykata, ka vlerësuar edhe kërkesën-kundërshtimin, e mbrojtësit të pandehurit Y.G. av. Taulant Rraci, për shpalljen e Raportit të Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, si provë të papranueshme, me arsyetimin se është përpiluar ne kundërshtim me dispozitat e Kodit te Procedurës Penale, i cili ka qenë ne fuqi ne atë periudhë, bazuar në mostrat e pështymës së marrë nga Y.G., i cili në atë kohë është marrë ne pyetje në cilësi te dëshmitarit, ndërsa ne fund te marrjes në pyetje është kërkuar nga i njëjti të

jap pëlqimin për dhënien e shenjave të gishtave dhe pështymës. Andaj mbrojtja konsideron se këto prova janë marrë në kundërshtim me nenin 145 par 2 dhe 3 të KPP-së.

Gjykata vlerëson se një kundërshtim i tillë i mbrojtësit është i pa bazuar duke pas parasysh faktin se neni 144 par 5 të KPP-së (kodi Nr.04/L-123 i Procedurës Penal) që ishte në fuqi në atë periudhë ka përcaktuar se “Kur është e nevojshme mostra e flokut dhe e folikulës, pështymës, urinës, sekretit të hundës, pjesës sipërfaqësore të lëkurës duke përfshirë edhe zonën e ijëve, thonjtë e mostra të pjesës së poshtme të thoit si dhe mostra të tjera të ngjashme, të cilat nuk përbëjnë ndërhyrje trupore, ato mund të merren gjatë ekzaminimit fizik pa urdhër të veçantë të gjykatës”.

Ndërsa paragrafi 8 i nenit 144 ka përcaktuar se “Dispozita e nenit 139, paragrafi 2. i këtij Kodi zbatohet përshtatshmërisht në rastet kur personi, përpos të pandehurit, refuzon që t’i shtrohet kontrollit të urdhëruar nga gjykata. Detyrimi mund të përdoret vetëm me urdhër të posaçëm të gjykatës” andaj gjykata vlerëson se paragrafi 8 i këtij nenin i referohet personave tjerë përpos të pandehurit, ndërsa nga Procesverbali i Marrjes në Pyetje të dëshmitarit Y.G. me dt. 17.05.2022, shifet se në atë kohë dëshmitari Y.G. e ka dhënë pëlqimin pas asnjë kundërshtim, andaj si i tillë Raporti i Eksperimentimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë AKF/2022-2020/2022-45 të datës 26.10.2022, për gjykatën është provë e pranueshme edhe në raport me të pandehurin Y.G..

Konform nenit 453 par.1 të KPPK-së, shpenzimet procedurale që ndërlidhen me të pandehurin Y.G., bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

Pjesa Dënuese

Gjykata pas administrimit të provave, i ka vlerësuar të njëjtat veç e veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjendja faktike u vërtetua nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Veprat penale për të cilat të pandehurit, N.G., B.G., A.G., A.G.1 dhe B.G.1, janë shpallë fajtorë sipas Dispozitivit të parë (I) dhe të dytë (II), të pjesës dënuese të këtij aktgjykimi janë, vepra penale e kryer në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nënpar 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe vepra penale e kryer në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, si dhe i pandehuri N.G. edhe për shkak të veprës penale, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Neni 173 par 1 të KPRK-së, ka parapare: “Me dënim me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm dënohet personi i cili” ndërsa nënpar 1.8 të këtij neni, është paraparë që “privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, përfshirë hakmarrjen për dhënien e dëshmisë ose sigurimin në ndonjë mënyrë, tjetër të informatave për Policinë apo në procedurë penale”, e që në rastin konkret kemi të bëjmë nga neni 173 par 1 nënpar 1.8 të KPRK-së, pasi që Gjykata ka vlerësuar se motivi për të kryer veprat penale nga të pandehurit natën kritike ka qenë hakmarrja, për një rast që kishte ndodhur në Itali.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës, ka paraparë si një nga format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale edhe “Bashkëkryerja”. Neni 31 i KPRK-së, ka paraparë “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për vepër penale”.

Nga deklarata e të dëmtuarve, M.dhe A.H., Gjykata vërtetoi faktin se ditën kritike, i dëmtuari M.H., kishte ber rezervim ne Restorantin “.....” për te shku se bashku me familje për darkë-iftarë. Përafërsisht ne orën ora 19:30, të dëmtuarit M. H., A.H. dhe tani ndjeri F.H., se bashku me bashkëshorten dhe fëmijët të dëmtuarit M.H., dhe të fejuarën e të dëmtuarit A.H., arrijnë ne Restorantin “.....” i cili gjendet në fsh. Volljak. K Klinë.

Gjykata ja fali besimin deklaratës së të dëmtuarit, M.H. të dhënë ne shqyrtimin gjyqësor, pasi që deklarata ishte në përputhje, edhe me provat tjera materiale, si video-inqizimet e marra nga kamerat e Restorantit “.....”. I dëmtuari M.H., ndër te tjera ka deklaruar se, ditën kritike ka thirr në Restorantin “.....” dhe ka rezervuar iftarin për 7 persona. Ka ora 19:00 e diçka, ka shkuar ne Restorant se bashku me tre fëmijët e tij dhe bashkëshorten e tij me një veturë te modelit Porche –Panamera, ndërsa vëllai F. tani i ndjeri, ka qenë në një veturë tjetër te modelit BMW4, me vëllain A. dhe nusen e A.. Kanë hyrë ne Restorant brenda ku vëllai i pronarit i ka udhëzuar për tek tavolina, çdo gjë ka qenë në rregull, nuk e din sakt sa kanë qëndruar ne Restorant përafërsisht një orë, dhe pasi dhe kanë ngrënë iftar kanë dal nga Restoranti. I pari ka dal M., me dy djemtë e tij nga Restoranti, dhe është drejtuar në drejtim të veturave së bashku me dy djemtë e tij, në atë moment e ka dëgjuar një zë, ka bërtit gruaja M., ka thënë “ ruju se të mbytën”, kur e ka kthyer kryet M. pas, i ka parë 3 apo 4 persona, duke vrapuar në drejtim të tij. Pastaj kanë sill në të sa kanë mujt me mjete të forta, kanë qenë kacija, mjetet e punës, stupca etj. I dëmtuari M.H. po ashtu ka deklaruar se, kur e kanë godit në kokë i ka humb vetëdija, mirëpo nuk është rrëzuar, pastaj e ka dëgjuar një zë duke thënë “vraje”, pastaj ne atë moment e kanë godit me armë në këmbën e majtë, mirëpo nuk e ka ditë cili e ka goditë. I dëmtuari M.ka hy brenda në Restorant dhe ka thënë : “ a ka Zot dhe a ka njerëz se del na ndihmon se mbarum”. Pasi qe ka kërkuar ndihmë në Restorant është kthyer përsëri të dal nga Restoranti të shkoj tek vëllezërit, i ka parë të pandehurit duke i goditur vëllezërit e tij mjete të forta. Në momentin kur ka dal nga Restoranti, pasi që kërkuar ndihmë, vëllai i ndjerë ka qenë i shtrirë në tokë, në pjesën e djathtë të parkingut të Restorantit, ndërsa A. ka qenë gati i shtrirë në tokë, kanë qenë duke e goditur me mjete të forta non stop.

I dëmtuari A.H., në shqyrtimin gjyqësor kur përshkruante, ngjarjen e ndodhur, ndër të tjera deklaroi se, ditën koritke ka biseduar me vëllain M. dhe kanë len me ngrënë darkë-iftar me familje, sepse ka qenë Ramazan, rezervimin e ka ber M., kanë shkuar në Restorant diku kah ora 19:00, mirëpo nuk e di saktë. Në Restorant ka shkuar me veturën tij, se bashku me të fejuarën e tij, me të ishte edhe tani i ndjeri F.H., ndërsa M. ka qenë me veturën tjetër së bashku me bashkëshorten e tij, dy djemtë e tij dhe vajzën e vogël. Kur kanë shkuar në Restorant kamarier ka qenë E.B., vëllai i pronarit të Restorantit. Ne Restorant kanë qëndruar, ndoshta një orë, apo një orë e gjysmë, nuk e din saktë. Kanë përfundu darkën si dhe pagesën e ka bërë vëllai i tij M.i

dhe kanë filluar të dalim nga Restoranti. I pari ka dal M. nga Restoranti, pas tij ka dal nusja e tij, M. ka qenë me dy fëmijet para, nusja e tij ka qenë me vajzën e tij pas tij, pastaj ka qenë dëmtuari A. me të fejuarën dhe me të ndjerin F.. Ka hec me të fejuarën dhe me vëllain tani të ndjerë F.. Para se me dal nga Restoranti, është banjo në anën e djathtë dhe i dëmtuari A.ka, hy me i pastru duart, në ato momente ka ndi do zhurma, “o vrani , o vrani”, ka dal nga banjo dhe nga Restoranti, kur ka dal nga restorani i ka pa tre persona, kanë qenë duke sjell me mjete të forta, si lopatë, zinxhirë, shkop dhe gjëra tjera vëllezërve të tij M. dhe F.. I dëmtuari A.H., ka shku direkt tek vëllezërit e tij për me i largu sulmuesit, në ato momente e ka kap njërin nga sulmuesit dhe në atë çast, e ka ndi vëllain e tij M., “o më kapi plumbi”. Si dhe në atë moment e ka ndi një zë tjetër, “o vraje edhe këto , o vraje edhe këto”. Po ashtu ka dëgjuar një zë “ o lësho , o lësho ta vraj edhe këto” nga personat që ishin aty duke i sulmuar, pastaj ky person ka gjuajtur në drejtim të dëmtuarit A.ku plumbi i ka shkuar afër fytyrës, njeri nga sulmuesit ka pas armë. I dëmtuari A. po ashtu ka deklaruar se në ato momente nuk i kujtohet ku ishte M., dhe i ndjeri F., nuk ka pa, pasi qe nuk ka pas mundësi me i pa se non stop e kanë goditur, kanë qenë përmbi tre vet që e kanë godit, me lopatë me zingjir, e kanë godit në kokë dhe gjithë trupin. Pastaj pas gjithë këtyre goditjeve, i ka ndi një apo dy të shtëna me armë, si dhe ka dëgjuar kur dikush ka thënë “o ikni se na u blloku alltija”, por prapë nuk janë ndalur duke i sjellë te dëmtuarit A.në atë moment është ofruar kamerieri, vëllai i pronarit dhe ka tentu të ndajë sulmin, ndërsa axha i vëllezërve Gashi, këtu i pandehuri B.G. i ka thënë “ec prej këtuhit nuk ki nevojë me ndal sulmin”

Gjykata gjeti se të gjitha këto momente te cekura si më lartë, nga të dëmtuarit M.dhe A.H., vërehen edhe në video -incizimet e mara nga kamerat e Restoranti “.....”, po ashtu Gjykata ju fali besimin deklaratave të dëmtuarve kur te njëjtit deklaronin se para se me përfundonte përleshja kanë dëgjuar fjalët se “na u koçit arma dhe hajde ikum” “o ikni se na u blloku alltija”, Faktin se pistoleta është, koqitur- bllokur, natën kritike ka mbështetje edhe në provat materiale si një fishek i gjetur i pa shkrepur natën kritike në vendin e ngjarjes, pastaj edhe një fishek tjetri i po të njëjës armë është gjeture në veturën Pik-up, me të cilën veture, të pandehurit janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe e kanë dërguar pistoletën deri në vendin ku është gjetur pastaj, e që Gjykata vlerëson se fishekët, kanë rën kur i pandehuri, N.G., ka repetitë armën duke u munduar ta zhbllokoj. Gjykata ju fali besimin deklaratave të dëmtuarve kur të njëjtit deklaroni se kanë dëgjuar edhe fjalët “o vraj-o vraj”, mirëpo Gjykata nuk kishte prova të mjaftueshme për të vërtetuar faktin se, cili nga të pandehurit i ka thënë këto fjalë “o vraj o vraj”

Nga dëshmia e dëshmitarit, E.B., i cili natën kritike ka punuar si kamerier në Restorantin “.....”, po ashtu vërtetohet fakti natën kritike M. me familjen e vet ka pasë, rezervim për iftar, dhe dëshmitari ka shërbyer si kamarier. Pasi qe familja H. e kanë përfundu iftarin, pagesën e ka bërë M.. Po ashtu u vërtetua fakti se pasi qe M. me familje kanë dalë nga Restoranti, dëshmitari nuk ka dëgjuar asgjë sepse e ka pas sallën plot musafirë, mirëpo pas pak, një fëmijë ka hy duke bërtit, e që në këtë raste ishte fëmija i te dëmtuarit M.. Kur dëshmitari E.2ka dal jashtë derës së Restorantit i ka parë duke u rreh, përkatësish e ka pa M. aty, ku njëri i pandehur G. ishte duke e rrah me lopatë M. në kokë. Dëshmitari pasi i shikon të pandehurit në sallën e gjykimit, tregon se personi që ka pas të veshur tesha të baustellës me lopatë në dorë, thotë se është A.G., dëshmitari ka hyrë në mes për ti ndarë, mirëpo nuk i kujtohet nëse dikush e ka

penguar, për të mos ndërhyrë për me i nda ndoshta ka pas mundësi me i pengu, mirëpo nuk i kujtohet ka mundësi që e ka shtyrë familja G. mirëpo nuk e dinë saktë sepse ka qenë i stresum. Pastaj e ka parë një të vramë në anën tjetër, ndërsa M. ka qenë i plagosur në këmbë. Ka dëgjuar të shtëna, mirëpo nuk është i sigurte sa të shtëna kanë qenë. Dëshmitari pasi që i shikon foton me nr. 68,69, deklaroi se, po ai është ne foto mirëpo nuk e din arsyen pse është ulur ka mundësi ndoshta është rrëzuar. Dëshmitari E.B. po ashtu deklaroi se vëllezërit H.nuk ju kan pa asgjë në dorë, vetëm M.e ka pas një çantë të krahut.

Gjykata vlerësoi edhe deklaratën e dëshmitarit, I.B., pronar i Restorantit “.....” të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, ku nga kjo dëshmi Gjykata po ashtu, vërtetoi fakti se i dëmtuari M., ka bërë rezervim ditën kritike për të shkuar së bashku me familje për darkë-iftar, në këtë Restorant, pastaj I.B. e ka njoftuar, A.T.n dhe ai e ka shënu në fletore të rezervimit. Ndërsa përtej këtij fakti nga dëshmia e dëshmitari I., Gjykata nuk vërtetoi ndonjë fakt tjetër rreth veprave penale pasi që dëshmitari, Ismet gjatë ditës kishte dal nga Restoranti dhe kishte shkuar në Prishtinë për arsye familjare, ndërsa në kohën kur ka ndodhur rasti, nuk ka qenë prezent në Restorantit e tij “.....”.

Dëshmitari, L. B., gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se, në kohën kur ka ndodhur vepra, ka qenë i punësuar në “.....”, si pjatlarës. Ditën kritike ka qenë në kuzhinë duke larë pjata, dhe i ka marr disa pjata të pastruara për ti dërguar në kuzhinë poshtë, dhe sa e ka qel derën e kuzhinës për me i qu pjatat poshtë, ka has me një veturë Pik-up, ngjyrë kaltër, i cili ka qenë drejtë më derë të kuzhinës i parkuar rikferc për me hec fill, ne pik-up kanë qenë një pasagjer dhe shoferi. Dera e kuzhinës është në dalje në parking të Restorantit. Dëshmitari i ka qu pjatat në kuzhinë dhe të dera e kuzhinës është takuar me një person të panjohshëm i cili e ka pyet, a bon me hy në sallë brenda, pasi dëshmitari i ka thënë jo sepse është e rezervuar vetëm për persona që agjërojnë iftar, ky person i ka thënë a bon jashtë, ndërsa dëshmitari L. i ka thënë po. Po ashtu dëshmitari deklaroi se ka qenë ne kuzhinë kur i ka ndi krismat e alltisë, dy apo tri krisma, pastaj ka dal jashtë, dhe ka parë një person duke gjuajtur përpjetë me allti dhe sa i kujtohet ka parë vetëm një të shtënë, tjetri person ka qenë duke sillë me kaci në një person të shtrirë, që ishte i ndjeri F. e të cilin e ka njoftë, pasi që e ka parë ne rrjetet sociale pas rastit. Gjykata nga video inqizimet e mara nga Restoranti “.....” vërtetohet fakti se personi që e ka pyetur dëshmitarin L.B.se a bon me hy në sallë është i pandehuri B.G..

Dëshmitari A.T., gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se, ditën kritike ka qenë në punë në Restorant “.....”, familja H., ka rezervuar një tavolinë për iftarë, rezervimi është bërë tek pronari I.B. në telefon, pastaj Ismeti e ka thirr në telefon dëshmitarin A.2 dhe i ka tregu për rezervimin. Për iftare nga familja H. ne Restorant kanë shkuar, tre vëllezërit H., dy fëmijë dhe dy gra, përgjegjes me ju sherby familjes H. ka qenë E.2. M.i me familje ne Restorant ka qëndruar përafërsish një orë. Dëshmitari ka shtuar se nuk ka dëgjuar asgjë, deri ne momentin kur ka ardhë një fëmijë i vogël i familjes H. i cili ishte duke qajhtë dhe ka kërkuar ndihmë ka thënë se “janë duke ja rrahur babën”. Pastaj dëshmitari ka tentu me dal jashtë me i ndihmua dhe në momentin që është afruar afër derës, ka pas të shtëna me armë dhe është kthyer mbrapa, ka shku deri tek pjesa ku i lajnë pjatat brenda, ka tentuar përsëri me dal jashtë pas disa sekondave, dhe ka dëgjuar përsëri të shtëna me armë dhe përsëri është kthyer pas. Herën e parë kur ka tentu me dal e ka

dëgju një të shtënë, ndërsa herën e dytë kur ka tentu me dal i ka dëgjuar dy të shtëna një pas një. Në momentin kur ka dal jashtë e ka pa të ndjerin F., ka qenë i shtrirë, ka qenë i mbuluar me gjak, ndërsa A. , ka qenë afër tij duke e mbajtur disi si në prehër, e ka kap kokën e të ndjerit si në prehër. M.i ka qenë në këmbë duke fol me telefon duke tentuar me e thirr dikënd. Pas rastit dëshmitari ka dëgjuar se L.B., ka thënë se njëri prej të pandehurve ka tentuar apo ka hyrë gabimisht në pjesën ku lahen pjatat. Po ashtu dëshmitari ka thënë se është e saktë ajo që ka deklaruar në Prokurori se “kur jam fsheh më pas jam ngrit, kam kaluar në pjesën e sallës, ku në ato momente është futur brenda M. i gjakosur në këmbë, duke kërkuar ndihmë, e që saktë nuk më kujtohet se çka ka thënë, por e di se ka thënë o hajde ndihmona, dhe nëse nuk gaboje tani ka dal M.i jashtë, por edhe E.2 e aty janë dëgjuar edhe dy të shtëna njëpasnjëshme”, M.nuk ka pas asgjë në duar por ka qenë i gjakosur në këmbë. Edhe dëshmia e këtij dëshmitari ka përputhje me video-incizimet e marra nga vendi i ngjarjes e ku vërehet se M.i hynë në Restorant, për të kërkuar ndihmë pasi që e kishin plagosur me parë, po ashtu përputhet edhe me dëshmitë e dëshmitarëve tjerë që përshkruajnë se një fëmijë ka hyrë për të kërkuar ndihmë duke thënë se “janë duke ja rrahur babain”

Konform nenit 335 par.1, nënpar. 1.1 të KPP-së, në seancën e shqyrtimit gjyqësor të dt.02.04.2024, janë lexuar deklaratat e dëshmitarëve R. dhe B. B., për arsye se, nga raporti policor me nr. ref 05/3-03K-SO-146/2024, të dt. 05.03.2024, rrjedh se sipas informatave të siguruar dëshmitarët në fjalë gjenden jashtë shtetit dhe gjenden në Itali. Palët janë pajtuar që të lexohen deklaratat e dëshmitarëve R. B. dhe B.B., të dhëna në procedurën paraprake.

Dëshmitari, R. B., në deklaratën e dhënë në Polici me dt. 12.05.2022 dhe në Prokurori me dt. 23.09.2022, ndër të tjera ka deklaruar: se nuk e njeh familjen H., nga fsh. Golubovc, K. Malishevë, nuk e njeh as të dëmtuarin M.H., poashtu nuk e njeh, as familjen Gashi nga fsh. Sverk, ka shtuar se natën kritike nuk e din se ku ka qenë ulur i dëmtuari M.H., pasi që me ta është marr E.2. Kur ka ndodhur rasti ka qenë në terasë të kuzhina, kur ka dëgjuar krismën, nuk ka dëgjuar më shumë se një krismë. Vendi i ngjarjes është diku 5 apo 6 metra larg dhe nuk mund të shihet nga aty, dhe me të dëgjuar krismën ka shkuar brenda. Pasi që ka shkuar brenda, të gjithë klientët kanë qenë në këmbë. Poashtu i ka pa në këmbë kamarierët A.T., B.B., V. B. dhe E.B., E.2 ka dal jashtë, ndërsa dëshmitari vet ka dal jashtë pasi që janë larguar të pandehurit nga aty dhe kur ka dal e ka pa një person të shtrirë në tokë dhe dëshmitari nuk ka marr ndonjë veprim.

Dëshmitari B. B., në deklaratën e dhënë në Polici me dt. 13.05.2022 dhe në Prokurori me dt. 26.09.2022, ndër të tjera ka deklaruar, se punon si kamarier në Restorantin “.....”. Të pandehurit nuk i njeh, ndërsa të dëmtuarin M.H. e njeh, sepse ka ardhur edhe më parë në Restorant, mirëpo natën kritike dëshmitari nuk i ka shërbyer tavolinës ku ishte i ulur M. me familje dhe nuk e din se kush e ka shërbyer tavolinën ku ishte ulur M.. Sa i përket rastit ka deklaruar se ka qenë brenda në Restorant, duke shpërndarë supë, ka hy një djalë i vogël dhe ju ka drejtuar me fjalë Atdhes, “hajde se jon ka ma rrahin babën”. Dëshmitari B. është nisur së bashku me A.2 për me dal, por në atë moment ka dëgjuar krismën e armës, njëherë një krismë, pas një kohe të shkurtër edhe një krismë tjetër, e pas pak edhe dy krisma tjera. Pas këtyre krismave dëshmitari, B.me A.2, nuk janë dal fare jashtë, ndërsa jashtë kanë dalur pas, diku 10 minutave, pas kohës kur kanë dëgjuar krismat, përkatësisht rreth kohës kur kanë ardh Policia.

Kur ka dal jashtë e ka pa një person të shtrirë dhe një person ka qenë afër tij dhe me siguri ka qenë familjari i tij.

Gjykata pas vlerësimit të deklaratave të dëshmitarëve, R. B. dhe B. B., gjeti se të njëjtit në kohën kur ka ndodh rasti, nuk kanë dal në oborrin e Restorantit dhe nuk kanë parë veprimet e ndonjërit nga të pandehurit përveç faktit se dëshmitari B., ka deklaruar në Polici se ka dëgjuar, një herë një krismë, pastaj edhe një krismë, e pastaj edhe dy krisma tjera, që janë gjithsejtë 4 krisma, e që përputhet me numrin e gëzhzohave të gjetura në vendin e ngjarjes, poashtu dëshmitari, B. ka deklaruar se, një fëmijë i vogël, i moshës 8 apo 10 vjeçare, ka hyrë në Restorant duke qarë dhe ka kërkuar ndihmë duke thënë “se jon tu ma rreh babin”.

Nga shikimi i video- incizimeve të marra nga Restoranti, i cili gjendet në fsh. Volljakë, me dt. 28.04.2022, rreth kohës së incidentit, Gjykata vërtetoi se: sipas raportit të Policisë, me nr. të rastit 2022-DE-203, ref.nr.2022-HRP-57, i dt. 06.05.2022, koha dhe data me kamerat nuk ishte në përputhje me kohën dhe datën reale. Data dhe koha në kamera ishin, 16.03.2005, ora 07:30, derisa koha dhe data reale e incidentit është 28.04.2022, rreth orës 20:40.

Nga shikimi i këtyre CD-incizimeve, Gjykata vërtetoi se, sipas kohës së kamerave, të dëmtuarit vëllezërit H., arrijnë në parkingun e Restorantit, “.....”, me dy veturangjyrë e kuqe dhe, ngjyrë e zezë, (me dt. 16.03.2005, në orën 06:07:32 sec sipas kohës se regjistruar ne kamera), të njëjtit pas 2 minutave, kanë hyrë në Restorantin “.....”, tre vëllezërit H. së bashku me dy gra dhe tre fëmijë.

Pas, 1(një) ore e 5(pesë) minuta, përkatësisht sipas kohës së kamerave, 07:14 min, vërehet momenti kur të pandehurit arrijnë ne parkingun e Restorantit “.....” me veturen Pik-up, ngjyrë të kaltër (në Pik-up, ishin N.i, A.li dhe B.), dhe parkohen në fund të parkingut të Restorantit. Po ashtu vetëm pas 7 minutave, vërehen dy të pandehurit tjerë që hyjnë në këmbë, në parkingun e Restorantit, kalojnë pranë veturës Porsche, e shikojnë dhe vazhdojnë në drejtim të Pik-upit, ku ishin edhe të pandehurit tjerë. Këta dy persona që kanë ardhur në këmbë deri në parkingun e Restorantit “.....”, janë të pandehurit B.G. dhe A.G., pasi qe të njëjtit e kishin len veturën ne parkingun afër Restoranti “.....” Në orën 07:22 min, vërehet i pandehuri B.1, duke u afruar te dera e Restorantit “.....”, hyn brenda në Restorant, shikon në të djathtë ku ishin ulur të dëmtuarit dhe menjëherë del nga Restoranti dhe shkon e bisedon me të pandehurit që ishin duke pritur në Pik-up. Gjykata vlerësoi se në këto momente i pandehuri B.G., i informon të pandehurit tjerë që ishin në veturën Pik-up, se ku dhe me kënd janë ulur te dëmtuarit.

Nga momenti kur të pandehurit kanë arritur në parkingun e Restorantit, “.....” orën 07:14, e deri tek momenti kur i dëmtuari M. H. del nga Restoranti, kalojnë rreth 15 minuta. Në orën 07:29, sipas orës së kamerave, vërehet i dëmtuari M.H. duke dal nga Restoranti “.....” se bashku me fëmijët e tij. Në orën 07:29:47 sec. vërehet tani i ndjeri F., duke dal nga Restoranti. Në orën 07:29:49 sec, vërehet i pandehuri i parë (A.li G.) me stupc në dorë, duke vrapuar ne drejtim te dëmtuarit M.H.. Në orën 07:29:52 sek. vërehet i pandehuri i dytë (N.i), i cili po ashtu, kishte mjet të fortë në dorë dhe shkon në drejtim të M., pastaj nga pas veturës Pik-up, dalin edhe

dy të pandehurit (A.i dhe B.) tjerë dhe shkojnë në drejtim të dëmtuarve. Në orën 07:29:57 sekonda, vërehet i dëmtuari A.H., duke dal nga Restoranti me vrap dhe shkon në drejtim ku ishin të pandehurit duke ja goditu vëllezërit e tij. Në orën 07:29:58 sekonda, vërehet fëmija i familjes H., duke vrapuar kah Restoranti, i cili hyn në Restorant e që sipas dëshmitarëve i njëjti ka kërkuar ndihmë, duke thënë se janë duke ia rrahur babën.

Në ora 19:30:10 sek, i dëmtuari M.plagoset në këmben e majtë nga gjuajtja me armë nga i pandehuri N., pas 10 sekondave, vërehet i dëmtuari M.H., duke ikur nga oborri i Restorantit dhe duke hyrë tek dera e Restorantit “.....”, në këto momente vërehen edhe të pandehurit A. dhe B. të përfshirë në përleshje. Në momenti kur i dëmtuari M.largohet ne drejtim te Restorantit, vërehen të pandehurit se tani sulmojnë të dëmtuarin A. dhe tani të ndjerin F.H.. I pandehuri N., vërehet se mban pistoletën në të dy duart, të drejtuar nga i dëmtuari A., ne orën 19:30:22 dhe 19:30:27, shtënë dy herë ne drejtim te dëmtuarit A..(momenti ku i dëmtuari A. deklaroi se plumbi i ka shkuar afër fytyrës). Ndërsa në orën, 19:30:30 sekonda, shtënë ne drejtim të tani te ndjerit F.H., vërehet e shtëna me armë zjarri, (vërehet flaka ne armë) nga e cila e shtënë mbetet i shtrirë tani i ndjeri F.H..

Gjykata gjeti se kur ka ndodhur e shtëna me pistoletë, si pasojë e të cilës ka mbetur i vdekur, i ndjeri F.H., i dëmtuari M.H., ishte tek hyrja e Restorantit dhe nuk ishte farë afër te dëmtuarve dhe të pandehurve tjerë qe ishin të përfshirë në përleshje, andaj nga ky fakt vërtetohet se nuk është i vërtetë pretendimi i të pandehurve se i ndjeri F.H. ka vdekur si pasojë e shtënies me armë të zjarrit nga ana e të dëmtuarit M., pasi që në momentin që është goditur tani i ndjeri F. me predhë, M.ka qenë në hyrje të Restorantit.

Në 19:30:36, vërehet goditja me mjete të forta dhe me lopatat përderisa viktimia ishte i shtrirë në tokë. Në atë kohë në përleshje janë të përfshirë të gjithë të pandehurit e të cilët ishin duke e goditu tani te ndjerin F. dhe të dëmtuarin A. në mënyra të ndryshe. Në orën 07:30:37 sekonda, vërehet i pandehuri B.G., duke dal nga Restoranti dhe duke shikuar të pandehurit derisa ishin duke e goditur me mjete të forta të dëmtuarin A.. Në orën, 07:30:52 sekonda, vërehet i pandehuri A.1, duke e goditur me kaci të dëmtuarin A.. Në orën 07:30:55 sekonda, vërehet i pandehuri A., kur merr kacinë nga A.1i dhe e godet në kokë të dëmtuarin A.t. Në 07:30:51, sekonda i pandehuri .1 vërehet duke e penguar dëshmitarin E.B., pasi që dëshmitari kishte ndërhyrë për ti ndal të pandehurit që mos e godisnin të dëmtuarin A.. Në orën 07:30:59 sekonda, vërehet se sulmi ndaj të dëmtuarve ka përfunduar, pastaj vërehen të pandehurit duke shkuar në drejtim të veturës së tyre Pik-up, ndërsa i dëmtuari M., vërehet tek dera e Restorantit në orën 07:31:31 sekonda, vërehet i dëmtuari A., që ishte afër tani të ndjerit F.H., në orën 07:31:39 sekonda, të pandehurit largohen me veturën e tyre Pik-up.

Nga shikimi dhe vlerësimi i këtyre, video-incizimeve, Gjykata përveç që vërtetoi të gjitha veprimet e ndërmarra, nga secili i pandehur natën kritike, po ashtu vërtetoi faktin se shkuarja në vend të ngjarjes nga ana e të pandehurve ka qenë e planifikuar dhe e koordinuar mirë në mënyre që të gjithë të shkojnë se bashku.

Gjykata, vlerësoi edhe CD-incizimet të marra nga kamerat e Restorantit, “.....” për ditën kritike dhe atë nga ora 17:20-22:00.

Nga këto video- incizime vërehet se, me dt. 28.04.2022, në orën 19:31:44 sekonda, vërehen dy veturat e familjes H., duke lëvizur nga rruga kryesore, në drejtim të Restorantit “.....”. Në orën 19:58:16 sekonda, vërehet vetura Pik-up, ngjyrë e kaltër, duke shkuar në drejtim të Restorantit “.....”. Vetëm pas disa sekondave, vetura Pik-up, ngjyrë e kaltër, kthehet rikverc dhe parkohet buzë rrugës, tek Restoranti “.....”. Në orën 19:58:50 sekonda, afër Pik-up, afrohen dy persona tek vozitësi, pas një bisede, këta dy persona në këmbë largohen nga aty, në drejtim të Restorantit “.....”, Gjykata gjeti se këta dy persona janë të pandehurit A. dhe B.G., pasi që të njëjtit vërehen edhe nga kamerat e Restorantit “.....” kur arrijnë në këmbë në parkingun e Restorantit “.....”. Në orën 20:00:43 vërehen kur njeri nga të pandehurit vjen me veturën “Reno Clio” dhe parkon afër veturës Pick-up, që ishte i parkuar, afër parkingut të Restorantit “.....”, nga vetura “Reno Clio” del njëri nga të pandehurit, hap derën pasagjerit, me pas hap bagazhin e Pick-up, merë diçka nga vetura “Reno Clio” dhe e vendos në pik-up, menjëherë pas këtij veprimi hyn në veturën “Reno Clio” dhe parkon tek parkingu, pastaj menjëherë kthehet prapë tek vetura pick-up, bëhet bashkë me të pandehurit tjerë dhe nisen me Pik-up, në drejtim të Restorantit “.....”.

Sipas, video- incizimeve, të marra nga Restoranti “.....” vërtetohet fakti se të gjithë të pandehurit, N., B., A., B. dhe A.G.1, janë takuar se bashku afër Restorantit “.....” kanë biseduar për një moment në mes tyre dhe nga aty kanë shkuar në drejtim të Restorantit “.....”, i pandehuri A. dhe B.1 në këmbë, ndërsa të pandehurit N., A.1 dhe B.G.1 me veturën pik-up ngjyrë e kaltër. Pra kjo vërteton faktin se të gjithë të pandehurit në vend ngjarje kanë shkuar me paramendim dhe duke e ditur se aty është i dëmtuari M.H. me familjen e tij.

Pas rastit natën kritike në orën 21:21:27 sekonda, vërehet i pandehuri B.G., duke hyrë në Restorantit “.....”, ulet në Restorantin “.....”, shikon telefonin kohë pas kohë, ngritët nga karrika duke biseduar me telefon, kthehet përsëri tek tavolina ku ishte ulur më parë, kohë pas kohe e merr telefonin në dorë dhe qëndron ulur deri në orën 21:28:13 sekonda. Ndërsa në orën 21:28:55 sekonda, shihet se është duke dal nga Restoranti “.....”. Kjo për gjykatën vërteton faktin se i pandehuri B.G. edhe pas ngjarjes ka qenë aktiv, duke u munduar ti informoj të pandehurit tjerë rreth rastit dhe veprimeve që zhvilloheshin afër vendngjarjes, pastaj i pandehuri B.1 merrë veturën e tij dhe largohet nga aty.

Raporti i autopsisë me numër MA 22-128, te dt. 29.04.2022 i përpiluar nga Eksperti mjeko ligjor, Dr. N. U., vërteton, shkakun e vdekjes së të ndjerit, F.H., në cilin raport si përfundim është konstatuar; Bazuar në gjetjen mjeko ligjore gjatë ekzaminimit të jashtëm trupor – makroskopikisht gjatë ekzaminimit të jashtëm trupor është konstatuar një plagë tejshkuese me vrimën hyrëse në regjionin e zgavrës së syrit të majtë, trajektore që ka drejtimin majtas-djathtas, duke përshkruar edhe pjesën ballore të hemisferës trurore dhe duke përfunduar në regjionin e djathtë tamblorë të kokës, pas veshit të djathtë; Si dhe gjendja mjekoligjore gjatë ekzaminimit të brendshëm mjeko ligjorë ku janë konstatuar makroskopikisht procedurat traumatike me thyerje kockore të kafkës dhe gjakderdhje trurore. Shkaku i vdekjes së të ndjerit F.H., ka ardhë

si rezultat i gjakderdhjes së brendshme trurore dhe thyerjes kockore si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hedhur nga armë e zjarrit. Dr . N. U., gjatë seancës së shqyrtimit gjyqësor deklaroi se distanca e qitjes nuk ka qenë më e madhe se 1 metër nga tani më i ndjeri. Faktorët plotësues të qitjes gjatë hedhjes së predhës nga arma e zjarrit, të konstatuar në trupin e të dëmtuarit, janë prova kryesore mjeko ligjore që dëshmojnë për distancën maksimale të qitjes prej 1 metër. Po ashtu është konstatuar vrima hyrëse nga predha e hedhur nga arma e zjarrit, e cila ka drejtim nga majtas djathtas dhe pjerrtas, nga lartë poshtë, në drejtimin e pjesës së pasme të veshit të djathtë. E që i bie se arma me të cilën është shtënë ka qenë pak më lartë se vrima hyrëse dhe dalëse.

Plotësimi i raportit të autopsisë me nr.MA22-128 i dt. 14.02.2024, dhe deklarimi i ekspertit në seancë gjyqësore, Gjykata vërtetoi faktin se i ndjeri F.H., ka pësuar edhe lëndime, si ne vijim; në regjionin e majtë dhe të sipërm ballor të kokës, rreth 3,5 cm mbi vetullën e majtë, plagën gervishese, e shoqëruar me gjakderdhje nenlëkurore më përmasa rreth 1,1x30cm në formë të çrregullte dhe përgjyrim kafe. Eksperti për këto lëndime gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se plagët që janë të dukshme në fotografitë e raportit të autopsisë, me nr. 11 dhe 12, e cila gjendet në regjion e sipërm të majtë ballor, ka formë të një vije lineare me përngjyrim të kuqërremtë, dhe me besueshmëri deklaroi se është shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit mbrehtës(jo i mbrehtë).

Lëndimet në regjionin e djathtë ballorë të kokës rreth 0,4 cm, mbi vetullën e djathtë, është konstatuar gërvishje me përmasa rreth 1,6x0,3 cm, me formë lineare, horizontalisht dhe paralel me vetullën e djathtë dhe me ngjyrim kaf. Eksperti gjatë shqyrtimit gjyqësor, deklaroi se plaga e cila është evidentuar në fotografinë me nr.10, e cila duket në formë të vijës lineare në raport me vetullën e syrit të djathtë, është shkaktuar si rezultat i veprimit mekanik të mjetit mbrehtës (jo i mbrehtë).

Lëndimet, që vërehen në regjionin e jashtëm të shpinës së këmbës së djathtë ku është konstatuar ndrydhje dhe gjakderdhje nen lëkurore me përmasa rreth 5x3 cm, në formë të çrregullt dhe përngjyrim të kuqe, lëndime që vërehen në foton nr. 23 nga raporti i autopsisë, mbi shputën e këmbës së djathtë, eksperti gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se është gjak mbledhje nën lëkurore në formë ovale të çrregullt e shkaktuar nga veprimi mekanik i ndonjë mjeti të fortë, pa maje, pa teh, (topitës jo i mbrehtë), e që përjashtohet mundësia e shkaktimit të kësaj plage si rezultat i veprimit dinamik të predhës së hedhur nga arma e zjarrit.

Lëndimet trupore të evidentuara tek i ndjeri F.H. siç janë konstatuar edhe në plotësimin e raportit të autopsisë, e të deklaruara edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor nga eksperti; në regjionin e majtë dhe të sipërm ballor të kokës, rreth 3,5 cm mbi vetullën e majtë, plagën gervishese, e shoqëruar me gjakderdhje nenlëkurore më përmasa rreth 1,1x30cm në formë të çrregullte dhe përgjyrim kafe”. Lëndime që vërehen edhe në fotot e raportit të autopsisë, me nr. 11 dhe 12. Lëndimet në regjionin e djathtë ballorë të kokës rreth 0,4 cm, mbi vetullën e djathtë, është konstatuar gërvishje me përmasa rreth 1,6x0,3 cm, me formë lineare, horizontalisht dhe paralel me vetullën e djathtë dhe me ngjyrim kaf, lëndime që vërehen në foton nr. 10 nga raporti i autopsisë, dhe Lëndimet që vërehen në regjionin e jashtëm të shpinës së këmbës së djathtë ku

është konstatuar ndrydhje dhe gjakderdhje nen lëkurore me përmasa rreth 5x3 cm, në formë të çrregullt dhe përngjyrim të kuqe, mbi shputën e këmbës së djathtë, lëndime që vërehen në foton nr. 23 nga raporti i autopsisë. Ndërsa në fotoalbumi e autopsisë i dt.29.04.2022, i cili përmban 58 fotografi, shihet gjendja e trupit të te ndjerit F. me lëndimet e shkaktuara.

Nga raporti, plotësim raporti i autopsisë dhe deklarimi i Eksperti Dr . N. U., në seancën gjyqësore, Gjykata vërtetoi faktin se i ndjeri, F.H., natën kritike përveç së është goditur me predhe të hedhur nga armë e zjarrit, e cila ka qenë edhe shkaktar i vdekjes, i ndjeri F.H. është goditur edhe me mjete të forta, pa maje, pa teh, (topitës jo i mbrehtë). Gjykata gjeti se i ndjeri F., është goditur nga të pandehurit me mjete të forta të cilat i kanë përdorur natën kritike, e që vërehet edhe në videoe-inqizimet e mara nga vendi i ngjarjes.

Ndërsa në raportin mjekësor me nr. 8237, të dt. 28.04.2022, i lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë - Emergjenca, në emër të F.H., është konstatuar se, pacienti sillet në QE pa shenja jete, ka një plagë me armë zjarri në pjesën e pasme të kokës.

Lëndimet trupore të pësuar nga të dëmtuarit A. dhe M.H., ditën kritike vërtetohen nga, Akt ekspertimi Mjeko Ligjor, i përpiluar nga Ekspertit Mjeko Ligjor, Dr. N. U., me Nr..I Ref:PE-34 te dt.29.05.2022, të përpiluar ne bazë të dokumentacionit të çështje në emër të dëmtuarve M.H. dhe A.H., dhe Akt ekspertimi Mjeko Ligjor i përpiluar në bazë të, ekzaminimeve të drejtpërdrejtë fizik dhe klinik mjekoligjor dhe dokumentacionit plotësues të çështje, nr.Ref.PE.nr.34B i dt.15.02.2024, ne emër të dëmtuarit A.H., Gjykata vërtetoi faktin se i dëmtuari A.H., ditën kritike pa pësuar lëndimet e konstatuara si ne akt ekspertizë dhe atë. Cikatrikse (vrraja), në regjionin e sipërm të vetullës së djathtë, me gjatësi 0,6 cm, në formë ovale dhe përngjyrim lëkuror. Të shkaktuar nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dhe të mbrehtë (kacia). Në regjionin e sipërm te gishtit t III-të të dorës së djathtë është konstatuar, Cikatriks (vrrajë), me gjatësi 2 cm, në shtrirje pjerrtas, formë lineare dhe përngjyrim të bardhë lëkuror. Të shkaktuar nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dh të mbrehtë (kacia). Eksperti ka sqaruar se, gjatë ekzaminimit të regjionit të kokës, ku është konstatuar plaga shqyese ndrydhëse në raportin mjekësor, të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Pejë –Emergjenca; nr.8238 dt.28.04.2022, për shkak të dendësisë se flokëve nuk ka mundur të ekzaminohet cikatriksi (palgen-t) në këtë regjion, mirëpo edhe me interpretimin e kësaj plage është marrë parasysht videoinqizimi i bashkangjitur në shkresat e lëndës, ku shihet disa herë ne formë të përsëritur veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dhe të mbrehtë në regjionin e pasëm të kokës (kacisë).Të gjitha dëmtimet e përshkruara, ne mungesë të thyerjeve kockore dhe dëmtimit të organeve vitale jetësore kualifikohen në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme ne shëndet.

Për te dëmtuarin M.H., Akt ekspertimi Mjeko Ligjor, në bazë të ekzaminimeve të drejtpërdrejtë fizik dhe klinik mjekoligjor dhe dokumentacionit plotësues të çështje, nr.Ref.PE.nr.34A i dt.15.02.2024, ne emër të dëmtuarit M.H., Gjykata vërtetoi se tek i dëmtuari M.H., janë konstatuar lëndimet si, Plaga tejshkuese e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit në regjionin e pasëm dhe të sipërm te kuadratit të jashtëm të kërcit të këmbës se majtë, bazuar ne cikatriksin e plagës se ekzaminuar prezantohet në formë ovale dhe përngjyrim të bardhë, me përmasa rreth 1x1 cm, është cikatriksi (vrraja) i plagës hyrëse. 2.

Cikatriksi (vrraja) tjetër e ekzaminuar ne regjionin e perparëm dhe të sipërm të kërcit të këmbës së majtë, rreth 1cm nën cikatriksin e plagës hyrës, me formë ovale, me përngjyrim të bardhe lëkurorë , me përmasa rreth 1x1cm, është cikatriksi (vrraja) dalëse. 3.Ka rezultuar se veprimi dinamik i predhës se hedhur ka pas drejtim të trajektores nga pas-pjerrtas, poshtë dhe para. Eksperti ka cekur se, pasi qe plaga tejshkuese nga veprimi dinamik i predhës se hedhur nga arma e zjarrit ne regjionin e sipërm të kërcit të këmbës së majtë është tajtuar në spitalin e Pejës dhe në raportin e lëshuar nuk janë evidentuar ndonjë nga faktorët plotësues të qitjes dhe marr parasysh se gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë fizik të plagës, tani janë prezent vetëm cikatrikeset (vrraja) e plagës është e pamundur të përcaktohet largësia e qitjes. Gjatë ekzaminimit ne regjionin e kokës është konstatuar, cikatriksi (Vrrajën) e plagës shqyese ndrydhëse, e cila prezantohet ne regjionin pasëm dhe të djathtë të kokës me vijë të pjerrtë lineare nga sipër, brenda dhe poshtë me gjatësi rreth 5cm, nga e cila, në 1cm e fundit ndahet vija tjetër e cikatriksit (vrrajes) me gjatësi rreth 1cm, në formë të vijës lineare me drejtim nga djathtas dhe jashtë. Kjo plage është shkaktuar nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dhe të mbrehtë, e që eksperti ka sqaruar se bazuar edhe në pamjet e videove të bashkangjitura ne shkresat e lëndës, ka mundur të shkaktohet nga veprimi i peshës dhe tehut të mjetit të fortë (kacisë). Nga ekzaminimi i laprës së veshit të majtë (bazuar ne diagnozën mjekësore nga Emergjencia ne Spitalin e Pejës), gjatë ekzaminimit të drejtpërdrejtë fizik dhe klinik mjekoligjorë është konstatuar një cikatriks (vrrajë), minimale.Të gjitha dëmtimet e përshkruara ne mungesë të thyerjeve kockore dhe dëmtimit të organeve vitale jetësore kualifikohen ne dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Nga Akt Ekspertimet Mjeko Ligjor të përpiluara nga Dr. N. U., për të dëmtuarit M.dhe A.H., Gjykata vërtetoi lëndimet e pësuar nga të dëmtuarit natën kritike si rezultat i goditjeve me mjete të forta nga të pandehurit.

Në foto albumin i vendit të ngjarjes, që përmban 106, me nr. TKR22/27, me nr. të dosjes 2022-DE-203, me datë të fotografimit 28.04.2024 dhe 29.04.2022, janë të evidentuara fotot si në më poshtë: Në foton nr.1 deri nr.16, paraqiten pamjet e trupit të pajetë të tani të ndjerit F.H., në foton nr.17, deri nr.20, paraqiten pamjet e përgjithshme të vendit të ngjarjes, në foton nr. 27, deri nr. 55, paraqiten dëshmitë e evidentuara me numra, e të gjetura në vend të ngjarjes, në foton nr. 66, deri nr. 68, paraqitet pamja e veturës Renault, e evidentuar si dëshmia 16, në foton nr. 69, deri nr.73, paraqitet pamja e veturës Pik-up, e cila është përdorur natën kritike nga të pandehurit, në foton nr.74-78, paraqiten pamjet e veturës BMW, në të cilën Gjykata gjeti se është vetura e të pandehurit B., në foton nr.79-82, paraqiten pamjet e përgjithshme të vendit të ngjarjes të kontrolluar në kushtet e ditës, në foton nr. 83-85, paraqet pamjen e objektit “.....”, në foton nr. 86 dhe 87, paraqiten pamjet e hapësirës, prapa objektit ku është gjetur arma, në foton nr. 88-94, paraqitet pistoleta një karikator dhe dy fishekë, e cila është përdorur ditën kritike, Në foton nr. 95, 96, paraqitet pamja e depos së objektit “.....”. Në foton nr. 97-102, paraqiten pamjet e njollave të kuqe, të cilat më vonë sipas ekspertizës së ADN-së kanë rezultuar se janë të Y.G.t, në foton nr. 103, paraqet pamjet e brendshme të zyrës. Në foton 104-106, paraqiten pamjet e DVR në zyrën e punëtorisë “.....”.

Në skicën e vendit të ngjarjes të punëtorisë “.....” është skicuar vendi ku janë gjetur dëshmitë #22 dhe #23, si njolla të kuqe në brendi të objektit e emëruar si zyre po ashtu dëshmitë #20 dhe #21 në pjesën e objektit të emëruar si punëtori kurse dëshmia #19, pistoleta është evidentuar në afërsi të objektit të emëruar si punëtori, në pjesën anësore të objektit.

Skica e vendit të ngjarjes tek Restoranti “.....” është skicuar vendi i ngjarjes ku janë të evidentuara dëshmitë dhe vendi ku janë gjetur dëshmitë nga #1 deri në #15, ndërsa në tabelën e matjeve të vendit të ngjarjes, është përshkruar distanca e largësisë në mes të dëshmive nga pika referuese A dhe B.

Nga lista e dëshmive me nr. TKR-Pejë-22/27 e dt.04.05.2022, Gjykata veretoi se, në vendin e ngjarjes janë gjetur; katër gëzhoja me mbishkrim të stampuar 7.62mm TT PPU të evidentuara si dëshmitë, #1, #2,#3,#8, një fishek me mbishkrim të stampuar 7.62mm TT PPU e evidentuara si dëshmia #12; një mjet i fort druri me gjatësi rreth 0.80 m e evidentuar si #5; një thikë e zezë me mbishkrim BOSIDUN nr. 311 me gjatësi tehu rreth 7cm e evidentuar si #7; një kartelë me mbishkrim LOYALTY, 3x1 euro 1x0.5 euro e evidentuar si #4; një shkrepës me ngjyrë të gjelbër e evidentuar si #11; një telefon Iphone e evidentuar si #14, mostra të kuqe të marra nga pellgu të evidentuar #9 dhe #13.

Në punëtorinë “.....”, janë gjetur: Pistoleta me ngjyrë të zezë me mbishkrim të stampuar UCK me nr. serik 7588839 66 1962, bashkë me karikator dhe dy fishek e evidentuar si dëshmia, #19, Katër mostra me ngjyrë të kuqe të evidentuara #20, #21,#22, #23.

Në veturën, Renault me targa Pik-up, janë gjetur janë gjetur, një lopatë pune me bisht të drurit me njolla të kuqe dhe qime të zeza e evidentuar si #26, e gjetur në pjesën e pasme së bashku me mjete pune, një fishek me mbishkrim të stampuar 7.62mm TT PPU të evidentuara si dëshmia #25, e gjetur në dysheme në anën e pasagjerit, dhe një njollë me ngjyrë të kuqe e evidentuar si #27 në pjesën e brendshme të derës së shoferit e cila sipas ekspertizës ka rezultuar të jetë e të pandehurit N.G..

Nga raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1945 i datës 26.10.2022, në të cilin ekspertet kanë dhënë konstatimin dhe mendimin përfundimtar dhe atë :Nga dëshmia #9 tampon me njollë të kuqe është fituar një profil të ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-në se F.H.. Nga dëshmia #13 tampon me njollë të kuqe është fituar profil i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së se M.H.. Nga dëshmitë #20 tampon me njollë të kuqe, #21 tampon me njollë të kuqe, #22 tampon me njollë të kuqe, #23 tampon me njollë të kuqe, është fituar profil i ADN-së i njëjtë, i cili përputhet me profilin e ADN-së, të pandehurit Y.G.. Nga mostrat #26.A dhe 26.B (njollat e kuqe nga lopata) është fituar një profil i njëjtë i ADN-së, i cili përputhet me profilin e ADN-së, së A.H.. (për gjykatën kjo vërteton faktin se nga lopata e gjetur në veturën Pik-up, natën kritike është goditur i dëmtuari A.t). Nga dëshmia #27 tampon me njollë të kuqe, është fituar profil i cili përputhet me profilin e ADN-së, së të pandehurit N.G.. Nga dëshmia #1 (një gëzhojë e fishekut) e gjetur në vendngjarje është fituar një profili përzier i ADN-së nga së paku dy persona, dhe atë në këta dy persona Y.G., nuk mund të përjashtohet si kontribues i ADN-së në këtë përzierje. Nga dëshmia #25 (një fishek) është fituar një profil i pjesërishtëm i ADN-së,

ku përjashtohen si kontribuues, A.H., M.H., F.H., N.G., A.G.1, A.G., B.G.1, B.G., dhe Y.G.. Nga mostra #26C (tampon nga pjesa e sipërme e bishtit të lopatës) është fituar një profil profili përzier i ADN-së, ku përjashtohen si kontribuues A.H., M.H., F.H., N.G., A.G.1, A.G., B.G.1, B.G., dhe Y.G.. Nga dëshmia #7 (një thikë metalike me ngjyre të zezë) e gjetur në vendngjarje është fituar një profil i përzier dhe i pjesërishëm i ADN-së i përshtatshëm për krahasim. Në dëshmitë #2 (një gëzhgjë e fishekut) dhe #19 (një revole) nuk është fituar profil i ADN-së, për shkak të sasisë së pa mjaftuar të ADN-së dhe kualitetit të dobët të mostrës si dhe Nga dëshmia #3 (gëzhgoje fisheku), #5 (një shkop druri), #8 (një gëzhgjë fisheku) dhe #12 (një fishek) nuk është identifikuar ADN me origjinë njerëzore.

Nga raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1946 i datës 26.09.2022, në të cilin ekspertet kanë dhënë konstatimin dhe mendimin përfundimtar dhe atë: në sipërfaqe të dëshmimeve #1, #2,#3,#8,#12 #19,#25,#5, #7 dhe #26 nuk janë nxitur-zhvilluar asnjë gjurmë e vijave papilare;

Nga raporti i ekspertimit me numër AKF/2022-2020/2022-1947 i datës 14.12.2022, ekspertët balistik kanë dhënë konstatimin dhe mendimin përfundimtar se:Dëshmia e evidentuar #19 (armë zjarri) është pistoletë e prodhuesit “NORINCO TYPE 54”, kalibër 7.62x25 mm, me numër serik 7588839 dhe e njëjta ka qenë funksionale. Dëshmia nën pikën B në kuadër të dëshmisë #19, një karikator i zbrazur i dizajnuar për pistoletat e prodhuesit “tulla tokare”, model 33 i cili është funksional dhe me kapacitet prej 8 fishekëve, dhe dëshmia nën shenjën C të dëshmisë në fjalë, dy fishekë me kalibër 7.62 x 25. Dëshmitë e evidentuar me shifrat #19 dhe #25 janë dy fishekë të kalibrit 7.62 x 25 mm, ndërsa, Dëshmitë nën #1, #2, #3 dhe #8, janë 4 gëzhgoja pjesë të fishekëve të kalibrit 7.62 x 25 mm të cilat janë shkrepur prej pistoletës së dorëzuar për ekspertizë balistike me shifrën #19. Nga evidentimi i këtyre dëshmime vërtetohet së në vendin e ngjarjes janë gjetur katër gëzhgoja , #1, #2, #3 dhe #8, që vërteton faktin se me pistoletën e njëjtë në vend ngjarje është shkrepur 4 (katër) herë.

Në Raportin e ekspertimit mbi ekzaminimin e dëshmimeve nga AKF-ja me nr. AKF/2022-0244 i dt. 18.01.2023, ekspertet kanë konstatuar se në tubin e objekt ekspertimit nga dëshmitë #1 deri #12 nuk u evidentuan mikrogrimca unike me përmbajtje të tre elementeve kimik më përmbajtje nga kapsolla e armës së zjarrit. Mirëpo kanë sqaruar se, Mungesa e mbetjeve të grimcave më prejardhje nga kapsolla e armës në duar të një personi nuk e eliminon atë person nga mundësia e shkrepjes së një arme zjarri.

Në raportin e Ekspertimit me nr. AFK/2022-2020/2022-195 i dt. 26.10.2022, janë dëshmitë që ju është bërë analiza e ADN-së, si ne vijim, #1 Një gëzhgjë e fishekut, #2 Një gëzhgjë e fishekut, #3 Një gëzhgjë e fishekut, #5 Një shkop i drurit, #7 Një thikë metalike me ngjyrë të zezë, #8 Një gëzhgjë e fishekut, #9 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #12 Një fishekë, #13 Një tampon me ngjyrë të kuqe/kaftë, #19 Një revole, një karikator dhe dy fishek, #20 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #21 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #22 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #23 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #25 Një fishek, #26 Një lopatë me bisht të drurit , #27 Një tampon me njollë të kuqe/kaftë, #AH Mostër referente pështymë nga A.H.j, #MH Mostër referente pështymë nga M.H., #FH Mostër referente pështymë nga F.H.j, #NH Mostër referente pështymë nga N.G., #AG Mostër referente pështymë nga A.G.1, #GA Mostër referente pështymë nga A.G., #BG Mostër referente pështymë nga B.G.1, #GB Mostër referente pështymë nga B.G.,

#YG Mostër referente pështymë nga Y.G., nga këto dëshmi ka rrjedh konstatimi përfundimtar i ekspertimit si ne vijim: 1. Nga dëshmitë #AH,#MH,#FH,#NG, #AG, #GA,#BG,#GB, dhe #YG, janë nxjerrë profilet e ADN-së se A.H.j, M.H., F.H.j, N.G., A.G.1, B.G.1, B.G. dhe Y.G., 2. Nga dëshmia #9 është fituar një profil i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së se F.H.j, kështu që F.H.j nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këtë dëshmi. Gjasa e paraqitjes së këtij profili në populacion është 1 në 98.8 kuadriliard individ (1.0127 e -28), 3. Nga dëshmia #13, është fituar një profil i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së, së M.H., kështu që M.H. nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këtë dëshmi. Gjasa e paraqitjes së këtij profili në piopulacion është 1 ne 2.6 kuadrilion individ (3.7956e-24), 4. Nga dëshmitë #20, #21, #22 dhe #23, është fituar një profil i njëjtë i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së se Y.G., kështu që Y. nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këto dëshmi. Gjasa e paraqitjes së këtij profili në populacion është 1 në 141 triliard individ (7.0872e-23), 5. Nga mostrat #26.a dhe #26.b (njolla të kuqe nga lopata), është fituar një profil i njëjtë i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së se A.H., kështu që A.H.nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këto mostra. Gjasa e paraqitjes se këtij profili në populacion është 1 në 32.6 triliard individ (3.0588e-22), 6. Nga dëshmia #27, është fituar një profil i ADN-së i cili përputhet me profilin e ADN-së së N.G.t, kështu që N.G. nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këtë dëshmi. Gjasa e paraqitjes së këtij profili në populacion është 1 në 9.3 kuadrilion individ (1.0676e-24), 7. Nga dëshmia #1, është fituar një profil i përzier i ADN-së, nga se paku dy persona. Y.G. nuk mund të përjashtohet si kontribuues i ADN-së në këtë përzierje, 8. Nga dëshmia #25, është fituar një profil i pjesërishëm i ADN-së, A.H.j, M.H., F.H.j, N.G., A.G.1, B.G.1, B.G. dhe Y.G., përjashtohen si kontribuues te ADN-së në këtë dëshmi, 9. Nga dëshmia #26.c, (tampon nga pjesa e sipërme e bishtit të lopatës), është fituar një profil i pjesërishëm dhe i përzier i ADN-së. A.H.j, M.H., F.H.j, N.G., A.G.1, B.G.1, B.G. dhe Y.G., përjashtohen si kontribuues te ADN-së në këtë mostër, 10. Nga dëshmia #7, është fituar një profil i përzier dhe i pjesërishëm i ADN-së, i pa përshtatshëm për krahasim, 11. Nga dëshmitë #2 dhe #19, nuk është ftuar profil i ADN-së për shkak të sasisë së pa mjaftueshme të ADN-së dhe kualitetit të dobët të mostrës, 12. Në dëshmitë #3, #5, #8 dhe #12, nuk është identifikuar ADN, me origjinë njerëzore. Eksperti B. M., specialist i lartë i serologjisë dhe ADN pranë AKF, gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se metodat që janë përdorur në rastin në fjalë për analizën e ADN-së janë metodat e pranuar të cilat përdoren edhe në laboratorë të vendeve të ndryshme të botës. edhe për pajisjet vlen e njëjta përgjigje, do të thotë janë të pranuar dhe aplikohen apo përdoren nëpër laboratorë të ADN-së nëpër vende të ndryshme të botës. Nga dëshmia me nr. 26#Y.G, është nxjerr profili i ADN-së së personit Y.G., mostër ka qenë mostër referent pështymë nga Y.G.. Sipas kalkulimit statistikor ka dal që shpeshësia e tij në populacionin botëror është 1 në 141 triljard individ, që nënkupton se ky profil është përputh me profilin e ADN-së, së Y.G., dhe jo ndonjë person në botë mund ta ketë këtë profil të ADN-së. Na dëshmia #1, që është një gëzhgojë e fishekut, është fituar një profil i përzier i ADN-së, nga së paku dy persona dhe kur është bërë krahasimi me profilet e ADN-së së A.H.j, M.H., F.H.j, N.G., A.G.1, A.G., B.G.1, B.G.t dhe Y.G.t, atëherë të gjithë personat tjerë janë përjashtuar kurse kemi përputhje me profilin e ADN-së, së Y.G. në këtë përzierje. D.m.th. njëri nga personat në këtë përzierje ka dal të jetë Y.G., ndërsa personat tjerë që i ka përmend më parë janë përjashtuar. Në pikën 7, profil i pjesërishëm i ADN-së i fituar nga dëshmia #25, nuk përputhet me profilin e përzier të ADN-së të fituar nga dëshmia 1, do të thotë ky person i panjohur, profili i të cilit është fituar nga dëshmia #25, përjashtohet si kontribuues i

ADN-së në dëshminë 1. Kjo nënkupton se në dëshminë me nr. #1 dhe #25 , kemi të bëjmë edhe me dy profile e ADN-së, të dy personave të panjohur. Mostra e cila është marr nga dëshmia #19 ka dhënë një sasi shumë të vogël të ADN-së, dhe për këtë arsye ka qenë edhe kualiteti i dobët për të fituar ndonjë profil të përshtatshëm të ADN-së.

Nga përgjigja e autoriteteve Italiane e të përshkruar në raportin e i ILECU-të, të dt. 01.06.2022, është konstatuar se nga kontrollet e kryera në bazën e të dhënave kombetare italiane rezulton; Egzon Gashi 20.06.1990 është në posedim të leje qëndrimit ne Itali. Egzon Gashi me dt.19.01.2022, ka raportuar në Stazione Carabinieri Borgo San Giacomo (Brescia), se është rrahur nga A. H. i lindur me 14.07.1984, E.3 H. i lindur me dhe B. H. i lindur me, sepse nuk e ka kthyer një borxh prej 300 euro, të dhenë disa javë me parë. Qendra klinike në Breshia ka trajtuar për 10 ditë personin për shkak të lëndimeve trupore.

Përgjigja e autoriteteve Italiane të dhëne përmes ILECU-të, vërteton motivin e kryerjes së veprave penale nga të pandehurit, N.G., B.G., A.G.. A.G.1, dhe B.G.1, e që është hakmarrja për shkak se vëllezërit e të dëmtuarve M., A. dhe të ndjerit F. e kishin rrahur vellaun e të pandehurve, N.G., A.G.. A.G.1, dhe B.G.1, në Shtetin e Italisë, ne muajin Janar apo për afërsisht 3 muaj para ngjarjes.

Gjykata vlerësoi listingun te hyrje-daljeve, të thirrjeve të mesazheve dhe hartografin e numrave të siguruar nga “Vala” për numrat, në shfrytëzim të A.G.1, në shfrytëzim të A.G., në shfrytëzim të B. G., dhe në shfrytëzim të B.G., për periudhën kohore që përfshin dt. 28.04.2022 dhe shikimit te raportit i hetuesit Enis Boshtrakaj me numër 2022-DE-203 i datës 27.05.2022 lidhur me analizën e thirrjeve telefonike “VALA”, dhe gjeti numri i telefonit, i të pandehurit A.G.1, ditën kritike ka qenë aktiv dhe është përdorur pak siç duket vetëm për internet dhe atë deri në ora 17:40. Numri i telefonit, me pronar të pandehurin A.G., ka qenë aktiv ditën kritike dhe është përdorur shumë ku është evidentuar se ka pas kontakte me numrin e vëllait- të pandehurit B.G.1 me numër, gjithsej 42 herë brenda ditës dhe disa nga thirrjet për periudhën në ora 18:22:02, 18:50:52, dhe në ora 19:14:28. Më pastaj evidentohet se ka komunikuar 22 herë me numrin e vëllait-të pandehurit N.G. dhe atë ora 19:40:47, si dhe ka shkëmbyer 10 mesazhe në këtë numër, në ora 19:55:43 deri në ora 21:13:26. Numri me pronar i pandehurit B.G.1, ka qenë aktiv ditën kritike dhe se ka pas kontakte vetëm me të pandehurin A.G. nga ora 08:49:10 deri me 15:30:04. Numri i të pandehuri B.G., evidentohet se nuk ka pas asnjë kontakt ditën kritike, por nga listingu i mesazheve të dërguara dhe pranuar vërehet se ka pas komunikime me mesazhe të dërguara dhe pranuar, ndërsa në deklaratën në Polici ka dhënë numër tjetër dhe atë

Vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve i dt.28.04.2022 më të cilin vërtetohet se telefoni i llojit Iphone me SIM karte me nr..... i është sekuestruar i të pandehurit B.1. Nga raporti i ekzaminimit të telefonave ka rezultuar se i njëjti nuk ka pasur të vendosur SIM kartelën të cilën e ka konstatuar më vërtetimin mbi sekuestrim por ka pas tjetër SIM kartelë dhe atë me numrin. e që rrjedhimisht rezulton se i njëjti këtë e ka bërë me qëllim për të penguar të provuarit e komunikimit me të pandehurit N. dhe A. dhe gjetjen e dëshmimeve që ndërliken me veprën penale.

Gjykata vlerësoi listingun te hyrje daljeve, të thirrjeve të mesazheve dhe hartografisë e numrave të siguruar nga “IPKO” për numrat, në shfrytëzim N.G., në shfrytëzim M.H., në shfrytëzim A.H. dhe ne shfrytëzim të F.H., për periudhën kohore që përfshin dt. 28.04.2022, dhe shikimit te raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj Enis Boshtrakaj më numër 2022-DE-203 të datës 03.06.2022, raport lidhur me analizën e thirrjeve telefonike “IPKO”, është konstatuar se mbi listingun e thirrjeve hyrje, mesazheve dhe hartografisë, ku është konstatuar se; Numri i telefonit i të pandehurit N.G., ka qenë aktiv për periudhën kohore të kërkuar, Në orët e paradites të ditës kritike është përdorur interneti ndërsa në orët e pasdites ka qenë më aktiv në shkëmbimin e mesazheve. Në kohën e rastit kritik ka pas kontakte me numrin (i pandehuri A.G.). Gjykata nga listingu i thirrjeve verteton faktin se të pandehurit N., A. dhe B.G.1, kanë komunikuar mes tyre me telefon para ngjarje natën kritike e që Gjykata vlerëson se të njëjtit kanë qenë duke u organizuar për të shkuar në vend ngjarje ku ishin te dëmtuarit.

Nga listingu i siguruar nga kompania “IPKO”, për numrat të cilët i kanë poseduar të dëmtuarit M.H., A.H. dhe tani të ndjerin F.H., ditën kritike Gjykata nuk vërtetoi ndonjë fakt, lidhur me veprën penale që janë objekt i kësaj procedure penale, pasi që nuk është evidentuar thirrje telefonike në nga ana e të dëmtuarve në drejtim të të pandehurve apo personelin e Restorantit dhe anasjelltas.

Nga raporti i ekspertimit mbi ekzaminimin e dëshmimeve nga AKF-ja me nr. AKF-2022-0244 i dt. 11.10.2022, ka rezultuar se janë ekzaminuar dëshmitë #6,#14 #28 dhe #29 ku nga këto dëshmi ka rezultuar se: dëshmia #6, Iphone 6s, nuk është arrite të ekzaminohet për shkak se ekrani i telefonit ka qenë i dëmtuar ndërsa SIM kartela është ekzaminuar, dëshmia #14, Iphone 12 pro, nuk është arritur të ekzaminohet sepse ka kod të sigurisë së panjohur po ashtu edhe SIM kartela nuk është arrit të ekzaminohet; dëshmia #28, Iphone 13 pro, është ekzaminuar dhe ka rezultuar me të gjetura, Gjykata gjeti se ky telefon ishte i të dëmtuarit A.H.; dëshmia #29, Iphone Xs, telefon i të pandehurit B. Gashi, është ekzaminuar dhe ka rezultuar po ashtu me të gjetura; Nga raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj mbi analizën e Raportit te ekspertimit të dëshmimeve nga AKF-ja me nr. AKF-2022-0244 i dt.31.10.2022 ka rezultuar se dëshmia #28 Iphone 13 pro ka qenë telefon i të dëmtuarit A.H. i cili është marrë ditën kritike nga ana e të pandehurve, ndërsa nga dëshmia #29 telefoni i të pandehurit B.G.. Nga raporti i hetuesit Enis Boshtrakaj i dt. 05.05.2022 me nr.2022-DE-203 dhe nr. ref 2022-HRP-57, vërtetohet se në dëshminë #29 – telefon Iphone X me ngjyrë të zezë pronë e të pandehurit B.G. ka rezultuar, se është gjetur se është zhvilluar thirrje përmes MSG-së, më të pandehurin A.G. në ora 8:16 PM- e që i bie 20:16 si dhe dy mesazhe të cilat i ka pranuar nga i pandehuri A. me përmbajtje: “Ej po tpres te rruga... au nise...” mirëpo i pandehuri B. Inuk është përgjigjur në këto mesazhe si dhe nga ekrani i këtij telefoni gjejmë se i njëjti ka komunikuar me të pandehurin N.G. dy here si dhe me persona të tjerë.

Gjykata gjeti se në këtë raport janë të paraqitura edhe fotot ku vërehet mesazhi i shkruar si dhe thirrjet telefonike (faqe21 -22 ne shkresat e lendes follderit nr.2), që vërteton faktin se i pandehuri B.G., ka komunikuar me të pandehurin A. në orën 20:16 (27 sekonda)bisedë, po ashtu vërtetohet fakti se i pandehuri B., ditën kritike ka komunikuar edhe me të pandehurin N.G. përmes telefonit.

Nga raporti i ekspertimit numër, AKF/2022-0244 i datës 16.06.2022 është konstatuar se DVR i tërhequr nga objekti “.....” dëshmia #24, nuk ka evidentuar/regjistruar ditën kritike brenda periudhës kohore nga ora, 20-23:59. Vendi ku është gjetur arma në punishten “.....”

Nga te cekurat më lartë Gjykata gjeti se, në veprimet e të pandehurve, N.G., B.G., A.G., A.G.1, dhe B.G.1, qëndrojnë te gjitha elementet e veprës penale, të kryer në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nënpar 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe veprës penale të kryer në bashkëkryerje, “vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, ndërsa për të pandehurin N.G. edhe të veprës penale, “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së.

Vepra penale e kryer në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” nga neni 173 par. 1 nënpar 1.8 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, në këtë rasti kishte humbur jetën tani i ndjeri F.H., sipas raportit të autopsisë me numër MA 22-128, te dt. 29.04.2022, i përpiluar nga Eksperti mjeko ligjor, Dr. Naim Uka, shkak i vdekjes së të ndjerit F.H. ka ardhë si rezultat i gjakderdhjes së brendshme trurore dhe thyerjes kockore si pasojë e veprimit dinamik të predhës se hedhur nga arma e zjarrit. Nga video-incizimet, është vërtetuar se natën kritike me pistoletën e përshkruar si ne dispozitiv të aktgjykimi ka shtënë i pandehuri N.G., pasi që ne video incizime vërehet momenti i shtënies me armë, po ashtu vërehet i pandehuri N. me pistoletë në dorë, faktin sa ka shtënë natën kritike me pistoletë i pandehuri N. e kishte pohuar edhe në deklaratën e dhënë në Polici, ku ndër të tjera kishte deklaruar se “armën e kam kap me dorën e djathtë dhe qysh ishim në tub ashtu unë kam shkrep alltinë në drejtim të tij një here dhe pastaj edhe një here. E kom pa kur F. ka rënë për tokë dhe ka mbet i shtrirë, me plumbin e dytë nuk e di a e ka rrokë M. por e kam gjujtë këmbëve”

Gjykata vlerëson se në këtë rast përmbushen elementet e veprës penale të Vrasjes së Rëndë për motive të hakmarrjes se paskrupullt, të paraparë me neni 173 par 1 nënpar 1.8 të KPRK-së, pasi që nga provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor u vërtetu fakti se qëllimi i të pandehurve ka qënë hakmarrja, ndaj të dëmtuarve familjes H., e në veçanti ndaj të dëmtuarit M.H., për një rast që kishte ndodhur ne Itali, ku ne këtë rast të pandehurit e fajësonin familjen e të dëmtuarve vëllezërit e të dëmtuarve te cilët jetojnë dhe veprojnë në Itali A., E.2, dhe B. H., se e kishin rrahur vëllain e të pandehurve, E.1 G. në Itali në prezencën e gruas dhe fëmijës.

Për rastin e ndodhur në Shtetin e Italisë në mesë të vëllezërve të dëmtuarve dhe vëllait të pandehurve, Gjykata e vërtetoi nga përgjigjja e autoriteteve Italiane e të përshkruar në raportin e i ILECU-të, të dt. 01.06.2022, ku është konstatuar; Nga kontrollet e kryera në bazën e të dhënave kombëtare italiane rezulton; E.1 G. 20.06.1990 është në posedim të leje qëndrimit ne Itali. E.1G. me dt.19.01.2022, ka raportuar në Stazione Carabinieri Borgo San Giacomo (Brescia) se është rrahur nga A. H. i lindur me 14.07.1984, E. H.3 i lindur me dhe B. H. i lindur me, sepse nuk e ka kthyer një borxh prej 300 euro, të dhënë disa javë me parë.

Po ashtu Gjykata vlerësoi se në veprimet e pandehurve N.G., B.G., A.G., A.G.1, dhe B.G.1, qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale, të kryer në bashkëkryerje, “vrasje e rëndë në tentativë” nga neni 173 par. 1 nën par. 1.8 lidhur me nenin 28 dhe 31 të KPRK-së, në dëm të dëmtuarve M.dhe A.H.. I demtuari M.H. natën kritike është plagosur në këmbën e majtë e që vërtetohet nga Akt ekspertimi Mjeko Ligjor., nr.Ref.PE.nr.34A i dt.15.02.2024, ku janë konstatuar plagët. Në regjionin e kokës është konstatuar, cikatriksi (Vrrajën) e plagës shquese ndrydhëse, e cila prezantohet ne regjionin pasëm dhe të djathtë të kokës, me gjatësi rreth 5cm, nga e cila, në 1cm e fundit ndahet vija tjetër e cikatriksit (vrrajes) me gjatësi rreth 1cm, e shkaktuar nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dhe të mbrehtë, dhe veprimi i peshës dhe tehut të mjetit të fortë (kacisë). Si dhe në lapren e veshit të majtë, është konstatuar një cikatriks (vrrajë), minimale.

Të gjitha këto plagë dhe lëndime te pasuara nga i dëmtuari M., ditën kritike, si pasojë e goditjes me predhë te shtënë nga arma e zjarrit, pastaj lëndimet e pësuar ne kokë si pasojë e goditjeve me mjetë të forta kaci (me tehë) sidomos ne regjionin e pasëm te kokës e ku është konstatuar plaga 5 cm, Gjykata vlerëson se ne veprimet e të pandehurve përmbushen elementet e veprës penale të vrasje së rëndë në tentativë. Gjykata vlerëson se e shtëna më armë nga ana e të pandehurit N., në drejtim të dëmtuarit M., pastaj goditja me predhë në këmben e majtë të cekur si ne Akt Ekspertizë, si dhe goditjet me mjetë të fortë (kaci) në kokë, tek të pandehurit ka ekzistuar dashja për ta privuar nga jeta të dëmtuarin M.H., mirëpo i dëmtuari M.ju ka shmangur goditjeve duke u larguar nga vendi i ngjarjes dhe duke hyrë në Restorant.

Faktin se i dëmtuari M.është goditur nga një predhë e armës së zjarrit dhe me mjetë të forta natën kritike vërtetohet nga, video-incizimet, e marra nga restoranti “.....” ku shihet se i dëmtuari M.në fillim bëhet shënjestër e goditje me mjete të forta nga të pandehurit e pastaj ne drejtim të tij shtënë me pistoletë i pandehuri N., pasi qe ne video incizimet vërehet i pandehuri N. me pistoletë ne dorë, pas plagosjes vërehet i dëmtuari M., duke u larguar nga vendi i ngjarjes në drejtim te Restorantit. Po ashtu faktin se ka shtënë natën kritike me pistoletë i pandehuri N. e kishte pohuar edhe në deklaratën e dhënë në Polici ku kishte deklaruar se “armën e kam kap me dorën e djathtë dhe qysh ishim në tub ashtu unë kam shkrep alltinë në drejtim të tij një here dhe pastaj edhe një here. E kom pa kur F. ka rënë për tokë dhe ka mbet i shtrirë, me plumbin e dytë nuk e di a e ka rrokë M. por e kam gjujtë këmbëve”

I dëmtuari A.H., natën kritike ka pësuar lëndimet në regjionin e kokës vërtetohet nga Akt ekspertimi Mjeko Ligjor nr.Ref.PE.nr.34B i dt.15.02.2024, ku janë konstatuar Cikatrikse (vrraja), në regjionin e sipërm të vetullës së djathtë, me gjatësi 0,6 cm, të shkaktuara nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dhe të mbrehtë (kacia). Në regjionin e sipërm te gishtit t III-të të dorës së djathtë është konstatuar, Cikatriks (vrrajë), me gjatësi 2 cm shkaktuar nga veprimi i kombinuar i mjetit të fortë dh të mbrehtë (kacia). Në regjionin e pasëm të kokës, është konstatuar plaga shquese ndrydhëse mirëpo shkak te dendësisë se flokëve nuk ka mundur te ekzaminohet cikatriksi (palgen-t) në këtë regjion.

Faktin se i dëmtuari A. është goditur me mjet të fortë natën kritike vërtetohet nga, video-incizimet, e marra nga Restoranti “.....” ku vërehet i dëmtuari A., duke u goditur me

mjete të forta nga të pandehurit, po ashtu edhe pasi që i ndjeri Fazli veç se ishte i shtrirë në tokë nga goditja me predhe nga arma e zjarrit, të pandehuri akoma vazhdojnë sulmin ndaj të dëmtuarit A., e ku ne video incizimet vërehet në orën, 07:30:52 (20:30:52)sekonda, i pandehuri A.1, duke e goditur me kaci të dëmtuarin A., në orën 07:30:55 sekonda, vërehet i pandehuri A., kur merr kacinë nga A.1i dhe e godet në kokë të dëmtuarin A.t. I pandehuri N., vërehet se mban pistoletën në të dy duart, të drejtuar nga i dëmtuari A., i pandehuri N. ne orën 19:30:22 dhe 19:30:27 shtënë dy herë ne drejtim te dëmtuarit A., e ku me këtë rastë i dëmtuari A.ka deklaruar se plumbi i ka shkuar afër fytyrës.

Lëndimet e pasuara nga i dëmtuari A., në regjionin e kokës si pasojë e goditjeve me mjete të fortë kaci (me tehë), pastaj faktin se ndaj tij është shtënë dy herë me pistoletë natën kritike, dhe njëra predhë i ka kaluar afër fytyrës, Gjykata vlerëson se ne veprimet e të pandehurve përmbushen elementet e veprës penale, Vrasje së rëndë në tentativë. Pasi që Gjykata vlerësoi se goditej me mjet te fortë me kaci në regjionin e kokës, tek te pandehurit ka ekzistuar dashja për ta privuar nga jeta të dëmtuarin A..

Se ndaj te dëmtuarit A., është shtënë dy herë nga i pandehurit N., gjen mbështetje edhe ne provat e gjetura në vend te ngjarjes e që janë 4 gëzhjoja, që vërteton faktin se në vend ngjarja është shtënë katër herë, e ku nga këto katër të shtëna, me njëren predh është goditur i dëmtuari M., pastaj me një predhë tjetër është goditur i ndjeri F., ndërsa me dy të shtëna tjera është tentuar të goditet i dëmtuari A..

Faktin se në veprimet e të pandehurve përmbushen elementet e veprës penal, të Vrasjes së Rëndë ku mbeti viktimë i tani i ndjeri F.H. dhe veprës penale, Vrasjes së Rëndë e mbetur në tentativë ndaj të dëmtuarve M.dhe A.H., për motive të hakmarrjes se paskrupullt, të paraparë me neni 173 par 1 nenpar 1.8 të KPRK-së, Gjykata e vërtetoi nga provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Gjykata gjeti se qëllimi i të pandehurve ka që hakmarrja, ndaj të dëmtuarve familjes H., për arsye te rastit që kishte ndodhur ne Itali, ku ne atë raste të pandehurit e fajësonin familjen e të dëmtuarve, vëllezërit e të dëmtuarve te cilët jetojnë dhe veprojnë në Itali A., E.3 dhe B. H., se e kishin rrahur vëllain e të pandehurve, E.1G. në Itali në prezencën e gruas dhe fëmijës.

Këtë hakmarrje e bën edhe me të paskrupullt fakti se të pandehurit janë hakmarrë ndaj familjarëve, që nuk kishin të bënin farë me ngjarjen e ndodhur ne Itali, e po ashtu nuk kishte prova se të njëjtit ishin ne dijeni apo të ishin përfshirë në rastin që ka ndodhur ne Itali, mirëpo natën kritike, kishin dalë për Iftar me familjen e tyre, dhe i vetmi “faj” i tyre ishte se vëllezërit e tyre në Itali, akuzoheshin nga të pandehurit se e kishin rrahur vëllain e tyre E.1 në Itali. Gjykata vlerëson se i ndjeri F. u bë viktimë e një hakmarrje të paskrupulltë, për një rast që kishte ndodhur me mija kilometra larg, e që i ndjeri F. as që kishte të bënte fare me atë rast.

Kodi Penal i Republikës së Kosovës ka paraparë si një nga format e bashkëpunimit në kryerjen e veprave penale edhe “Bashkëkryerja” e cila është paraparë ne nenin 31 të KPRK-së, ku theksohet se “Nëse dy apo më shumë persona së bashku kryejnë veprën penale duke marrë pjesë

në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër, secili prej tyre është përgjegjës dhe dënohet me dënimin e paraparë për veprën penale”.

Gjykata vlerësoi se në këtë çështje penale janë përmbushur elementet e bashkëkryerjes në kryerjen e veprave penale, të “vrasjes së rëndë” dhe “Vrasjes së rëndë në tentativë” për të cilat Gjykata i shpalli fajtorë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, N.G., B.G., A.G.. A.G.1, dhe B.G.1.

Gjykata vlerëson se të gjithë të pandehurit kanë marrë pjesë në kryerjen e këtyre veprave penale, pasi që secili nga të pandehurit kanë kontribuar në kryerjen e këtyre veprave penale.

Gjykata gjeti se të pandehurit fillimisht pasi që kanë ra në dijeni se i dëmtuari M.H. është duke ngrënë darkë- Iftar, me familjen e tij në Restorantin “.....” të pandehurit janë organizuar si të shkojnë të Restoranti në mënyrën sa me të organizuar dhe për mos të tërhequr vëmendje. Në video incizimet e siguruar nga Restoranti “.....” vërehen të pandehurit që fillimisht takohen afër parkingut të këtij Restoranti, dhe pas një bisede marrin edhe disa gjera nga vetura Reno Clio dhe i vendosin në Pik-up, pastaj e parkojnë veturën Reno Clio afër parkingut të Restoranti “.....” dhe me Pik-up nisen për të Restoranti “.....” ku ishte i dëmtuari M.H. me familje, në Pik-up, ishin të pandehurit N., A.1 dhe B.G.1, ndërsa i pandehuri B. me të pandehurin A., e lojnë veturën e të pandehurit B.1 tek Restoranti “.....”, dhe nga aty shkojnë në këmbë deri te parkingu i Restoranti “.....”.

Fillimisht në parkingun e Restorantit “.....” arrin me pik-up, të pandehurit N., A.1 dhe B.G.1, pastaj vetëm, 7 minuta pas tyre, sipas kohës së regjistruar në kamerat e Restorantit, aty arrin në këmbë të pandehurit A. dhe B.G., e që vërteton faktin se shkuarja në vend ngjarje ka qenë e planifikuar dhe koordinuar mirë që të gjithë të shkojnë së bashku.

Meqenëse qëllimi për hakmarrje ka qenë i të gjithë pandehurve edhe shkuarja në vend ngjarje ka qenë e koordinuar dhe secili nga të pandehurit ka marrë pjesë aktivisht në kryerjen e këtyre veprave penale, në mënyra të ndryshme, ku fillimisht i pandehuri B.1, pasi arrin në parkingun e Restorantit “.....”, dhe bisedon me të pandehurit tjerë, i njëjti pastaj hynë në Restoranti “.....”, shikon nga vendi ku ishin të ulur të dëmtuarit me familjen e tyre, pastaj i pandehuri B.1 delë jashtë bisedon me të pandehurit tjerë dhe i informon se të dëmtuarit gjinden brenda, pastaj bën disa përpjekje për të hyrë nga hyrja që gjendet në pjesën anësore të Restorantit, mirëpo meqenëse në Restorant brenda ishin të gjitha tavolinat e rezervuara i pandehurit B.1, ulet në pjesën e tarracës dhe gjatë gjithë kohës monitoron situatën duke përcjellë vazhdimisht vendndodhjen dhe lëvizjet e viktimës dhe të dëmtuarve në brendi të restorantit. Gjykata gjeti se kontributi i të pandehurit në këtë rast ishte informimi i të pandehurve tjerë, me faktin se kush nga familja H. ishte në Restorant, këtë kontribut e bën të rëndësisë së veçantë fakti se deri sa të dëmtuarit ishin brenda në Restorant, të pandehurit N., A.1, A. dhe B., nuk janë ekspozuar për të ra në sy të familjes H., duke e ditur faktin se të njëjtit mund të njiheshin nga familja H., ndërsa të pandehurin B.1, familja H. nuk e kanë njohur, e për me shumë nuk kishin arsye për të dyshuar në të. Ky kontribut i të pandehurit B.1 ka ndihmuar që të pandehurit N., A.1, A. dhe B., mos të ekspozohen para familjes H. e që eventualisht familja H. të përgaditet për ndonjë sulm që mund të ju vije nga vëllezërit G.. Po ashtu në video-incizimet e mara nga Restoranti “.....” në

një moment të caktuar vërehet i pandehuri B.1, duke penguar dëshmitarin E. B., në momenti që dëshmitari E.2. tenton të ndal sulmin e ber nga vëllezërit G.në drejtim të dëmtuarit A., e ku ishin duke e goditur me mjetë të forta në kokë, ky fakt le të kuptohet se i pandehuri B.1, ka dëshiruar edhe pasojën e shkaktuar nga veprat penale, pasi qe ka penguar dëshmitarin E2. për ta ndalur sulmin që ishte duke u ber ndaj të dëmtuarit A..

Ndërsa fakti se të pandehurit A., A.1 dhe B., kanë përdoruar mjetë të forta duke goditur në pjesë te ndryshme të dëmtuarit, vërtetohet nga video-incizimet e marra nga vendi i ngjarjes, e ku shihet se të gjithë ishin të përfshirë në mënyrë aktive në kryerjen e veprave penale duke i goditur te dëmtuarit M. dhe A.në kokë me mjetë te forta si Stupca dhe Kacia, e po ashtu vërehen se në mënyrë aktive kanë marrë pjesë ne goditjen e tani të ndjerit, sa ishte i ngritur por edhe ne momentin kur i njëjti ishte i shtrirë, e që lëndimet nga mjetet e forta në trupin e tani të ndjerit janë evidentuari edhe në raportin e autopsisë.

I pandehuri N., përveç faktit se fillimisht vrapon me një mjetë të fortë në dorë ne drejtim te dëmtuarit M., i njëjti në video-incizimet e marrë nga vendi i ngjarjes vërehet me pistoletë në dorë dhe vërehet momenti kur shtënë ne drejtim te dëmtuarve dhe në drejtim të tani te ndjerit F.H..

Gjykata vlerësoi elementin e bashkëkryerjes në raport me përgjegjësin individuale të secilit të pandehur për veprimet e tij, mirëpo gjeti se në këtë rast në bashkëkryerje kanë marrë pjesë te gjithë të pandehurit qe gjykata i shpalli fajtorë pasi qe, secili ka kontribuar ne kryerjen e këtyre veprave penale. Gjykata vlerësoi se në këtë rast përdorimi i pistoletës nga ana e të pandehurit N., nuk mund te vlerësohet si veprim individual i shkëputur nga veprimet e te pandehurve tjerë, pasi qe në momenti kur i pandehuri N. ka përdorë armen, të pandehurit tjerë, A.1i, A.i dhe B., kanë qenë duke marrë pjesë aktivisht në sulm ndaj të dëmtuarve, andaj marrja pjesë e tyre përveç qe ka shkaktuar pasojë me lëndime tek të dëmtuarit Al. dhe M., ka penguar të dëmtuari qe eventualisht edhe të mbrohen nga i pandehuri N., po ashtu edhe fakti se të pandehurit A.1, B.dhe A. , i kanë goditur ne kokë me mjete të forta si kaci (me teh) të dëmtuarit tjerë e me këtë rast edhe tani të ndjerin, len te kuptohet se tek të njëjtit ka ekzistuar dashja për pasojën që mund të vije nga goditje në ato mjetë, e që është vrasja e të dëmtuarve.

Gjykata vlerëson se tek të pandehurit ka ekzistuar dashja si element subjektive ne kryerjen e veprave penale, pasi qe asnjëri nga te pandehurit prezent natën kritike, nuk ndërmori ndonjë veprim i cili do të lentë te kuptohet se ndonjëri nuk ka pasur dashje ne pasojat e shkaktuara natën kritike, po ashtu edhe pasi qe i pandehuri N.G., shtënë katër herë me pistoletën e tij, të padënuarit tjerë nuk e ndalojnë sulmin fillimisht e godasin të ndjerin F. edhe pasi qe ishte i shtrirë në tokë, pastaj duke e parë se i ndjeri F. është i shtrirë, vazhdojnë sulmin ndaj të dëmtuarit A., ndërsa në sulmë kontribon edhe i pandehuri B.G., duke e larguar dëshmitarin .2 Gjykata vlerëson se në këtë rast sulmi ndaj të dëmtuarve është ndalur vetëm kur i pandehuri, N. ka thënë se ju ka bllokuar Pistoleta. Ndërsa fakti se pistoleta është, koqitur- bllokuar, natën kritike ka mbështetje edhe në provat materiale si një fishek i gjetur i pa shkrepur natën kritike në vendin e ngjarjes, pastaj edhe një fishek tjetër po i të njëjës armë është gjeture në veturën Pik-up, me të cilën veture, të pandehurit janë larguar nga vendi i ngjarjes dhe e kanë dërguar pistoletën deri në

punëtorin “.....”, e që Gjykata vlerëson se fishekët, kanë ren në momentin kur i pandehuri, N.G., ka repetitë armën duke u munduar ta zhblllokoj.

Gjykata nuk ju fali besimin deklaratave të pandehurve kur te njëjtit deklaronin se pasi qe e kanë vërejtur veturën e të dëmtuarit M.H. në parkingun e Restoranti, “.....”, të njëjtit kanë pritur vetëm për te biseduar, apo siç deklaroi i pandehuri A.1 për të ja dhënë disa flakaresha–shuplakë, të dëmtuarit M., pasi që Gjykata vlerësoi se një deklaram i tillë është ne kundërshtim me provat personal edhe materiale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor. Nëse të pandehurit do te kishin si qellim te bisedonin më te dëmtuarin M.H. apo të ja japin vetëm ndonjë flakaresh, atëherë pse u pajisen me gjithë ato mjete të forta si stupca-bishta te sakicave, kacia, e pastaj edhe me armë zjarri –pistoletën e përdor natën kritike, nga i pandehuri N.. Nga video incizimet e marra nga kamerat e Restoranti “.....”, shumë qartë shihet, kur i dëmtuari M.H., del nga Restoranti “.....”, me familjen e tij dhe shkon në drejtim te veturës së tij, i njëjti sulmohet menjëherë me mjete të forta nga të pandehurit dhe aty as qe kishte tentim nga të pandehurit për të biseduar me të dëmtuarit.

Gjykata ka vlerësuar se në këtë rast tek veprat penale, të kryera në bashkëkryerje, “Vrasje e rëndë” dhe vepra penale e kryer në bashkëkryerje, “vrasje e rëndë në tentativë”, nuk përmbushet edhe elementi nga pika 1.5 i nenit 173 të KPRK-së, ku parashihet se “privon nga jeta personin tjetër dhe me atë rast me dashje e vë në rrezik jetën e një ose më shumë personave tjerë” pasi që, Gjykata vlerësoi se në këtë rast nuk kishte prova se ndonjë personi tjetër i është rrezikuar jeta e po ashta as Prokuroria ne aktakuzë nuk ka cekur ndonjë person konkret te cilit i është rrezikuar jeta në ndonjë mënyrë nga veprimet te pandehurve, përveç të dëmtuarve M.dhe A., e që për veprimet ndaj tyre, Gjykata i shpalli fajtorë të pandehurit, për shkak te veprës penale, vrasje e rënd e mbetur në tentativë.

Gjykata gjeti se, në veprimet e të pandehurit N.G., përmbushen elementet, të veprës penale “Mbajtje në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armeve” nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, pasi qe i pandehuri ditën kritë e ka poseduar armë e që vërehet edhe në video-incizimet e mara nga kamerat e Restorantit “.....”, e me të cilën edhe ka shtënë ne drejtim te dëmtuarve, dhe tani të ndjerit. Ndërsa gjykata nuk ja fali besimin deklaramit te pandehurit N. kur i njëjti deklaroi se pistoletën e ka marrë në tokë pasi qe i ka ra nga dora te dëmtuarit M., pasi qe ky deklarim i të pandehurit, nuk kishte mbështetje në asnjë provë materiale.

Gjykata ka vlerësuar deklaratat e të pandehurve, N., .1 A., B. dhe A.G.1, dhe gjeti se të njëjtat kanë kundërthënie ne mes tyre, fillimisht ka kundërthënie në mes të deklaratave të dhëna nga vetë të pandehurit, në Polici, Prokurori, e me pas edhe në shqyrtim Gjyqësor, pastaj kanë kundërthënie edhe ne mes te deklaratave të njeri tjetrit, andaj si te tilla në tersin e tyre Gjykata i vlerësoj si jo të besueshme e të bëra vetëm me qellim te ikjes apo zvogëlimit të përgjegjësisë penale nga ana e të pandehurve.

I pandehuri N.G., ne deklaratën e dhëne ne Polici me dt. 29.04.2022, nder të tjera kishte deklaruar se, kanë qenë duke shkuar me vëllezërit e tij në drejtim të Restorant “.....” që gjendet përball pllacit të tyre në fsh. Valljak, me qëllim më pi kafe. Në atë moment aty derisa

ishin duke kaluar rrugën ka kaluar M.H. me veturën “Porche” dhe ka ngadalësuar shpejtësinë dhe i ka shikuar. Të pandehurit kanë qenë shumë të mllefosur në të (M.in) dhe menjëherë është kthyer me vëllain A.1in dhe me veturën tyre “Renault Pick-Up”...janë nisur në drejtim të “.....” në kërkim të M., sepse ju ka mare mendja që ai është duke shkuar në ndonjërin nga Restorantet për darkë. Pasi e që e kanë parë veturën e M. i kanë njoftuar përmes telefonit edhe vëllezërit A.in dhe B. të cilët kanë ardhur...”

Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt.11.01.2023, i pandehuri N.G., kishte deklaruar, se kanë shkuar me veturën Pikc-up se bashku me A.1in dhe B., në fillim kanë shkuar në Restorantin “.....”, për me shikuar a mos është ndal aty M., por e kanë parë se nuk është ndalur aty pastaj kanë shkuar tek Restoranti “.....” dhe në fund e kanë shkuar të Restoranti “.....ë” paso që kanë pa se vetura e M. ishte aty, ku me këtë raste janë parkuar në parking Restorantit “.....”. Po ashtu ne Prokurori ka deklaruar se A.i vëllai i tyre kishte e qenë ne dijeni se ne iu vumë pas M..

Në deklaratën e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor me dt. 25.04.2024, deklaroi se ka shkuar tek “.....”pasi që është ftuar nga vëllezërit e tij A.1i dhe B., se ju ka prishë vetura “Reno Clio” duke shkuar në Gjakovë, dhe pasi janë takuar kanë dashtë të hynë të për të pirë kafe në Restorantin “.....”, mirëpo aty kishte pasur tollovi, dhe e kanë lënë veturën në parking të Restorantit “.....” për arsye të shkojnë tek Restoranti “.....”, me pi kafe. Kur kanë shkuar tek Restoranti “.....” me pik-up, duke u parkuar e kanë vërejte veturën e M.H. dhe për këtë arsyes nuk janë hy me pi kafen, pasi që M. i njeh dhe e din që ka problem me ta, mirëpo kanë qëndruar në pik-up, N.i, B.dhe A.1i.

Pra përderisa në Prokurori, kishte deklaruar se kanë shkuar pas M. , në gjykatë deklaroi se tek Restoranti “.....” ka shkuar pasi që është ftuar nga vëllezërit e tij, A.1i dhe B., se ju ka prishë vetura “Reno Klio” duke shkuar në Gjakovë, dhe pasi janë takuar kanë dashtë të hynë të për të pirë kafe në Restorantin “.....”, mirëpo aty kishte pasur tollovi, dhe e kanë lënë veturën aty në parking të Restorantit “.....” për arsye të shkojnë tek Restoranti “.....”, me pi kafe. Kur kanë shkuar tek Restoranti “.....” me pik-up, duke u parkuar e kanë vërejte veturën e M.H. dhe për këtë arsyes nuk janë hy me pi kafen, pasi që M. i njeh dhe e din që ka problem me ta, mirëpo kanë qëndruar në veturën Pik-up më B. dhe A.1in.

Lidhur me faktin se a kishte shtënë i pandehuri N., apo si kishte ardhur deri të vrasjeae ta ndjerit F.H., natën kritike i pandehuri N.G., në Polici kishte deklaruar se “Kam pa M. kur e ka hap qantën e krahut dhe ka nxjerrë pistoletë dhe e ka drejtu në drejtim tonin. Ne atë i ka ra dikush me bisht në dorë dhe i ka rënë pistoletë në tokë, Une e kamë pa pistoletën që i ka rene dhe e kam marrë me dorën e djathë dhe kam gjujtë një herë edhe M. ka ik edhe pse jam majtak nuk kam mujt me kap pistoletën me dorën e majtë. Andaj armën e kam kap me dorën e djathtë dhe qysh ishim në tub ashtu unë kam shkrep alltinë në drejtim të tij një here dhe pastaj edhe një here .E kom pa kur F. ka rënë për tokë dhe ka mbet i shtrirë, me plumbin e dytë nuk e di a e ka rrokë M.por e kam gjujtë këmbëve”.

Në deklaratën e dhënë në Prokurori, me dt.11.01.2023, kishte deklaruar se “Përderisa ishim në përlshje e sipër, njëri prej vëllezërve e ka goditur M. dhe aty i ka rënë arma në tokë, ashtu që unë kam arritur që ta marr armën në duar, e me të njëjtën kam lëvizur por nuk kam gjuajtur me të në drejtim të askujt.” Pra këtu e ka mohuar faktin se ka gjuajt më armë.

Ndërsa ne shqyrtimin gjyqësor të dt.25.04.2024 i cili ndër të tjerat ka deklaruar: “M. e ka shkrep armën në tollovi dhe aty është vrarë vëllai i tij, tashmë i ndjeri F.H., pa dëshirën e M.H.. Gjatë përlshjes, vëllai A.I, e ka godit në dorë M.H. me shkop dhe aty i ka ra arma në tokë. Nga frika se mos të na vriste e kam kap armën nga toka, kam lëviz me armë, por nuk e kam përdorur armën, sepse nuk kam dit me përdor armë, sepse kur në jetën time nuk kam përdorë armë”

Nga deklaratimet e të pandehurit, N. gjejmë se i njëjti në tri deklaratat e dhëna ka dhënë versione të ndryshme duke u munduar ti iktë përgjegjësitë penale, ku i njëjti në Polic ka deklaruar se “armën e kam kap me dorën e djathtë dhe qysh ishim në tub ashtu unë kam shkrep alltinë në drejtim të tij një here dhe pastaj edhe një here .E kom pa kur F. ka rënë për tokë dhe ka mbet i shtrirë, me plumbin e dytë nuk e di a e ka rrokë M.por e kam gjujtë këmbëve”. Gjatë deklaratimit në Prokurori dhe në shqyrtimin gjyqësor e ka mohuar faktin se ka shtën me pistoletë, ndërsa në shqyrtimin gjyqësorë ka deklarua se “M. e ka shkrep armën në tollovi dhe aty është vrarë vëllai i tij, tashmë i ndjeri F.H., pa dëshirën e M.H.s”. Gjykata nuk ja fali besimin deklaratimit të pandehurit N. të dhen ne shqyrtimin gjyqësor kur i njëjti deklaroi se M. H. e ka vra tani te ndjerin F.H., pasi qe një deklaram i tillë nuk kishte mbështetje ne asnjë provë tjetër materiale, e po ashtu vërehet edhe në video-incizime, se në momentin qe goditet i ndjeri F. , i dëmtuari M.është tek hyrja e Restoranti “.....”. I pandehuri N.G., ne shqyrtimin gjyqësor, pasi ju përgjigj pyetjeve të parashtruara nga mbrojtësi i i tij, ne vazhdim deklaroi se do të mbrohet në heshtje dhe nuk do të përgjigjet në asnjë pyetje.

Po ashtu deklaratat e të pandehurit B.G., ishin ne kundërthënie ne mes tyre, I pandehuri B.G., në deklaratën e dhënë në Polici me dt. 29.04.2022, ndër të tjera ka cekur se : “ atëherë me veturën time të tipit BMW-316, ngjyrë e zezë, kam shkuar tek punëtorja e A.it, që është buzë rrugës së magjistrales Klinë-Gjakovë. Aty nuk kishte qenë askush, atëherë jam nisur në drejtim të Restorantit të Islamit (.....). Me të mbërritur aty, jam ulur në një tavolinë vetëm, ndërsa rreth meje kishte pasur shumë mysafirë, unë vizualisht kam shikuar mos po i shoh djemtë e vëllait tim, mirëpo nuk i pashë. Unë kam filluar që të mendoj që të njëjtit nuk janë aty, ndërkohë kam qëndruar brenda në Restorant, nga disa mysafirë, kam dëgjuar se ka të shtëna me armë zjarri, që vinin nga Restoranti “.....”, që gjendet shumë afër vendit ku isha ulur unë. Atëherë kam dalur në rrugë me këmbë jam nis në drejtim të Restorantit Përgjatë rrugës nuk kam vërejtur asnjë automjet, apo vetura duke ikur nga vendi i ngjarjes, mirëpo me të arritur aty, i kam vërejtur Policinë...”, pra Gjykata gjen se i pandehuri B.G. në Polici e ka mohuar faktin të ketë qenë në vend të ngjarjes, në Restorantin “.....”, kur ka ndodhur rasti, mirëpo ka deklaruar se ka qenë në Restorantin

Në deklaratën e dhënë në Prokurori me dt. 05.01.2023, lidhur me këtë fakt ka deklaruar se: “më ka thirr A.i, djali i vëllait dhe ka thënë “xhaxh a mundesh mem qu me kerr deri tek, pasi që unë nuk kom kerr dhe jam tek vend punishtja “.....” dhe se më tha po ashtu se “vëllezërit

e mi po më duket se kanë shkuar tek Ujëvara dhe se aty poget se osht edhe M.H. e po tutna se mos po bojnë fjalë” po ashtu deklaruar se pasi kanë shkuar në parkingun e Restorantit “.....”, e kanë parë veturën “Pick-up”, e cila ishte e parkuar dhe kanë shkuar së bashku me A.in aty, e ka parë N.in që ishte në ulëse të shoferit, e hapi derën kur i pa, doli jashtë dhe aty i ka thënë N.it se: “çka je ty bo ktu dhe nëse jeni ardh për me bo fjalë a najsend, mos më merrni në qafë po hajde dheze kerrin, e hecni prej shpije”

Në Gjykatë deklaroi se e “ kam marr A.in dhe jemi nis për e dërgu në Restorantin Kur kemi shku aty, A.i e ka pa veturën e vet të parkuar tek “.....”, në një parking që e posedon S. B., Pastaj kemi dal nga kerri afër ku ishte parkuar vetura e A.it, në parkingun e S. B.. A.i shikoi se mos është vetura tjetër aty “Pik-up”, A.i tha nuk qenka Pik-upi këtu, mos janë shku tek I.B., në Restorantin “.....”. Pasi nuk është larg në “.....” veturën time e kemi lënë aty dhe kemi shkuar në këmbë, nga ai parking në Restorantin “.....”. Si kemi hyrë në hymje të oborrit të Restorantit “.....”. Tani ka dal nga pik-upi nuk e di sigurte a ka qenë N.i, apo cili nga vëllezërit, mirëpo mendon se ka qenë N.i. Unë ju kam drejtu, ju kam thënë çka po bëni këtu, N.i më tha asgjë. Unë ju kam drejtu me fjalë se nëse keni ardh me bo fjalë me dikënd mos më merrni në qafë as mu as vetën. N.i mu ka përgjigj se jo nuk e kemi menden me bo fjalë me askënd por jemi ardh me pi kafe. Pastaj A.i më ka thënë shko hin brenda në Restorantin “.....”, porosite një kafe sepse edhe ne po vijmë, unë jam nis me shku në Restorant”

Gjykata gjeti se edhe deklaratat e të pandehurit B.G., kanë kundërthënie ne mes tyre, andaj si te tilla nuk ju falë besimin përderisa në Polic kishte mohuar faktin se ka qenë ne vend te ngjarjes, ne Prokurori dhe në Shqyrtim gjyqësor ka deklaruar se kinse aty ka shkuar vetëm ta dërgoj të pandehurin A.. Gjykata vlerëson se nga shikimi i video-incizimeve të marr nga kamerat e Restorantit “.....”, vërehet shumë mirë kontributi i të pandehuri B.1 i cili pasi qe bisedon me të pandehurin N.G., hynë ne Restorante për të shikuar se ku është i ulur M.H. me familjen e tij dhe pastaj del përsëri bisedon me të pandehurit tjerë dhe pastaj shkon e ulet ne terasen e Restorantit “.....”.

Po ashtu edhe deklaratat e të pandehurit A.G., janë ne kundërthënie ne mes tyre, I pandehurit, A.G., në deklaratën e dhënë në Polici, me dt. 28.04.2022, ndër të tjera kishte deklaruar se, ditën kritike rreth orës 16:30, përderisa ishte në pritje para punëtorisë ka kaluar vetura e tipit “Porche” me ngjyrë e kuqe të cilën ishte duke e vozitur M.H., nga fshati Gullbovc –Malisheve. Po sa e ka vërejte A.in se ishte aty, M. e ka ngadalësu veturën e tij dhe për një moment e ka nis vrullshëm në drejtim të Gjakovës, dhe në atë moment përmes telefonit A.i e ka thirre vëllain A.1in G. dhe i kam treguar, ku pas pak çastesh aty kanë ardhë A.1i, N.i dhe B., dhe pasi që biseduan mes tyre A.i ju ka thënë vëllezërve: “merrne kerrin tim dhe nisuni në drejtim të Gjakovës se mos është ndal M.dika ka Guri i Zi” ku të njëjtit e kanë marr veturën time “RENO” dhe u nisën në drejtim të Gjakovës ku pasi kanë identifikuar se i njëjti ishte parkuar në Restorantin “.....”, pastaj e ka telefonuar vëllai A.1i dhe i ka thënë se M., qenka aty në Restorant. Me pas me Auto Stop deri tek rruga “.....s” ku edhe kishin qenë në pritje edhe vëllezërit e tij.

Në deklaratën e tij të dhënë në Shqyrtimin Gjyqësor, me dt. 12.06.2024, i pandehuri A.G., kur tregonte momentin se si e ka parë te dëmtuarin M.H., nder të tjera deklaroi se ka qenë tek

punëtorja kur ka kaluar M.me veturën Porsche dhe kur ka ardh tek punëtorja, e ka ndal veturën sepse nuk ka qenë duke ec shpejtë dhe e ka hap dritaren dhe i ka ofendu dhe i ka kërcënu dhe i ka dhënë shllajf kerrit, A.i ka qenë më vëllezër, B., A.lin, N.in, axha Imeri ka qenë aty, vëllai A.li dhe vëllai B., e kanë marr veturën “Reno Clio” dhe janë nis në drejtim të Gjakovës, dhe i kanë thënë A.it po shkojmë po takohem me M. dhe po e pyesim pse edhe na ke rreh vëllain edhe prapë nuk po i ndal kërcënimet ndaj tyre. Po ashtu ka deklaruar se tek punëtorja ka qëndruar 40 minuta deri 1 orë, pasi që kanë shku vëllezërit. Pasi që dikush nga vëllezërit e ka thirr dhe i ka thënë se M. qenka tek “.....”. Meqenëse nuk kishte veturë aty dhe e ka thirr në telefon axhën B.1 dhe i kam thënë axhës, a po vjen deri tek punëtorja në Volljakë se kanë shku ata djemtë me u taku me M.in, dhe po tutna mos po bëjnë problem, a ka mundësi me ardhë me e dërgu deri tek “.....” dhe kthehu shko në shtëpi.

Gjykata gjeti se deklaratat e të pandehurit A. kanë kundërthënie ne mes tyre pasi që në Polic i njëjti ka deklaruar, se ka qenë vetëm në punëtori kur aty ka kaluar M.H. dhe i njëjti e ka ngadalësuar veturën e tij dhe për një moment e ka nisur vrullshëm në drejtim të Gjakovës. Më pastaj se i A.i, përmes telefonit e ka thirrë A.lin dhe i ka treguar, ku pas pak çastesh aty kanë ardhë A.li, N.i dhe B., dhe pasi që biseduan mes vete A.i iu ka thënë vëllezërve: “merne kerrin tim dhe nisuni në drejtim të Gjakovës se mos është ndal M. dika ka”, në gjykatë deklaroi se kur ka kaluar M., e ka ndal veturën, e ka hap dritaren, i ka ofenduar dhe kërcënuar si dhe në punëtori kishte qenë së bashku, me vëllezërit por edhe me axhën e tij Imerin. Në Polici ka deklaruar se deri tek rruga e Restorantit “.....” ka shkuar me Auto Stop, ndërsa ne Gjykatë deklaroi se aty e ka dërguar axha i tij B.a pasi që ky e kishte thirrë ne telefon dhe kishte kërkuar nga aj që ta dërgon deri aty.

Në Polici ka deklaruar se me axhën B.1, janë takuar vetëm pas rastit tek shtëpia e tyre, kurse në gjykatë deklaroi se ishte axha B. ai që e ka dërguar tek vendi i ngjarjes pas komunikimit me telefon. I pandehuri A. ne Prokurori ishte mbrojtur në heshtje, ndërsa ne shqyrtimin gjyqësor, pasi ju përgjigj pyetjeve të parashtruara nga mbrojtësi i i tij, ne vazhdim deklaroi se do të mbrohet në heshtje dhe nuk do të përgjigjet në asnjë pyetje.

I pandehuri B.G.1 në deklaratën e tij të dhënë në Polici, me dt. 29.04.2022, i, ndër të tjera kishte deklaruar se nuk ka qenë aty në Restorant kur ka ndodh problemi, dhe sa e din aty ka qenë vëllai i tij A.li dhe N.i, pra i pandehuri B. ne Polici e ka mohuar faktin se ka qenë ne vend ngjarje ditën kritike.

Ndërsa në deklaratën e tij të dhënë në Shqyrtim Gjyqësor, me dt. 12.06.2024, ka deklaruar se, duke shkuar në lokal E.3, aty ka kuluar M. me veturë, dhe na ka provokuar në mënyrë banale të panevojshme me disa shllajfa, e ka zvo glu shpejtësinë, kur i ka pa duke kaluar asfaltin i ka jep gaz dhe ka jep shllajf, nuk ka fol, ka qenë vetëm. Pastaj kanë shku në Restorant, E.3 ka qëndru diku 40 minuta deri 1 orë. A.li është dal i pari nga Restoranti .3 B.ka dal pas tij dhe janë nis, me A.lin me Reno për në fshatin Mejë, sepse kishin i me u marr vesh me myshterijntë që kanë punuar. Diku përtej “.....”, gjatë rrugës vetura nuk ishte diçka në rregull, pastaj janë kthyer ngadalë dhe kanë shku në parking të “.....”. E kanë lënë veturën në parking të “.....”, dhe e ka thirrë N.in duke i thënë, merre Pik-upin dhe hajde në parking të “.....”. Pasi ka

shkuar N.i me Pik-up, i kanë i hek disa vegla prej Renos, disa haletë të punës, i kanë vendos në Pik-up. Iu ka thënë vëllezërve A.1it dhe N.it, a të hyjnë të pimë kafe tek “.....”, kur kanë shku deri në gjysmë të oborrit, kanë ndi si muzikë, si zhurmë, si darsëm në “.....”, për ketë arsye kanë shkuar tek Restoranti “.....” të pinë kafe. Janë shku me Pik-up, janë hy në oborr të Restorantit “.....”, duke parkuar e kanë pa veturën e M. dhe ju ka thënë vëllezërve vetura e M. koka këtu. B. ju ka thanë vëllezërve të tij se “unë dal e merrna vesh me M.” Ka dashtë me i thonë M. “le se na rehe vëllain, po pse nuk po na lenë në shtëpinë tonë rehat”.

Gjykata deklarave të pandehurit B.G.1, nuk ju fali besimin pasi qe i njëjti në Polic kishte deklaruar se farë nuk ka qenë në vend ngjarje natën kritike, ndërsa ne Gjykatë deklaroi se ne Restorantin “.....” kanë shkuar rastësisht pasi që ju ka prishur vetura duke shkuar në fshatin Mejë, dhe meqenëse vetura ju ka prishur këta janë ndalur për te pirë kafe fillimisht kanë dashtë me hy ne Restorantin “.....” e pastaj meqenëse aty kishte guzhem kanë shkuar ne Restorantin “.....” dhe aty kanë pa veturën e M.t. Në Prokurori i pandehuri B. G., është mbrojtur në heshtje. I pandehuri B.G.1, ne shqyrtimin gjyqësor, pasi ju përgjigj pyetjeve të parashtruara nga mbrojtësi i i tij, ne vazhdim deklaroi se do të mbrohet në heshtje dhe nuk do të përgjigjet në asnjë pyetje.

Edhe deklaratat e të pandehurit A.G.1, kishin kundërthënie mesë tyre, i pandehuri A.1 në deklaratën dhënë në Polici, me dt. 29.04.2022, ndër të tjera kishte deklaruar se ditën kritike pasi qe janë kthyer në vendpunishte për me pre gurë por maqina nuk ju ka punuar sepse ishte prish, pastaj kanë vendos me pi kaf ne Restorantin “.....”, pasi kanë pi kafe jan qu me shku në shtëpi dhe duke hecur nga hoteli ne drejtim te pllacit ku e kishin pik-upin, e kanë parë rrugës ka kaluar vetura Porsche të cilën, e kanë njoftë se është e M. dhe ai e voziste, M.ishte vetëm ne veturë dhe ka shkuar nga Klina ne drejtim te Gjakovës. Pas 20 minutave A.1i ka vendosur se bashku me N.in me shku pas tij, duke e ditur se M. ka mujt me shku vetëm ne Restorantet të “.....”, “.....” ose “.....”, kanë dashtë vetëm me shku me e rrahë me ja kthye rrahjen të cilën ja kishte bër vëllait te tyre Egzonit në Itali, para tre majave. Kanë shkuar se pari të Restoranti “.....”, nuk ka qenë aty e pastaj kanë vazhduar të Restoranti dhe e kanë parë se e kishte Porschen aty dhe janë parkuar aty dhe e kanë pritë 25 minuta deri sa ka dal M. nga Restoranti. Kur ka dal M. nga Restoranti dhe ju ka ofruar veturës se tij, i pandehuri A.1 ka dal nga vetura e tij Pic-up, me një bisht te sakicës ne dore, e po ashtu edhe vëllai i tij N.i, ka dal me një bisht te sakicës në dorë, pastaj i pandehuri A.1 ka tëntu m’i ra M.t, atëherë ka bërtit vëllai i tij “M.ruju” dhe A.1i e ka godit me bisht në shpinë një herë M.in, menjëherë M. e ka shty. A.1in e ka sulmua me grushta vëllai i M., pastaj ka pa kur M. e ka nxjerr pistoletën e repertirat dhe ju ka drejtua N.it, ka dëgjua një krismë dhe nuk i kujtohet asgjë vetëm kur e ka par vetën në “Pick Up” e tyre dhe N.i duke vozitë. Në Polici po ashtu ka deklaruar se vëllain e tij A.in, nuk e ka pa sot hiq ndërsa në pyetjen se kush e ka sulmuar tjetër M., A.1i është përgjigjur “vetëm unë dhe N.i ishim.”

I pandehuri A.G.1 në deklaratën e tij të dhënë në Shqyrtim Gjyqësor, me dt. 12.06.2024, ndër të tjera ka deklaruar se, e kanë përfunduar punën, kanë shkuar tek pllaci, e janë takuar me A.in kanë vendos që të hyjmë me pi kafe në Restorantin E.3. Duke tejkalu autostradën për me dal tek Restoranti, ka ardhur M.H. me veturë Porsche, i cili ishte në shpejtësi, e ka ndal shpejtësinë, e ka hapur xhamin e veturës dhe i ka shikuar, pastaj e ka mbush kerrin shllajf, nuk e ka ndi se

ka fol diçka. Pastaj kanë pi kafe në lokal me, A.i, N.i dhe B.. Pasi qe kanë pi kafe, kanë pas që të takohen me pronarin e punës, që ishin duke punuar në Meje të Gjakovës, janë nis me B.për me shku në Gjakovë për me u taku me pronarin e punës që ishin duke punuar në Meje të Gjakovës. Pasi që e kanë kaluar “.....”, janë kthyer sepse ju është prish vetura. Kanë shkuar menzi deri tek “.....”. Aty e kanë kontaktuar vëllain A.in i kam thënë thuj N.it merre Pik-upin e hajde tek Ujëvara sepse ju është prish kerri. Pastaj për pak minuta ka shku N.i dhe kanë vendos që të pinë kafe tek “.....”. Janë afruar deri afër për me hy në Restorant, por ka qenë si tollovi dhe kanë vendos që të shkojmë tek “.....”. E kan parkuar veturën përmbi parking të Ujëvarës dhe kanë shkuar tek “.....”. Duke u parkuar në parking e kanë parë veturën e M., e cila ishte në parking, kanë pritë 10 apo 15 minuta për të biseduar me M. dhe për tia dhënë 2 apo 3 flakaresha- shuplaka, sepse M. me vëllezërit e tij, ja kishte rrahur vëllain të pandehurit A.1 në Itali, në prezencë të gruas dhe djalit të vëllait. Pastaj M. ka dal nga Restoranti dhe ka filluar përleshja. A.li i ka ra M.t, një herë apo dy me shkop të cilin e ka pas në dorë, pastaj ka ardhë një vëlla i M. më i ka ra A.lit, në ato momente M.H. e ka nxjerr armën nga çanta dhe ka gjuajt dy herë në drejtim të A.it dhe N.it. Pastaj për deri sa ishte duke u përlesh A.li ia ka ra në duar M.H., i cili e kishte armën në dorë hala, i ka ra arma nga dora, është përkulur N.i që ta merr armën nga toka, është mundu M. prapë e ka shty për me marr armën, por e ka kap N.i armën, prej tokë, por nuk e ka pa se ka gjuajt në drejtim të ndokujt.

Gjykata gjeti se deklaratat e të pandehurit A.1, kanë kundërthënie mes tyre, i pandehuri A.1 në Polic kishte deklaruar se kanë shkuar pas M., përkatësisht pas 20 minutave ka vendosur se bashku me N.in me shku pas tij, duke e ditur se M. ka mujtë me shku vetëm ne Restorantet të “.....”, “.....” ose “...”, kanë dashtë vetëm me shku me e rrahë me ja kthye rrahjen të cilën ja kishte bër vëllait te tyre Egzonit në Itali, ndërsa në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se aty kanë shkuar vetëm pasi qe ju është prish vetura duke shkuar rrugës për në fsh. Mejë te Gjakovës. I pandehuri A.G.1, në Prokurori është mbrojtur në heshtje, ndërsa ne shqyrtimin gjyqësor, pasi ju përgjigj pyetjeve të parashtruara nga mbrojtësi i i tij, ne vazhdim deklaroi se do të mbrohet në heshtje dhe nuk do të përgjigjet në asnjë pyetj.

Gjykata vlerësoj se e përbashkëta e deklaratave të pandehurve gjithmonë dele të jetë motivi i kryerjes së veprës penale, e që ishte hakmarrja për një rrahje të ndodhur në Itali para disa muajve nga vëllezërit e të dëmtuarve, M., A. dhe F.H. të cilët jetojnë dhe veprojnë në Itali e kishin rrahur E.1 G., vëllain e të pandehurve, N., A., B. dhe A.G.1 në Itali ne muajin janar të vitit 2022.

Gjykata nuk ju fali, besimin deklaratave të pandehurve kur deklarorin se ditën kritike nuk kam pas qëllim, me ndodh rasti që ka ndodh, por kanë pas qëllim vetëm të bisedonin apo edhe t’ia jepnin ndonjë flakaresh –shuplakë, të dëmtuarit M., pasi që Gjykata vlerësoj se një deklaram i tillë është ne kundërshtim me provat personal edhe materialë te administruara gjatë shqyrtim gjyqësor. Nëse të pandehurit do te kishin si qellim të bisedonin më te dëmtuarin M.H. apo t’ia japin vetëm ndonjë flakaresh atëherë pse u pajisen me gjithë ato mjetë te forta si stupca-bishta të sakicave, kacia, e pastaj edhe me armë zjarri –pistoletën e përdor natën kritike, nga i pandehuri N.. Nga video-incizimet e marra nga kamerat e Restoranti “.....”, shumë qartë shihet, kur i dëmtuari M.H., del nga Restoranti “.....”, me familjen e tij dhe shkon në

drejtim të veturës së tij, i njëjti sulmohet menjëherë me mjete të forta nga të pandehurit dhe aty as qe kishte tentim nga te pandehurit për të biseduar me të dëmtuarit.

Fakti se në njëren gëzhgjë të gjetur natën kritike në vend ngjarje, dehmia #1, është gjetur profili i ADN-së, se të pandehurit Y. G., për gjykatën edhe pse ishte provë e pamjaftueshme për ta shpallur fajtor te pandehurin, Y.G., për veprat penale për të cilat akuzohet, kjo provë vërteton faktin se i pandehuri Y.G., ne një moment të caktuar ka pas kontakt me atë predhë në te cilën është gjetur profili i tij i ADN-së. I pandehuri Y.G., edhe kushëri i të pandehurve G., andaj kjo provë përjashton mundësin se pistoleta ka mundur te jetë e të dëmtuarit M.H., pasi qe nuk kishte asnjë provë apo indicie, se i dëmtuari M.H. të ketë pasur ndonjëherë kontakt me të pandehurin Y.G., ndërsa nga ana tjetër te pandehurit, N.G., A.G.. A.G.1, dhe B. G., kanë pas kontakt me të pandehurin Y.G., pasi qe edhe punëtorit i kishin ne të njëjtin vend, ne fshatin Volljakë dhe i ndante vetëm një muri nga njëra tjetra.

Gjatë shqyrtimi gjyqësor gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të pandehurit, N.G. për dërgimin e CD-ve në pastrim, për arsye se gjykata ka vlerësuar se video-incizimet janë mjaftueshëm te pastra dhe po ashtu ishin të qartësuar me foto në raportet e zyrtarëve policor, të cilët kishin përshkruar sekuencat e caktuar për aq sa mund të vërehen, andaj dërgimi i Cd-incizimev ne pastrim vetëm sa mund të prolongonte procedurën penale. Ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të pandehurit N.G., për dërgimin e armës për ekspertizë balistike të serishme për të vërtetuar vijat papilare, për arsye se, gjykata ka vlerësuar se ekspertiza balistike është e qartë, po ashtu ekspertët kanë qenë në seancë dhe mbrojtësit i është ofruar mundësia që të ju parashtrojë pyetje nëse ka pas dyshim si dhe mbrojtësi nuk ka ofruar ndonjë arsye konkrete se pse nuk duhet të ju besohet ekspertëve të cilët e kanë punuar ekspertizën për herë të parë.

Gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të pandehurit N. për dëgjimin e dëshmitarit Mulla Xh. K., si dhe propozimin e mbrojtësve të pandehurve, N.G. dhe B.G., për dëgjimin e dëshmitarit S. G., pasi qe gjykata ka vlerësuar se rrethanat për të cilat janë propozuar këta dëshmitarë nuk janë relevante për këtë çështje penale, nëse familjaret e tyre kanë kërkuar falje apo jo.

Sa i përket fajësisë të pandehurit ishin të vetëdijshëm për veprat e kryera dhe ato i kanë kryer me dashje. Ndërsa gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësinë penale të pandehurve N., B., A., Bahri dhe A.G.1, kështu qe të njëjtit janë penalisht përgjegjës.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 69 të KPRK-së. Rrethana lehtësuese për të pandehurit gjykata nuk gjeti.

Ndërsa rrethana renduese ndaj të pandehurve Gjykata, gjeti mënyrën dhe vendin e kryerjes se veprave penale, pasi qe të pandehurit duke mos pas fare konsideratë se në atë vend e posaçërisht në kohen kur kanë kryer veprat penale, aty ka persona qe kryesisht janë me familje e fëmijë, të pandehurit shkojnë dhe kryejnë veprat penale e ku vërehen edhe shumë musafir te restorantit të shqetësuar ngritën ne këmb nga vendet ku ishin duke qëndruar me familjet e tyre. Po ashtu

Gjykata si rrethanë rënduese mori faktin se të pandehurit veprat penale i kanë kryer në prezencën familjeve të dëmtuarve e posaçërisht në prezencën e fëmijëve të mitur, të të dëmtuarit M.H., e ku vërehet edhe fakti se fëmijët e mitur të dëmtuarit M.H., e kanë pa ngjarjen dhe njëri nga fëmijët edhe ka ikur në restorant për të kërkuar ndihmë për babain e tij, Gjykata vlerëson se një pamje e tillë për një fëmijët të mitur është pamje mjaftë e rënd e cila edhe mund të len pasoj tek fëmijët.

Gjykata për të pandehurin N.G., rrethanë rënduese në raport me të pandehurit tjerë, mori faktin se shkaktar i vdekjes së të ndjerit F.H., është goditje me predhën e pistoletës së shkrepur nga i pandehuri N.G..

Për të pandehurit B.G., gjykata rrethanë rënduese mori faktin se i njëjti si axhë i të pandehurve tjerë dhe me i moshuar se ta, në vend se të jap kontribut për parandalimin e një ngjarjes të tillë përkundrazi i njëjti merr pjesë aktivisht në kryerjen e veprave penale, ku i njëjti fillimisht vëzhgon të dëmtuarit deri sa dalin nga restoranti, duke i informuar të pandehurit që gjendeshin në pritje të tyre, e pastaj duke mos u mjaftuar me faktin se tani i ndjeri F., vetëm ishte i shtrirë në tokë, i pandehurit B.1, pengon dëshmitarin E.3, që ta ndal sulmin që ishte duke u zhvilluar në ato moment ndaj të dëmtuarit A. nga të pandehurit tjerë.

Për të pandehurit A.G., gjykata rrethanë rënduese mori faktin se i njëjti është vëllai më i moshuar nga të pandehurit, N., B. dhe A.1, dhe faktin se në fund vërehet kur i pandehuri A.1 është, duke e goditur me kaci të dëmtuarin A., i pandehuri A., merr kacinë nga A.1i dhe e godet në kokë të dëmtuarin A., pra i pandehurit A. ka qenë aktiv në kryerjen e veprave penale deri në momentet e fundit kur edhe janë larguar nga vendi i ngjarjes.

Për të pandehurit A.1 dhe B.G.1, gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese që mund të veçohet nga veprimet e përgjithshme të bëra në bashkëkryerje me të pandehurit tjerë.

Gjykata duke u gjendur para këtyre rrethanave të pandehurit i gjykoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke konsideruar se ky dënim është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tyre dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë, siç është bindur se vendimi mbi dënimin do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimin, e që është pengimi i të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen si dhe në preventivën tjetër për personat tjerë që të përmbahet nga kryerja e veprave penale, konform nenit 38 të KPRK-së.

Të pandehurve në dënimin e shqiptuar me burgim, do ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga dt. 28.04.2022 e tutje.

Të pandehurit të cilët u shpallën fajtorë duke u bazuar në nenin 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.1 dhe 2.6 të KPP-se, Gjykata ka përcaktuar për të pandehurit secilin veç e veç shpenzimet e procedurës penale në shumën prej 100 (njëqind) euro, për përpilimin e ekspertizave dhe dëgjimin e eksperteve në seancë. Po ashtu të pandehurit secilin veç e veç i obligojtë të paguajnë paushallin gjyqësor në shumë prej 100 (njëqind) euro, duke u bazuar në shpenzimet që janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri në përfundimin e saj.

Konform nenit 36 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, të pandehurit i obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata konform nenit 462 par 2, të KPRK-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Konform nenit 366 par.3 të KPP-së, gjykata ka konfiskuar pistoletën e llojit TT, kalibër 7.62x25mm, me ngjyrë të zezë, me nr. serik 7588839661962, me një karikator dhe dy (2) fishekë të pashkrepur,.

Si mjete të cilat janë përdorur në kryerjen e veprës penale, nga të pandehurit konfiskohen, Një (1) telefon “I-phone”, Një (1) telefon “I-phone” 12, ngjyrë e zezë; Një (1) thikë, ngjyrë e zezë, me mbishkrim “Bossidun” nr. 311, Një (1) fishekë me mbishkrim të stampuar 7.62mm, TTPPU, Një (1) lopatë pune me bisht të drurit; Një (1) mjet i fortë druri me gjatësi 0.80m.

Nga arsyet e cekura më lartë konform, nenit 363 par. 1 nën par. 1.3 të KPP-së, u vendos si në pjesën liruesë të këtij aktgjykimi, ndërsa konform 364 të KPP-së, është vendosur si pjesën dënuese të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 369 të KPP-së, Gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË,-Departamenti Për Krime të Rënda
PKR.nr.07/23 më datë 24.09.2024**

**Bashkëpunëtore profesionale
Selvane Bukleta**

**Kryetari i Trupit Gjykses
Shaqë Curri**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 30 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykatë.